

Raporti  
Raporti vjetor

2006  
vjetor



# Inspektorati Policor i Kosovës



Ministria e Punëve të Brendshme  
Qeveria e Kosovës

OSCE

IPK-ja është projekt i  
Misionit të OSBE-së në  
Kosovë për zhvillim të kuadrove



"SEMPER VIGILO"

# Inspektorati Policor i Kosovës

Raporti vjetor  
2006

Ministria e Punëve të Brendshme  
Qeveria e Kosovës

© 2007 Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)

Ministria e Punëve të Brendshme, Rr. "Armend Daci, Nr. 1, Bregu i Diellit,  
Prishtinë

Të drejtat e rezervuara

# Inspektorati Policor i Kosovës

2006

**I prezentuar Ministrit të Punëve të Brendshme**

**Në bazë të nenit 9.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54**

## Shkurtesat

KE	Këshilli i Evropës
DEZHP	Departamenti për Edukim dhe Zhvillim Policor (Misioni i OSBE-së në Kosovë)
KEEP	Kodi Evropian i Etikës Policore
BE	Bashkimi Evropian
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SHSHPK	Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme (Kosovë)
MD	Ministria e Drejtësisë
OMnK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Përmbajtja

## Faqe

Fjala hyrëse e Ministrit	6
Hyrje	7
Përmbledhje e aktiviteteve të IPK-së gjatë vitit 2006	11
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Menaxhimi i trafikut rrugor	14
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Menaxhimi i parkut të automjeteve	22
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Menaxhimi i ndërtesave	32
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Arrestimi dhe ndalimi	41
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Burimet njerëzore	51
Kryerja e detyrave nga ana e SHPK-së – Hetimi i krimit	65
Lista e rekomandimeve kryesore	77
Procedura standarde e operimit – Inspektimet e SHPK-së	83
Lista e inspektorëve të IPK-së	88
Ekipi implementues i OSBE-së	89

## Fjala hyrëse e Ministrit



Në kuadër të planit dhe strategjisë së organizimit dhe funksionimit të MPB-së ju prezentoj *raportin e parë vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës (2006-2007)*. Ky dokument i rëndësishëm do të bëhet një botim zakonshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe paraqet njëri nga metodat primare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të sigurimit të asaj që Shërbimi Policor është i përgjegjshëm ndaj qytetarëve të cilëve iu shërben.

Për MPB-në filozofia e funksionit të inspektimit policor të IPK-së mbështetet në *Kodin Evropian të Etikës Policore*. Inspektimet e zakonshme të IPK-së përqendrohen në mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e menaxhmentit të SHPK-së; në kuptim të efektshmërisë, efikasitetit dhe pajtueshmërisë me ligjin. Këto parime të rëndësishme duhet të kuptohen drejtë, me që vlejën për mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e policisë. Shprehja *efektshmëri* i referohet mënyrës se si zyrtarët e lartë të SHPK-së kryejnë detyrat për realizimin e qëllimeve kryesore policore, si zbulimin e aktiviteteve kriminale, zvogëlimin e vdekjeve dhe lëndimeve në rrugët e Kosovës, sigurimin e një mjedisi të qetë dhe të sigurtë për të gjitha komunitetet në Kosovë si dhe qëllimet tjera të rëndësishme policore. Vlerësimi i

efektshmërisë së SHPK-së përfshin parashtrimin e pyetjeve kontrolluese rreth suksesit të SHPK-së në realizimin e këtyre qëllimeve.

Shprehja efikasitet i referohet nevojave të SHPK-së në ofrimin e shërbimeve policore me një kosto minimale të taksapaguesve.

Dhe në fund, kemi shprehjen e *pajtueshmërisë*. Një shërbim policor demokratik, jo vetëm që duhet të realizojë qëllimet e veta me kosto minimale por edhe duhet ta bëjë një gjë të tillë në përputhje me ligjin dhe standardet e *Kodit Evropian të Etikës Policore*.

Dëshiroj të shpreh falenderimet e zyrtarëve të posadiplomuar të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) të cilët përpiluan raportin vjetor si dhe ekipin implementues të OSBE-së të cilët trajnuan zyrtarët e IPK-së dhe i ndihmuan ata në përgatitjen e këtij raporti.

Raporti i parë vjetor përfshin vetëm gjashtë tema të mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së, që nga fillimi i punës së IPK-së në korrik të vitit 2006, e jo 12 fushat e parapara gjatë një viti fiskal. Megjithatë, raporti nxjerr në pah anët pozitive të rëndësishme brenda SHPK-së si dhe fushat e rëndësishme në të cilat organizata duhet të zhvillohet. Tanimë është e qartë se puna e IPK-së si një mjet efikas i mbikëqyrjes dhe reformës policore është duke u treguar e suksesshme.

### Fatmir Rexhepi

Ministër i Punëve të Brendshme,  
Qeveria e Kosovës.



## Hyrje nga ushtruesi i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) filloi punën më datë 3 korrik, 2006, që ishte dita e parë e trajnimit, me ndihmën e ekipit implementues të OSBE-së. Shumë lexues me arsye nuk do të jenë të njohur me natyrën dhe qëllimin e kësaj organizate të re. Shënimet në vijim janë krijuar me qëllim që lexuesit e raportit të parë vjetor të kuptojnë rolin e IPK-së, si funksion i rëndësishëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### Çka është IPK-ja ?

Siç është definuar në Rregulloren 2005/54, IPK-ja është themeluar si një Organ Ekzekutiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përbëhet prej Kryeshefit Ekzekutiv dhe një grupi të zyrtarëve inspektues të cilët janë nëpunës civil dhe plotësisht të pavarur Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK). Këta zyrtarë janë të pajisur me një mori kompetencash për të hyrë dhe inspektuar stacionet dhe departamentet policore, për të intervistuar policët e të gjitha gradave, për të mbledhur të dhëna për mënyrën e kryerjes së detyrave, për të hetuar ankesat disiplinore, dhe aty ku është e domosdoshme për të konfiskuar dokumentet policore.

### Cili është qëllimi i IPK-së?

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është një mekanizëm i pavarur i

mbikëqyrjes së policisë me dy funksione kryesore:

(a) inspektimi i mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së në një varg të definuar të funksioneve menaxhuese, në lidhje me saktësinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi;

(b) hetimi i të gjitha ankesave për sjellje të keqe të policëve të SHPK-së, pa dallim grade.

### Cili do të jetë rezultati i punës së IPK-së?

Në çdo vit kalendarik IPK-ja do të paraqes një raport të thuktë në mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së, duke përfshirë analiza dhe rekomandime të hollësishme në reformat organizative. Kjo do t'i mundësojë Ministrisë që duke qenë plotësisht e informuar të marrë

vendime ndaj politikave që kanë të bëjnë me çështjet policore në Kosovë, si dhe të ndihmojë bashkësinë ndërkombëtarë në vlerësimin e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së. Përveç kësaj, IPK-ja do të përgatitë dosjet e rasteve në lidhje me ankesat formale për sjellje të keqe dhe t'i përcjellë rekomandimet sipas nevojës ose, ndryshe, për një shqyrtim disiplinor nga ana e Komisionit për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinë (KELPD).

### Si do t'i ndihmojë IPK-ja SHPK-së?

SHPK-ja është organizata më e re në ish-Jugosllavi dhe, me shumë respekt, është njëra nga modelet më të mira të 'policisë demokratike' në rajon. Sidoqoftë, SHPK-ja është ende duke u zhvilluar dhe duke u rritur. IPK-ja do të përpiqet që t'i ndihmojë SHPK-së në zhvillimin e tij si një institucion demokratik. Do ta bëjë këtë duke i aplikuar standardet evropiane policore, duke e vlerësuar punën e menaxherëve të SHPK-së – këto standarde janë të definuara në *Kodin Evropian të Etikës Policore*. Asnjë organizatë policore në rajon nuk e ka mënyrën e njëjtë të vlerësimit të punës në këtë mënyrë dhe IPK-ja do t'i ndihmojë menaxherëve të SHPK-së në sigurimin e pajtueshmërisë me standardet e Këshillit Evropian.

### Kush do të jetë përgjegjës për implementimin e programit të IPK-së?

Në bazë të një marrëveshjeje në mes të IPVQ-së (Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes), KM (Kryesuesit të Misionit) dhe Kryesuesit të Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut, OSBE-ja është pajtuar që të merr rolin udhëheqës në Projektin Implementues të IPK-së. Në shtator të vitit 2005 OSBE-ja emëroi Frank Harris si udhëheqës të projektit dhe Steve Smith si udhëheqës i trajnimit.

### Kush ka kompetencë ekzekutive për IPK-në?

Siç është cekur në Rregulloren 2005/54 dhe në Urdhëresën Administrative, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor ka kompetencë të plotë ekzekutive dhe i përgjigjet Ministrit të Punëve të Brendshme. Personeli i OSBE-së do të jetë përgjegjës për themelimin dhe implementimin, si të fazës së ndërtimit të institucionit po ashtu edhe të fazës së ndërtimit të kuadrove, si dhe monitorimin e punës së IPK-së.

Personeli i OSBE-së ka siguruar këshilla në nivel ekspertësh gjatë procesit të rekrutimit, përfshirë edhe organizimin e procesit të selektimit i cili ishte krijuar që të identifikohen kandidatët më të mirë të mundshëm për pozitat e IPK-së. Kjo përpjekje në bashkëpunim me Ministrinë – ka rezultuar në një proces transparent dhe të drejtë të selektimit.

### Ku është e vendosur IPK-ja?

Në mënyrë që të mundësohet që sa më parë të fillojë faza e krijimit të kuadrove, OSBE-ja është pajtuar që të sigurojë një vend të përkohshëm dhe pajisjet përkatëse për aftësim të stafit të Inspektoratit. Kjo gjendet në Bazën e Logjistikës të OSBE-së (BBC2, në rrugën e aeroportit). Posa të sigurohet vendi i përhershëm nga Ministria, personeli i Inspektoratit do të vendoset në objektet e veta.

### Çfarë shkathtësish do të kërkojnë zyrtarët e IPK-së?

Funksionet e Inspektoratit janë të veçanta në kontekst të IPVQ-së dhe krijimi i kuadrove të kërkuara është shumë i specializuar. Puna ka filluar me krijimin e programit të ndarë në dy faza për ndërtimin e kuadrove për ekipin e Inspektoratit. Faza e parë e programit do të zgjasë 30 javë dhe do të përqendrohet në njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen për të kryer inspektimet auditive mbi mënyrën e



kryerjes së detyrave nga ana e menaxhmentit të SHPK-së dhe përgatitjen e raportit të parë vjetor mbi mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së, në dhjetor të 2006. Kjo do të përfshijë:

- Programin njoftues;
- Shkathësitë e inspektimit policor – Përdorimi i protokoleve inspektuese;
- Shkathësitë e raportimit të inspektimit;
- Shkathësitë për menaxhim themelor dhe për udhëheqësi;
- Ligji i aplikueshëm;
- Reforma policore dhe ndryshimi organizativ.

### Si do të ndihmojë IPK-ja për të siguruar përgjegjshmërinë e SHPK-së?

IPK-ja funksionon si një mekanizëm mbikëqyrës i policisë, plotësisht i pavarur nga SHPK-ja. Pavarësia e IPK-së është kusht thelbësor në ruajtjen e besimit të popullatës në SHPK-në si një organizatë profesionale, që bazohet në parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë.

Roli i IPK-së nuk duhet të merret si negativ nga ana e policëve të SHPK-së ose si një ndërhyrje e padëshirueshme në veprimet policore. Inspektimet kanë për qëllim që të arrijnë vetëm rezultate pozitive. Në çdo vit kalendarik puna e inspektiveve do të rezultoj në një Raport Vjetor të mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së: analiza të thukta të veprimeve menaxheriale që identifikojnë anët pozitive dhe negative, dhe bëjnë rekomandime praktike dhe reale në lidhje me ndryshimet që mund ta përmirësojnë mënyrën e kryerjes së detyrave në të ardhmen.

Vendimi për të vepruar ndaj këtyre rekomandimeve qëndron tek Komisioneri, por shpresohet se ata do ta ndihmojnë atë në detyrat për

zhvillimin e mëtutjeshëm të organizatës

Gjithashtu, përgjegjësia e IPK-së për të hetuar ankesat e rënda për sjellje të këqia (që pritet të fillojë në mars të vitit 2007) duhet të shikohet në pikëpamje pozitive. Puna e IPK-së do ta ndihmojë SHPK-në që t'i demonstrojë popullatës se është plotësisht e përgjegjshme dhe se ankesat për sjellje të këqija do të hetohen në mënyrë të drejtë nga një organ i pavarur, e jo nga policët tjerë. IPK-ja do të sigurohet se të drejtat e policëve që akuzohen për sjellje të keqe respektohen, duke zbatuar në mënyrë rigorozë parimin se një polic është i pafajshëm përderisa nuk shpallet fajtor.

Për këtë shkak, IPK-ja nuk do të ndërhyjë në kompetencat ekzekutive të Komesarit apo të ndonjë zyrtari tjetër të lartë të SHPK-së. Nuk do të ndërhyjë gjithashtu në kompetencat e SHPK-së për punët operative policore. Në vend të kësaj IPK-ja do t'ju ndihmojë menaxherëve të SHPK-së të përmirësojnë mënyrat në të cilat ata arrijnë tri qëllime:

- **Efektshmërinë** – duke u siguruar që qëllimet e SHPK-së janë arritur;
- **Pajtueshmërinë** – duke u siguruar që qëllimet e SHPK-së janë arritur në pajtueshmëri të plotë me ligjet e aplikuara dhe standardet evropiane;
- **Efikasitetin** – duke u siguruar që qëllimet janë arritur në mënyrën më fitimprurëse, duke ua bërë të ditur punën e policëve taksapaguesve të Kosovës.

### Informatat e mëtutjeshme

Për një kuptim më të hollësishëm të rolit inspektues të IPK-së, lexuesit këshillohen që të shikojnë procedurat e standardeve operative, në fund të këtij raporti vjetor si dhe urdhëresën Administrative 2006/9. IPK-ja ekziston

me qëllim që Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe komuniteteve në Kosovë t'iu ofrohen informata të hollësishme dhe të sakta për mënyrën e kryerjes së detyrave

Ne jemi të gatshëm që edhe më tej të ofrojmë informata për punën e SHPK-së.

**Enver Rustemi**

Ushtrues i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv,  
Inspektorati Policor i Kosovës,  
Ministria e Punëve të Brendshme.

## Përmbledhje e aktiviteteve të IPK-së gjatë vitit 2006

Roli auditiv dhe inspektues i Inspektoratit Policor përfshinë rishikimin e punës së organizatës së SHPK-së si tërësi dhe një kontroll të vargut të tërë të aktiviteteve menaxheriale, përfshirë shfrytëzimin efektiv të resurseve njerëzore. Roli i Inspektoratit është i lidhur me identifikimin e problemeve të cilat ndeshen në arritjen e qëllimeve të organizatës dhe ndryshimit në mes formulimit të strategjisë dhe politikave të vendimarrjes, si dhe veprimeve të nevojshme për implementimin e suksesshëm të tyre. Inspektimet kanë lidhje me gjendjen e tanishme të organizatës së SHPK-së dhe me atë se çfarë duhet të bëhet tani me qëllim të arritjes së objektivave dhe qëllimeve të policisë.

Roli i Inspektoratit është kompleks dhe tërësor përshkak të karakteristikave të caktuara unike të SHPK-së si një organizatë e re dhe në zhvillim. Së pari, duhet të jemi në dijeni për atë se – në shumë zona të përgjegjësive - menaxherët relevant të SHPK-së kanë përvojë të pamjaftueshme dhe shpesh i kanë mbajtur pozitën e tyre vetëm për disa muaj në vend të viteve. Së dyti, përgjegjësia e menaxherëve të SHPK-së në nivelet më të larta menaxheriale mbetet në gjendje të paqëndrueshme; procesi i transferimit të kompetencave policore nga UNMIK-u vazhdon, po ashtu edhe procesi lidhur me konsolidimin e zonave ekzistuese të përgjegjësive është në vazhdim. Kompleksiteti i këtyre proceseve nuk duhet të nënvlerësohet as vështërisht që hasen nga këto në UNMIK dhe SHPK.

*Ngjashëm sikur sipërfaqet e diamantit çdo raport i IPK-së ofron një pasqyrë të jetës së organizatës së SHPK-së si tërësi.*

### Zhvillimi personelit të IPK-së

Në gjashtë muajt e parë të punës së tij Inspektorati Policor ka kaluar nëpër një trajnim të vazhdueshëm. Nën udhëheqjen e OSBE-së Misioni në Kosovë, zyrtarët e Inspektoratit I janë nënshtruar një programi intenziv për të zhvilluar njohurit e nevojshme, shkathësit dhe aftësit për të arritur këto objektiva të IPK-së të përshkruara në Rreguloren 2005/54 dhe Urdhëresën Administrative 2006/9. Theksi është vënë 'në të mësuarit në veprim' – psh. të mësuarit e kryerjes së intervistave duke i bërë ato, më parë se sa thjeshtë vetëm të bisedohet për ato. Kjo ka qenë rezultat i gjashtë Raporteve të Përkohëshme që janë përmbajtje e këtij Raporti Vjetor. Në një vit Inspektorati do të paraqes së paku dymbëdhjetë Raporte të Përkohëshme, secili i përqëndruar në aspekte të ndryshme të menaxhmentit të SHPK-së. Këto raporte do të ndërtohen duke u grumbulluar në një imazh të detajuar të organizatës së SHPK-së dhe kryerjes së detyrave nga ana e menaxherëve të lartë të SHPK-së. Ngjashëm sikur sipërfaqet e diamantit çdo raport i IPK-së ofron një pasqyrë të jetës së organizatës së SHPK-së si tërësi.

Në qendër të programit trajnues qëndron një metodologji e inspektimit e planifikuar me kujdes. Që nga fillimi i trajnimit në korrik të vitit 2006 IPK-ja ka kryer gjashtë inspektime të rëndomta lidhur me performancën e menaxhmentit të SHPK-së, duke

përfshirë këtu menaxhimin e trafikut rrugor, menaxhimin e parkut të automjeteve, menaxhimin e objekteve, menaxhimin e qendrave të paraburgimit, resurseve njerëzore dhe menaxhimin e hetimit të krimit. Në secilin rast, zyrtarët e IPK-së në tajnim kanë shfrytëzuar pytësorë të strukturuar (të njohur si 'Protokolle') që sigurojnë njëtrajtshmeri dhe objektivitet në procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha regjionet e SHPK-së dhe departmentet e Shtabit Qëndror. Inspektorët kanë intervistuar zyrtarët e lartë relevant të SHPK-së dhe menaxherët civil, kanë kërkuar mendimin e pjesëtarëve të SHPK-së në nivele më të ulëta dhe kanë grumbulluar dëshmi të dokumentuara.

Hapi i ardhshëm nga inspektorët e IPK-së përfshin shëndrrimin e shumicës së të dhënave të mbledhura nën secilin inspektim tematik në një Raport të Përkohshëm. Burime të ndryshme të dëshmive janë analizuar, vlerësuar dhe janë identifikuar drejtime dhe metoda të rëndësishme. Fushat e menaxhimit të performancës janë studiuar, janë nxjerrur konkluzione dhe janë formuluar rekomandime të arritshme dhe reale. Përfundimisht, ky material është i përmbledhur brenda Raportëve të Përkohshme në katër fusha kryesore: që domethënë, struktura organizative e SHPK-së, performanca menaxhuese e tanishme, politikat dhe strategjia. Është bërë çdo përpjekje për tu siguruar se raportet janë në harmoni si duhet, duke treguar të dy fushat anën e fortë dhe atë të dobët.

**...Inspektorati Policor është mbrojtës i rëndësishëm i demokracisë në Kosovë.**

## Për të siguruar përgjegjshmërinë policore

Kjo përpjekje nuk është e menduar të jetë thjeshtë vetëm si një *ushtrim teorik*, një qështje e krijimit të më shumë raporteve që kryesisht injorohen dhe rrallë veprohet në bazë të tyre. Siq është e paraqitur në Rregulloren 2005/54 dhe urdhëresën Administrative 2006/9, Inspektorati Policor është një mbrojtës i rëndësishëm i demokracisë në Kosovë. Kjo është arritur përmes përgjegjësis publike, qeverisjes së mirë dhe transparencës. Raportet e Përkohshme dhe Raporti Vjetor janë menduar të jenë mjetet më të rëndësishme përmes të cilave Ministria e Punëve të Brendshme garanton se policët mbahen të përgjegjshëm ndaj të gjitha komuniteteve në Kosovë. Përgjegjësia do të thotë të qenit i hapur ndaj pyetjeve të publikut dhe afrimi i një dritarëje të hapur brenda SHPK-së, oraganizat e cila pretendon rol primar në sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë publike në Kosovë.

Raportet përmbajnë rekomandime kyçe të cilat kanë për qëllim përmirësimin e mënyrës se si SHPK-ja arrinë objektivat e saj të ligjshme. Megjithëse Komesari i policisë dhe zyrtarët e lartë të SHPK-së kanë autoritet të plotë për të gjitha vendimet operative dhe menaxheriale, aty tani më ka dëshmi se SHPK-ja është duke vepruar në bazë të rekomandimeve të Inspektoratit Policor.

Puna e Inspektoratit Policor është tërësisht pjesë e bashkëpunimit aktiv me Komesarin e Policisë dhe zyrtarët e lartë të SHPK-së. Deri më tani Inspektorati është njohur, me respekt, ashtu që shumica e zyrtarëve të lartë policor kanë qenë kooperativ dhe të gatshëm për të ndihmuar rrjedhën e inspektimeve të rëndomta. Veç kësaj, Inspektorati ka vërejtur qëndrimin pozitiv në mesin e policëve të SHPK-së të të gjitha gradave dhe gatishmërinë për tu zhvilluar dhe mësuar.

### Vështrimi drejt 2007

Më 2007 Inspektorati Policor shpreson të vazhdoj bashkëpunimin me SHPK-në. Përveç një rrethi të plotë prej 12 inspektimesh të rëndomta Inspektorati do të merr përgjegjësin për hetimin e rasteve të shkeljeve të rënda nga ana e policëve të SHPK-së të të gjitha gradave. Nën udhëheqjen e OSBE-së Misioni në Kosovë, më 2007 ekipi i ri i hetuesve të Inspektoratit do të përzgjedhet dhe do të trajnohet në bazë të dispozitave të Rregullores 2005/54, urdhëresës Administrative 2006/9, ligjit të aplikueshëm dhe shkathtësive hetuese. Gjatë vitit 2007 IPK-ja do të marr përgjegjësi të plotë për hetimin e të gjitha ankesave kundër policëve, nëse ajo dëshmohet, do të rezultoj me shkelje të rënda. Si një oraganizatë e pavarur, IPK-ja mund të ndihmoj në rritjen e besueshmëris së publikut që policët të cilët nuk veprojnë në pajtueshmëri me ligjin do të mbajn përgjegjësi. Gjthashtu mund të siguroj garanci të madhe tek policët të cilët janë subjekt i ankesave me qëllime të këqija dhe të pavërteta.

Në fillim të vitit 2007 grupi i parë i inspektorëve të IPK-së do të zhvendoset në objektin e ri të Inspektoratit Policor, Rr. „Armend Daci“, Nr#1, Bregu i Diellit, Prishtinë. Kjo hapsirë e pajisur mirë do t’iu bëjë të mundur grupit të parë të

Inspektoratit të vazhdojnë me punën auditive dhe inspektuese, përderisa grupi i dytë i hetuesve të posa rekrutuar do të kaloj trajnimin në bazën e logjistikës së OSBE-së në BBC2 Prishtinë. Në mënyrë që të implementohet plotësishtë programi udhëheqës i OSBE-së IPK-ja duhet që plotësisht të kompletohet në shtator ose tetor të vitit 2007.



***Në fillim të vitit 2007 grupi i parë i inspektorëve të IPK-së do të zhvendoset në objektin e ri të Inspektoratit Policor, Rr. „Armend Daci“, Nr.1, Bregu i Diellit, Prishtinë.***

## 1. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Menaxhimi i trafikut rrugor

### Hyrje

1.1 Inspektimi i parë i rëndomtë është bërë më datën 20 dhe 21 korrik të vitit 2006, sipas Rregullores 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9. Ky inspektim ishte i përqendruar vetëm në kryerjen e detyrës së menaxhimit në trafikun rrugor dhe është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, ushtrues i detyrës së Shefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit të përbërë nga 18 inspektorë. Vizitat janë bërë në Shtabin e Policisë në Prishtinë dhe në të gjitha shtabet regjionale. Pa përjashtim, inspektorët hasën në bashkëpunim dhe në gatishmëri nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së që t'ju ndihmojnë.

1.2 Niveli i aksidenteve në trafikun rrugor, vdekjet dhe lëndimet e shkaktuara nga aksidentet në Kosovë mbesin fushë e shqetësimit. Kryerja e detyrave të menaxhmentit për trafikun rrugor është pjesë e kornizës së punës e krijuar nga zyrtarët e lartë të SHPK-së me qëllim që të mundësohet një përgjegje taktike në qëllimet e përshkruara në Rregulloren 2005/54, e që kanë të bëjnë me zvogëlimin e numrit të vdekjeve dhe lëndimeve në rrugët e Kosovës. Kjo ndërlidhet me objektivat kryesore të SHPK-së, në detyrën e vet për t'u përkujdesur për një ambient të sigurtë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

1.3 Synim i inspektimit gjatë inspektimeve të rëndomta është që të jepen rekomandime në mënyrë që menaxherët e nivelit të lartë të SHPK-së të mund ta përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në pajtim me synimet në vijim:

- Pajtueshmëria me standardet relevante brenda *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Inkurajimi i strategjive më të mira për kryerjen e detyrave policore në mënyrë proaktive dhe reaktive me qëllim të zvogëlimit të vdekjeve dhe lëndimeve në trafikun rrugor të Kosovës;
- Të ndihmohet në përgatitjen e masave më efektive që në mënyrë të suksesshme të zbulohet dhe parandalohet dukuria e tejkalimit të shpejtësisë dhe kundërvajtjeve tjera në trafikun rrugor; dhe
- Të identifikojë dhe shpërndajë praktikë më të mirë.

1.4 Gjatë rrjedhës së inspektimit, personeli i Inspektoratit Policor ka vizituar dhe ka intervistuar punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Udhëheqësin e Drejtorisë së Trafikut
- Komandantët Regjional
- Udhëheqësit e Njësitit Regjional të Trafikut Rrugor
- Komandantët e stacioneve (shembuj të rastit)
- Udhëheqësin e Trajnimeve për Trafikun Rrugor, në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës
- Policët patrullues të SHPK-së të Njësitit të Trafikut Rrugor (shembuj të rastit)
- Vizitat në Njësitin e Trafikut (qendrore dhe regjionale sipas nevojës) dhe intervistat me personelin e njësisë së trafikut.

1.5 Me bashkëpunim të mirëfilltë të zyrtarëve të lartë të SHPK-së Inspektorati Policor ka mbledhur një sasi të rëndësishme të informatave, duke e shfrytëzuar protokollin

mbi 'Menaxhimi e Trafikut Rrugor' <sup>1</sup>. Raporti i tashëm nuk i paraqet të gjitha informatat dhe shënimet që janë mbledhur gjatë inspektimit, por fokusohet në qëllimet më të rëndësishme të menaxhimit, që Inspektorati Policor beson se janë fusha të rëndësishme për zhvillim organizativ në fushën e Menaxhimit të Trafikut Rrugor.

### Organizimi i detyrave policore në trafikun rrugor

2.1 Politika e Trafikut Rrugor në Kosovë organizohet nëpërmjet njësive të trafikut regjional, që ndahet me autoritetin e menaxhimit të Drejtoratit të Trafikut, me Shtabin e SHPK-së dhe Komandatët Regjionale. Çdonjëra njësi regjionale e trafikut është nën komandën vepruese respektivisht nën komandën e Komandatit Regjional, por menaxhimi i automjeteve në trafik, pajisjet dhe mirëmbajtja janë të centralizuara. Përveq kësaj, selektimi, trajnimi dhe emërimi i zyrtarëve të trafikut dhe stafit mbështetës civil janë po ashtu të centralizuara. Njësia e Trafikut Regjional luan një rol të posaçëm në ndjekje të këtyre politikave sipas nenit 3 të Rregullores 2005/54, pasi që ato ndërlidhen me sigurinë rrugore në Kosovë. Posaçërisht, me njësitë e trafikut rrugor që janë përgjegjëse për:

- hetimin e të gjitha aksidenteve të rënda dhe fatale;
- zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor dhe promovimin e një ambienti rrugor sa më të sigurtë; dhe
- sigurimin e përcjellësve të VIP-ve dhe funksionet tjera të trafikut.

<b>Tabela 1 – Njësia Regjionale e Trafikut Rrugor – Pozicionimi i personelit</b>			
<b>Korrik 2006</b>			
	<b>Zyrtarë policorë</b>	<b>Personeli civil</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Pristina</b>	110	13	123
<b>Peje</b>	N/A	N/A	N/A
<b>Prizren</b>	74	10	84
<b>Mitrovica</b>	73	13	86
<b>Gjilan</b>	63	10	73
<b>Ferizaj</b>	58	9	67

2.2 Tabela më lartë paraqet një përmbledhje të stafit të pozicionuar në njësitë regjionale të trafikut rrugor. Me përjashtim të njëjës, Komandatët Regjionale janë të kënaqur me shkallën e stafit dhe trajnimin që bëhet në Shkollën Policore dhe ato në nivel lokal. Inspektorati Policor ka mbikëqyrur që njësitë kanë një organizim të mirë dhe në përgjithësi janë të motivuar. Sidoqoftë, Inspektorati ka vërejtur që disa nga Komandatët Regjionale janë të brengosur lidhur me mungesën e qartësisë në

<sup>1</sup>Neni 1(e) i Urdhresës Administrative 2006/9 e definon termin "protokoll" si udhëzim i shkruar që definon procedurat operative. Përbehet nga një seri pyetjesh lidhur me temën e menaxhimit (p.sh. Politikë e Menaxhimit të Rrugëve) dhe vepron si udhëzues procedural për një 'inspektim të zakonshëm'.

menaxhimin operativ në njësitë e trafikut rrugor: Është e paqartë nëse Shtabi Kryesor i Prishtinës apo Komandantët Regjionalë kanë përgjegjësi për t'i identifikuar politikat e përgjithshme dhe strategjitë e sigurisë rrugore në trafik. Kjo brengë diskutohet më tej në paragrafin më poshtë 2.12.

2.3 Pothuajse në të gjitha regjionet, Inspektorati Policor ka qenë i informuar lidhur me të metat në sistemin e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve esenciale në njësitë e trafikut rrugor. Derisa njësitë janë furnizuar me automjete të patrullimit dhe me një varg pajisjesh moderne, ato nuk mirëmbahen si duhet dhe nuk servisohen. Posaqërisht, sistemi për kalibrimin dhe riparimin e 'radarëve' (mjet për përcaktimin e shpejtësisë) dhe mjetet për matjen e alkoolit tek ngasësit kërkon rishikim urgjent për të siguruar maksimumin e arritshëm të këtyre pajisjeve esenciale. Inspektorati Policor do të sigurojë një mbikëqyrje sa më të thellë në të metat e mirëmbajtjes së flotës së automjeteve të SHPK-së në inspektimin e zakonshëm të ardhshëm (Gusht 2006).

#### Rekomandimi kryesor nr. 1

*Është propozuar që SHPK-ja të udhëheq një rishikim urgjent të sistemit të tanishëm të servisimit dhe kalibrimit të të gjitha pajisjeve të zbulimit (p.sh. pajisjeve për zbulimin e shpejtësisë (radarë) dhe pajisjeve për zbulimin e alkoolit (alkotest) që shfrytëzohen nga Njësitë e Trafikut Regjional dhe të implementojë ndryshime për të siguruar maksimumin në arritjen e pajisjeve të tilla..*

2.4 Inspektorati Policor ka vërejtur se pothuajse të gjithë zyrtarët e lartë të SHPK-së kanë identifikuar nevojën për një bashkëpunim të afërt dhe një konsultim aktiv me komunitetet vendore dhe autoritetet komunale në lidhje me politikat e trafikut rrugor. Në pajtim me Nenin 7 të Rregullores 2005/54, menaxherët e SHPK-së në regjione kanë informuar Inspektoratin në lidhje me mbledhjet e rregullta dhe të dobishme me komunitetet vendore dhe autoritetet komunale. Sidoqoftë, kur ata janë pyetur, vetëm disa nga ata kanë mundur të ofrojnë dëshmi të mbledhjeve të tilla apo rezultate në lidhje me këto mbledhje. Inspektorati Policor është njoftuar në lidhje me disa rezultate. Me siguri se rezultati më i qartë i kësaj përpjekjeje për të arritur një bashkëpunim të ngushtë me komunitetet vendore është ligjërimi për sigurinë në rrugë nëpër shkollat regjionale.

#### Rekomandimi kryesor nr. 2

*Në rastin e parë që SHPK-ja do ta ketë, duhet të prezentojë një procedurë standarde të operimit që kërkojnë shënime formale të mbledhjeve ndërmjet Komandantëve të SHPK-së dhe komuniteteve vendore dhe autoriteteve komunale. Posaqërisht, këto shënime do të duhet të identifikojnë agjendën e mbledhjeve dhe rezultatet e arritura nga SHPK-ja dhe pjesëmarrësit tjerë. Procedura e rishikuar, po ashtu, duhet të adresojë nevojën për progresin e raportit që ofron detaje të qarta të ndryshimeve që rezultojnë nga veprimet e ndërmarrura..*

### Gjendja aktuale e kryerjes së detyrave policore në trafikun rrugor

2.5 Secili regjion ka qenë në gjendje që të ofrojë statistika në lidhje me kategoritë kryesore të aksidenteve në trafikun rrugor. Tabela 2. tregon krahasimin e aksidenteve në trafikun rrugor (në bazë të kategorisë) për gjashtë muajt e parë të vitit 2005 dhe 2006 në secilin regjion<sup>2</sup>. Edhe pse nuk është një analizë e dymbëdhejtë

<sup>2</sup> Shënimet e dhëna janë marrë nga statistikat e shkëputura nga secili regjion në korrik të vitit 2006, duke përdorur kategoritë korresponduese.



muajve të plotë<sup>3</sup>, të dhënat zbulojnë arsyet e brengosjes së komandantëve regjionalë. Përderisa në shumicën e regjioneve është zvogëluar numri i aksidenteve me dëme, është shënuar rritje në numrin e aksidenteve me fatalitet dhe me lëndime në të gjitha regjionet.

Tabela 2 – Aksidentet në trafikun rrugor në Kosovë – Krahasimi në regjione												
Prej janarit e deri në qershor 2005/'06												
Lloji i aksidentit	Pristinë		Pejë		Prizren		Mitrovicë		Gjilan		Ferizaj	
Viti	'05	'06	'05	'06	'05	'06	'05	'06	'05	'06	'05	'06
Aksidente me fatalitet	60	67	8	9	8	18	7	7	6	4	8	6
Personat e vdekur	67	75	8	13	N/A	N/A	7	7	N/A	N/A	9	6
Aksidentet me lëndime	940	1197	127	176	213	265	116	147	70	52	60	96
Personat e lënduar	1507	1862	170	283	N/A	N/A	178	207	N/A	N/A	140	160
Aksidentet me dëme	4760	4518	920	809	445	334	314	176	165	162	144	189

2.6 Siç tregohet në Tabelën 3<sup>4</sup>, të dhënat e kombinuara të cilat i janë dhënë Inspektoratit Policor tregojnë një rritje të përgjithshme prej 12% të aksidenteve me fatalitet dhe 21% të aksidenteve me lëndime në periudhën prej gjashtë mujorit të parë. Inspektorati Policor mendon se një tendencë e tillë kërkon një reagim të shpejtë të Komandantëve Regjionalë në periudhën para se të bëhet inspektimi tjetër i rëndomtë mbi menaxhimin e trafikut rrugor.

2.7 Inspektorati Policor ka vërejtur se secili regjion ka punuar në sisteme që kanë ndryshime të vogla në kategorizimin e të dhënave, disa punojnë në mënyrë më të hollësishme se sa të tjerët. Mungesa e qartë e sistemit të përbashkët të kategorizimit dhe prezentimit të të dhënave për aksidente ka krijuar një problem kur është bërë krahasimi i punës në secilin regjion sipas kategorisë së incidentit. Mundësia për ta krahasuar punën e kryer në këto fusha kritike të kryerjes së punës policore është mjet esencial i menaxhmentit të lartë dhe kërkon reagim të shpejtë.

<sup>3</sup> Një krahasim 12 mujor do të jetë i gatshëm në raportin e parë vjetor (për vitin 2006) në lidhje me mënyrën e kryerjes së punëve nga SHPK-ja, ky raport do të përfundohet në shkurt të vitit 2007.

<sup>4</sup> Tabela 2 thjesht përmban shënime nga Tabela 1.

Tabela 3 – Aksidentet në trafikun rrugor në Kosovë (Të gjitha regjionet) janar - qershor 2005/’06				
Lloji i aksidentit		2005	2006	+/- %
Aksidentet fatalitet	me	97	111	+ 12.6%
Aksidentet lëndime	me	1526	1933	+ 21%

Rekomandimi kryesor nr. 3
<i>Rekomandohet fuqimisht që SHPK-ja të pajtohet dhe të implementojë një sistem të përbashkët të kategorizimit dhe prezentimit të informatave në lidhje me aksidentet.</i>

2.8 Kudo në regjione ka mungesë të informatave të sakta lidhur me faktorët kryesorë të aksidenteve.<sup>5</sup>Një informatë është vitale për zyrtarët e lartë të SHPK-së, t'i përpunojnë politikat dhe strategjitë që adresojnë shkaqet kryesore të aksidenteve (shiko paragrafin 2.12 më poshtë). Duke u nisur që aksidentet fatale dhe me lëndime janë temë e hetimeve të detajizuara të aksidenteve, Inspektorati Policor beson që mund të jetë e mundur të mbledhen shënime të zakonshme nga raportet e hetimeve dhe të prezentohen shkaqet kryesore në formë statistikore.

Rekomandimi kryesor nr. 4
<i>SHPK-ja duhet të nxitet që të përgatisë dhe implementojë një sistem të mbledhjes së informatave në lidhje me shkaqet e faktorëve të aksidenteve nga raportet e hetimeve të aksidenteve fatale dhe me lëndime. Informatat përfundimtare duhet të jetë në dispozicion të të gjithë stafit komandues regjional dhe të shrytëzohen në hartimin e politikave dhe strategjive të trafikut në rrugë.</i>

2.9 Edhe pse zyrtarët e lartë nuk posedojnë shënime të sakta në lidhje me rastet specifike të aksidenteve brenda regjionit të tyre, ekziston një shkallë e marrëveshjes së mirëfilltë në lidhje me faktorët më të mundshëm që ndihmojnë në aksidente:

- Një infrastrukturë e varfër e rrugëve, duke përfshirë kryqëzimet rrethore të parregullura (p.sh. semaforë të pamjaftueshëm dhe shenja rrugore);
- Sasi e madhe e automjeteve rreth qendrave urbane;
- Aftësi të dobëta të vozitjes;
- Tejkalim i shpejtësisë;
- Mirëmbajtja e dobët e automjeteve.

2.10 Shumë menaxherë regjionalë e pranuan që policia, duke punuar vetëm, nuk mund të zvogëlojë numrin e aksidenteve rrugore në Kosovë. Ministria e Transportit dhe autoritetet komunale kanë përgjegjësi të mjaftueshme për përmirësimin e

<sup>5</sup> Termi 'faktor i rastit' i referohet faktorit që është përcaktuar si faktor kryesor në shkakun e aksidenteve (p.sh. në tejkalim të shpejtësisë, gabim i vozitësit, kushtet rrugore të pafavorshme, veturat defektive), qoftë duke vepruar në izolim apo kombinim me shkaqet e tjera dominante.

infrastrukturës rrugore, duke i përmirësuar udhëkryqet ku aksidentet ndodhin shpesh dhe duke e shtuar numrin e rrugëve rreth qendrave urbane. Zyrtarët e lartë të SHPK-së gjithashtu i njohin nevojat për strategjinë e përbashkët në mes të Ministrisë së Transportit, autoriteteve komunale dhe të SHPK-së e cila identifikon, përcakton sasinë e shkaqeve kryesore të aksidenteve fatale dhe atyre me lëndime, si dhe pastaj i përgatitë burimet për të reagur ndaj këtyre faktorëve të rastit. Sidoqoftë, Inspektorati Policor ka gjetur pak dëshmi të dokumentuara të çfarëdo marrëveshjeje formale në lidhje me këto strategji të përbashkëta për ta përmirësuar sigurinë në rrugë.

2.11 Inspektorati Policor është njoftuar për disa shembuj në lidhje me partneritetin e suksesshëm në mes të Njësitit Regjional të Trafikut Rrugor dhe Ministrisë së Transportit.<sup>6</sup> Sidoqoftë, ekziston një fushë e rëndësishme për një bashkëpunim më të afërt dhe më të mëtutjeshëm, duke pasur parasysh numrin e raporteve nga ana e zyrtarëve të lartë të SHPK-së në lidhje me mungesën e bashkëpunimit. Veçanërisht, komandantët e SHPK-së kanë cekur mungesën e bashkëpunimit me Ministrinë e Transportit, në lidhje me këtë kemi pohimin e SHPK-së se sistemi i kontrollimit të automjeteve është me të meta dhe jo efektiv dhe rastin e mosdashjes për t'i lejuar zyrtarët e SHPK-së që të monitorojnë punën e ekzaminerëve në dhënien e patentë shoferëve. Zyrtarët e SHPK-së kanë pohuar lidhur me shembuj të tjerë ku Ministria e Transportit ka dështuar të veprojë nën rekomandimet e policisë.

2.12 Obligimi i 'tiketave të gjobitjes' mbetet një masë primare preventive e Njësisë së Trafikut Rrugor të SHPK-së në përpjekjet e tyre për t'i zvogëluar aksidentet. Tiketave detyrohen për një varg të kundërvajtjeve dhe kryesisht për shpejtësi, ngarje pa patentë shoferi, automjete të paregjistruara dhe ngarje e automjetit pa rripin e sigurisë. Tabela 3 paraqet një analizë të shënimeve të dhëna nga regjionet. Duke e krahasuar periudhën janar - qershor të vitit 2005 dhe 2006.

<b>Tabela 4 – Kundërvajtjet në trafikun rrugor – Tiketave të lëshuara (Të gjitha regjionet)</b>			
<b>Janar - Qershor 2005/06</b>			
	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>+/- %</b>
<b>Prishtinë</b>	<b>102046</b>	<b>103952</b>	<b>+ 1.8%</b>
<b>Pejë</b>	<b>28926</b>	<b>24859</b>	<b>- 14%</b>
<b>Prizren</b>	<b>8925</b>	<b>10676</b>	<b>+ 16.1%</b>
<b>Mitrovicë</b>	<b>N/A</b>	<b>4589</b>	<b>N/A</b>
<b>Gjilan</b>	<b>10031</b>	<b>9248</b>	<b>- 7.8%</b>
<b>Ferizaj</b>	<b>6815</b>	<b>8578</b>	<b>+ 20.5%</b>

2.13 Një krahasim i vogël në mes Tabelës 2 dhe Tabelës 4 lë të kuptohet se nuk ekziston lidhje direkte në mes të shqiptimit të 'gjobave' dhe numrit të aksidenteve të rënda. Megjithatë regjioni i Ferizajit dhe Prizrenit në mënyrë dramatike kanë shtuar numrin e tiketave të lëshuara për ngasësit, të dy regjionet kanë vërejtur rritje të

<sup>6</sup> Gjatë periudhës raportuese (2005/6) prezentimi i shenjave të trafikut në rrugën Prishtinë - Gjilan dhe futja në përdorim e limitit të peshës në rrugën Pejë – Rugovë ku janë arritur rezultate dhe ku siguria në rrugë dhe në regjion është përmirësuar.

dukshme në numrin e aksidenteve me lëndime në periudhë të njëjtë (shih tabelën 2). Inspektorati Policor i Kosovës është në dijeni për dëshmitë që lënë të kuptohet se sistemi i 'gjobave' ka prirje të jetë i paefektshëm sepse shumë ngasës nuk e paguajnë gjobën<sup>7</sup>.

2.14 Inspektorati Policor mendon se mungesa e qartë e efikasitetit nga shfrytëzimi i 'gjobave' – për sa i përket zvogëlimit të numrit të aksidenteve me lëndime – kërkon një ekzaminim më të detajuar. Natyrisht kjo çështje është jashtë kompetencave të SHPK-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Problemet themelore në sistemin ekzistues të ndëshkimit të ngasësve dhe përmirësimit të standardeve të ngasjes në Kosovë lidhen me të metat në dispozitat e tanishme ligjore lidhur me kundërvajtjet në trafikun rrugor, patentë shoferët, defektet në automjete dhe në sistemin gjyqësor. Inspektorati Policor mbështet një rishikim të përgjithshëm të dobësive të njohura dhe përmirësimeve të mundshme në kornizën ligjore nga ana e SHPK-së, Drejtorati i Politikave për Kryerjen e Punës Policore (Ministria e Punëve të Brendshme), Ministria e Transportit dhe Ministria e Drejtësisë.

#### Rekomandimi kryesor nr. 5

*SHPK-ja këshillohet të filloj një rishikim të sofistikuar të dobësive të njohura dhe përmirësimeve të mundshme në dispozitat ligjore në lidhje me shtimin e masave ndaj kundërvajtjeve të trafikut dhe shtimin e standardeve për vozitje. Ky rishikim duhet të marrë parasysh sistemet e suksesshme të përdorura në pjesët e tjera të Evropës dhe duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoratin e Politikave për Kryerjen e Punës Policore, (Ministria e Punëve të Brendshme), Ministrinë e Transportit dhe Ministrinë e Drejtësisë.*

#### Politika dhe strategjia në kryerjen e detyrave policore në trafikun rrugor

2.15 Ekziston një mungesë konsekuente e dokumenteve të shkruara mbi politikat dhe të ndërlidhura me strategjinë<sup>8</sup> në Menaxhimin e Trafikut Rrugor në të gjitha regjionet e SHPK-së. Inspektorati Policor i Kosovës mendon se mungesa e informacioneve të tilla të menaxhmentit është rezultat i mungesës së trajnimit të komandantëve të lartë në përdorimin e politikave dhe strategjive të shkruara në fushën e menaxhimit të trafikut rrugor. Periudha e rishikimit (2005/'06) ishte periudhë e një tranzicioni të vazhdueshëm nga policia civile e UNMIK-ut tek zyrtarët e lartë të posaçmëruar të SHPK-së, meqenëse nuk ka ekzistuar ndonjë sistem paraprak i krijimit të politikave dhe strategjive në lidhje me kryerjen e detyrave policore në trafikun rrugor, komandantët e ardhshëm të SHPK-së, siç edhe pritet, nuk do të kenë njohuri për këtë mjet të rëndësishëm të menaxhmentit.

2.16 Siç është përmendur edhe në raste të tjera në këtë raport, Inspektorati Policor është në dijeni se detyra për zvogëlimin e vdekjeve dhe aksidenteve në rrugët e

<sup>7</sup> Në gjashtë muajt e parë të vitit 2005 kanë qenë 2383 tiketa gjyqësore të papaguara në regjionin e Ferizajit dhe në periudhën e njëjtë të vitit 2006 kanë qenë 3721 tiketa gjyqësore të papaguara.

<sup>8</sup> Është e rëndësishme që të jetë e qartë se çka IPK –ja mendon me anë të këtyre termeve. Një politikë është një grup ideshë që janë të formuluara si deklarata për veprimin e ardhshëm të SHPK-së në përgjigje ndaj problemeve të njohura për ruajtje të sigurisë në rrugët e Kosovës. Politika e Trafikut Rrugor duhet të tregojë synimet specifike që Njësi Regjional i Trafikut ka për qëllim t'i përmbush gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ndërsa, strategjia është një plan i detajuar për arritjen e këtyre synimeve që janë cekur në dokumentin e politikave. Strategjia e Trafikut Rrugor duhet të ofrojë një udhëzim të detajuar për mbikëqyrësit e trafikut për sa i përket asaj se çka duhet të bëhet, taktikave dhe medova të zgjedhura, si dhe burimeve që do të jenë në dispozicion.

Kosovës nuk i përket vetëm SHPK-së por gjithashtu edhe Ministrisë së Transportit, komunës dhe agjencioneve tjera. Prandaj politikat dhe strategjitë e suksesshme të trafikut rrugor duhet të rezultojnë nga një partneritet në mes të SHPK-së dhe autoriteteve tjera. Secila nga këto autoritete publike duhet të identifikoj synimet specifike për të cilat ata do të jenë përgjegjës dhe masat që ata do të ndërmarrin për t'i arritur këto synime. Përveç kësaj, Politikat dhe Strategjitë e Trafikut Rrugor Regjional duhet të publikohen dhe të jenë plotësisht në qarkullim, me qëllim që të fitojnë mbështetje dhe bashkëpunim nga ana e popullatës.

#### Rekomandimi kryesor nr. 6

*Në rastin e parë që do t'i ipet SHPK-së, duhet të aranzhoj trajnim të përshtatshëm për zyrtarët në pozita udhëheqëse në përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe strategjive të trafikut rrugorë regjional.*

## 2. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Menaxhimi i parkut të automjeteve

### Hyrje

1.1 *Inspektimi i dytë i rëndomtë* është bërë më datën 23 dhe 24 gusht të vitit 2006, sipas Rregullores 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9. Ky inspektim ishte i përqendruar vetëm në kryerjen e detyrës nga menaxhmenti i parkut të automjeteve të SHPK-së dhe është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, ushtrues i detyrës së Shefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit të përbërë nga 19 inspektorë. Vizitat janë bërë në Shtabin e Policisë në Prishtinë dhe në të gjitha shtabet regjionale. Pa përjashtim, inspektorët hasën në bashkëpunim dhe në gatishmëri nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së.

1.2 Parku i automjeteve të SHPK-së është shumë i rëndësishëm dhe paraqet njërën nga investimet më të mëdha kapitale të organizatës. Menaxhmenti i këtij investimi të madh kapital paraqet një sfidë kyqe për ekipin e ri të posa emëruar të zyrtarëve të lartë të SHPK-së dhe nëpunësve civil, pasi që ata i kanë marrë këto përgjegjësi për këtë fushë nga kolegët e tyre të policisë civile të UNMIK-ut. Automjetet e SHPK-së janë njëra nga karakteristikat më të dukshme të një organizate të re: gjendja fizike e automjeteve është një tregues i profesionalizmit të SHPK-së në sy të qytetarëve. Ekziston një interesim i madh i qytetarëve në lidhje me mënyrën se si menaxherët e lartë të SHPK-së e menaxhojnë parkun e automjeteve.

1.3 Përdorimi i automjeteve është shpenzuesi më i madh i burimeve (resurseve) të SHPK-së - e dyta pas kostos së pagave të personelit të SHPK-së. Prandaj nevojitet që një transport policor i sigurt, i besueshëm dhe i fortë të jetë i balancuar me menaxhimin efektiv të këtyre burimeve shumë të shtrenjëta. I tërë personeli i SHPK-së, menaxherët e lartë, personeli mbështetës dhe të gjithë zyrtarët policor që përdorin automjetet, janë të detyruar ta zvogëlojnë koston për taksapaguesin.

1.4 Qëllimi i inspektimit në këtë protokoll është të bëhen rekomandimet se si menaxherët e lartë të SHPK-së do të mund të përmirësonin kryerjen e detyrave (efektshmërinë) në menaxhimin e parkut të automjeteve duke u bazuar në qëllimet në vijim:

- Pëlqimi me standardet relevante brenda Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP),
- Të inkurajohet menaxhimi profesional
- Të ndihmojë në përgatitjen e mundësive transportuese të cilat janë më shumë efektive sipas kostos dhe sa më të sigurt, dhe
- Të Identifikojë dhe përhapë praktikatat më të mira.

1.5 Gjatë periudhës së inspektimit, personeli i IP-së vizitoi dhe intervistoi punëtorët e SHPK-së në vijim:

- Udhëheqësin e SHPK-së për Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse
- Menaxherin e Parkut të Automjeteve të SHPK-së (duke përfshirë edhe vizitat në punëtori)
- Prokurimin e SHPK-së/ udhëheqësi i financave
- Udhëheqësin e Drejtoratit të Trafikut
- Komandantët regjional
- Komandantët e stacioneve (shembuj të rastit)
- Policët e trafikut të SHPK-së (shembuj të rastit)

1.6 Njëpërmas bashkëpunimit të mirë të zyrtarëve të lartë të SHPK-së, Inspektorati Policor ka mbledhur një numër të konsiderueshëm të të dhënave, duke e përdorur protokollin mbi menaxhimin e parkut të automjeteve<sup>9</sup>. Raporti i tanishëm nuk paraqet të gjitha informatat dhe të dhënat e mbledhura gjatë inspektimit, por përqëndrohet në çështje të caktuara të menaxhmentit për të cilat Inspektorati Policor beson se janë sfera të rëndësishme për zhvillime organizative në fushën e menaxhimit të parkut të automjeteve.

1.7 Ky raport është përgatitur në bazë të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës publike e cila është e përfshirë në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. Organizimi i menaxhimit të parkut të automjeteve

2.1 Inspektorati policor me gatishmëri njofton se shumë aspekte të menaxhmentit të parkut të automjeteve të SHPK-së nuk shtrihen në fushën e vendimeve të ndërmarra nga menaxherët e SHPK-së. Këta zyrtarë të lartë dhe shërbyes civil kanë trashëguar një park të automjeteve dhe një sistem të menaxhimit i cili ka rezultuar nga vendimi i marrë nga kolegët e tyre të UNMIK-ut, gjashtë vite më parë. Në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhërësës Administrative 2006/9, Inspektorati Policor momentalisht merret vetëm me kryerjen e detyrave nga ana e menaxhmentit të SHPK-së dhe nuk synon që të shqyrtojë efikasitetin apo vendimet e ndryshme të marra nga personeli i UNMIK-ut.

2.2 Prokurimi dhe mirëmbajtja e parkut të automjeteve të SHPK-së është plotësisht e centralizuar dhe është nën Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse (DSHM), Shtabin e SHPK-së. Përgjegjësia për prokurim dhe financim të parkut të automjeteve bëhet në marrëveshje me udhëheqësin e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe udhëheqësin e Drejtoratit për lidhjen e kontratave. Servisimi dhe mirëmbajtja e parkut është përgjegjësi e menaxherit të parkut të automjeteve i cili është nën Drejtoratin e Logjistikës së DSHM-së.

2.3 Parku i tanishëm i automjeteve të SHPK-së daton që nga viti 2000 dhe prokurimi dhe shpërndarja e tyre ka qenë si rezultat i një sërë vendimesh të ndërmarra nga personeli i UNMIK-ut, brenda gjashtë viteve të fundit. Deri në mars të viti 2006, servisimi dhe riparimi në parkun e automjeteve është bërë nga një kompani private. Si rezultat i mospajtimeve në lidhje me kushtet e kontratës, kjo kompani e ka ndërprerë kontratën brenda një periudhe të shkurtë dhe pa dorëzim-pranim të kënaqshëm. Që nga prilli i vitit 2006, SHPK-ja ka punësuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë 55 punëtorë të cilët punonin për atë kompani private, që kanë qenë të përfshirë në servisimin dhe riparimet e automjeteve.

2.4 Sikurse me kompaninë private, mënyra e servisimeve dhe e riparimeve bëhet në garazhën qendrore në Prishtinë. Këtu përfshihet bartja e automjeteve nga rajonet e tyre operative në garazhën qendrore, për të gjitha format e riparimeve dhe servisimet e rëndomta. Megjithatë, në muajt e fundit, ekipe lëvizëse të mekanikëve me automjete kanë filluar t'i vizitojnë regjionet nga garazha qendrore në mënyrë që të kryejnë riparime dhe servisime relativisht të thjeshta. Inspektorati Policor e

<sup>9</sup> Neni 1(e) i Urdhërësës Administrative 2006/9 e definon termin "protokoll" si udhëzim i shkruar që definon procedurat operative. Përbehet nga një seri e pyetjeve lidhur me temën e menaxhimit (p.sh. Politikat e Menaxhimit të Rrugëve) dhe vepron si udhëzues procedural për një 'inspektim të zakonshëm'.

konsideron këtë iniciativë si një masë e cila e ka zvogëluar koston<sup>10</sup> operative dhe ka ndikuar në zvogëlimin e periudhës kohore për riparime të thjeshta..

2.5 Furnizimi i derivateve për automjetet e SHPK-së bëhet në bazë të një rrjeti të kompanive lokale të derivateve, të cilat i nënshtrohen kontratave të autorizuara dhe proceseve normale të tenderimit.

### 3. Gjendja aktuale e kryerjes së detyrave në parkun e automjeteve

3.1 Buxheti total i SHPK-së për vitin 2006 është mbi 56.8 million EURO: kjo paraqet një zvogëlim të buxhetit për 1.5% në krahasim me buxhetin e vitit 2005. Parku i automjeteve momentalisht ka 1172 automjete dhe kostoja e mirëmbajtjes së parkut përbën 23% të buxhetit të përgjithshëm të SHPK-së, të ndarë për këtë vit. Tabela 1 paraqet një përmbledhje të fondeve të ndara që kanë të bëjnë me përdorimin dhe mirëmbajtjen e parkut<sup>11</sup>. Kostoja e parkut të SHPK-së (13.12 million EURO) është e konsiderueshme, e veçanërisht nëse merret parasysh se kjo shumë përbënë 50% të koston totale të të ardhurave dhe pagave në vitin 2006 (26.5 million EURO apo 46.6% e buxhetit të përgjithshëm). Për funksionimin e çdo automjeti mesatarisht shpenzohen 11,177 EURO në vit apo 931 EURO në muaj.

Tabela 1: Përmbledhje e fondeve të ndara për parkun e automjeteve të SHPK-së – Buxheti i vitit 2006		
	Dobitë dhe shërbimet Milion EURO	Shpenzimet kapitale Milion EURO
Derivatet	5.47	0
Njësiti operativ i parkut	3.47	0.36
Mirëmbajtja e automjeteve	3.21	0.14
Riparimi i automjeteve	0.25	0.22
Nëntotali	12.4	0.72
<b>Totali</b>	<b>13.12</b>	

3.2 Siç shihet në tabelën 2 fondet e ndara për mirëmbajtjen e parkun për vitin 2006 janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme<sup>12</sup>, edhe pse numri i automjeteve nuk është zvogëluar. Kjo pa dyshim ka qenë një pasojë e reduktimit në buxhetin e planifikuar të SHPK-së për vitin 2006. Inspektorati Policor ka vërejtur se ndikimi në zvogëlimin aq të madh të fondeve dukshëm ka zvogëluar në efikasitetin e mirëmbajtjes së parkut. Sipas ushtruesit të detyrës së menaxherit të parkut, në kohën e inspektimit të rëndomtë, 179 automjete - apo 15.2% të numrit të

<sup>10</sup> Sipas ushtruesit të detyrës së menaxherit të parkut ky vendim i menaxhmentit ka rezultuar në ruajtjen e përafërsisht 300 EURO-ve në ditë.

<sup>11</sup> Kostot e treguara në tabelën 1 janë marrë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

<sup>12</sup> Kostot e treguara në tabelën 2 janë marrë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa.



përgjithshëm të automjeteve - ishin në garazhën kryesore në Prishtinë, duke iu nënshtruar servisimit apo riparimit të zakonshëm.

3.3 Pasi që mbi 15% e parkut të automjeteve nuk është në dispozicion për përdorime operative, kjo paraqet një brengë të madhe dhe Inspektorati Policor nxit zyrtarët e lartë që ta adresojnë këtë çështje nëpërmes të politikave të parkut të automjeteve dhe strategjisë që ka të bëjë me të. Siç do të shihet, periudhat e gjata kohore të cilat automjetet i kalojnë në servisim dhe riparim kanë qenë shkaktari kryesor për ankesa në lidhje me automjetet në regjionet e SHPK-së. Inspektorati Policor e kupton se ky është një problem i ndërlikuar, që rezulton nga një numër i faktorëve (p.sh. standardet e dobëta të vozitjes në SHPK, shkalla e shtuar e aksidenteve ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së, automjetet e vjetruara, garazha mirëmbajtëse jo e furnizuar mirë, etj). Një politikë dhe strategji e suksesshme e parkut të automjeteve të SHPK-së duhet të jetë e bazuar në të dhëna të sakta për të gjithë faktorët që kontribuojnë në mosfunksionimin e automjeteve operative dhe në implementimin e politikave të cilat i luftojnë këto shkaqe.

3.4 Në vitin 2006, derivatet paraqesin 41.6% (5.47 million EURO) të kostos së përgjithshme të mirëmbajtjes së parkut të SHPK-së, apo 9.6% të buxhetit total të SHPK-së. Edhe pse kostoja e derivateve përfshinë derivatet për gjeneratorët elektrik, pjesa më e madhe e kësaj kostoje është për derivate të automjeteve. Shtimi i fondeve të derivateve për 14% në vitin 2006 (shih tabelën 2) tregon një planifikim të mirë në pikëpamje të rritjeve dramatike të çmimeve të derivateve në nivel global për vitin 2005 dhe 2006. Njëkohësisht, Inspektorati Policor beson se reduktimi në shpenzimin e derivateve duhet të formojë një qëllim të rëndësishëm në çdo politikë dhe strategji të parkut të automjeteve të SHPK-së.

**Tabela 2: Përmbledhja e fondeve të ndara për parkun e automjeteve të SHPK-së – krahasimi i viteve 2005 dhe 2006**

	2005 Milion EURO	2006 Milion EURO	Krahasimi +/- %
Derivatet	4.81	5.47	+ 14%
Mirëmbajtja e automjeteve	4.87	3.36	- 31%
Riparimi i automjeteve	0.474	0.476	+ 0.5%

3.5 Inspektorati Policor e kupton se numri i aksidenteve në trafikun rrugor, ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së, është shkaku më i madh i brengosjes. Siç shihet në tabelën 3, numri i aksidenteve në trafik ka qenë përafërsisht 1.2 aksidente në ditë, brenda katër viteve të fundit dhe në vitin 2005 është rritur për 1.7 aksidente në ditë<sup>13</sup>. Është vërejtur se numri i aksidenteve të paraqitura në tabelën 3 përfshinë të gjitha llojet e aksidenteve, prej aksidenteve me dëme më të vogla deri te ato me dëme të mëdha, si dhe lëndimet e policëve dhe të qytetarëve tjerë në trafik..

<sup>13</sup> Numri i aksidenteve të treguara në tabelën 3 janë marrë nga Njësia e parkut të automjeteve në Prishtinë.

3.6 Sa i përket aksidenteve në përgjithësi (shih raportin e përkohshëm nr.1) Inspektorati Policor ka gjetur se SHPK-ja ka mungesë të të dhënave analitike në lidhje me faktorët<sup>14</sup> dominues të cilat kanë qenë shkaktarë të aksidenteve në SHPK - si një mjet themelor i menaxhmentit në zhvillimin e strategjisë efikase për t'i zvogëluar aksidentet e tilla. Megjithatë, detyra e identifikimit të faktorëve shkaktarë të këtyllë duhet të realizohet lehtë duke iu referuar raporteve të aksidenteve të cilët janë përgatitur në lidhje me secilin incident. Ekziston marrëveshja e përgjithshme në mes të personelit të lartë të SHPK-së se shumica e aksidenteve të SHPK-së vijnë si rezultat i shkathtësive të vozitjes nën nivelin e duhur të zyrtarëve në fjalë.

Tabela 3: Numri I aksdenteve ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së				
Krahasim vjetor				
Viti	2003	2004	2005	2006
Numri i aksdenteve	444	451	636	223
Mesatarja e numrit të aksdenteve për ditë	1.2	1.2	1.7	0.9

#### Rekomandimi kryesor nr.1

*SHPK-ja nxitet që ta dizajnojë dhe implementojë një sistem të krahasimit të faktorëve të cilët i shkaktojnë aksidentet, nga raportet për hetimin e aksidenteve në lidhje me të gjitha aksidentet ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së. Të dhënat përfundimtare duhet të përdoren nga personeli i lartë që të identifikojnë hapat përkatëse në zvogëlimin e aksidenteve të tilla, si pjesë e një politike dhe strategjie të përgjithshme.*

3.7 Inspektorati Policor ka vërejtur një pakënaqësi të përgjithshme në mesin e komandantëve regjional dhe personelit të shtabit në lidhje me efektshmërinë e procedurave për ballafaqimin me policë të cilët kanë shkaktuar aksidente, me vetëdije apo për shkak të pakujdesisë. Mementalisht, aksidenti ku është i përfshirë një automjet i SHPK-së rezulton në hetimin e aksidentit për trafikun rrugor (ATR) (nga njësia regjionale për aksidente në trafikun rrugor) dhe një hetim tjetër i bërë nga njësiti lokal për standarde profesionale. Si mundësi tjetër që lidhet me vendimin e prokurorit publik janë hetimet e ATR-së të cilat mund të rezultojnë në shpalljen e fajësisë nga ana e gjykatave relevante në përputhje me një ose më tepër kundërvajtje në trafik. Sidoqoftë, sipas zyrtarëve të lartë të intervistuar nga ana e Inspektoratit Policor, shumë rallë ndërmerren masa disiplinore dhe shpesh zyrtarët policorë në fjalë vazhdojnë që t'i ngasin automjetet policore<sup>15</sup>. Gjithashtu, këta

<sup>14</sup> Termi 'faktorë shkaktues' i referohet një faktori i cili është i përcaktuar si një shkak kryesor i aksidentit (p.sh. tejkalimi i shpejtësisë, gabime gjatë vozitjes, kushte të pafavorshme për rrugë, automjetet me defekte), në të vetmuar apo në kombinim me faktorët tjerë dominues.

<sup>15</sup> Duhet përmendur se kjo nuk është konfirmuar nga të dhënat përkatëse të Njesisë së Standardeve Profesionale gjatë rrjedhës së këtij inspektimi të rëndomtë.

zyrtarë rrallë i nënshtrohen ndonjë ndëshkimi financiar për dëme më të mëdha të cilat ia shkaktjnë automjeteve të shtrenjëta policore<sup>16</sup>.

#### Rekomandimi kryesor nr. 2

*SHPK-ja nxitet që të rishikojë procedurat e saj në lidhje me zyrtarët që shkaktjnë dëme në automjetet e SHPK-së, nga pakujdesia ose me vetëdije. Ky proces duhet të jetë në përputhshmëri me dispozitat e reja të Urdhëresës Administrative 2006/9 (shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës policore), dhe marrjen në konsideratë të aplikimit të diskualifikimeve të menjëhershme nga ngasja dhe ndëshkimet financiare përkatëse.*

#### 4. Politika dhe strategjia në menaxhimin e parkut të automjeteve

4.1 Në bazë të pesonelit të SHPK-së të cilët ishin intervistuar, për momentin nuk ekziston ndonjë politikë ose strategji<sup>17</sup> e shkruar në lidhje me parkun e automjeteve të SHPK-së. Siç është cekur më lartë, në paragrafin 2.1, ndoshta është e kuptueshme që gjatë periudhës së vazhdueshme të tranzicionit nga UNMIK-u tek SHPK-ja, nuk ka mungesë të planifikimit zyrtar. Megjithatë, një operacion i cili përbënë 23% të buxhetit vjetor të SHPK-së (duke mos përmendur investimet e konsiderueshme kapitale në vetë parkun e automjeteve) kërkon një politikë të planifikuar në mënyrë të kujdesshme dhe një strategji e cila është e përpiluar për implementimin e kësaj politike. Një numër i çështjeve të tjera por ngushtë të lidhura duhet adresuar në politikën e parkut të automjeteve:

- Numrin e nevojshëm, tipin dhe shpërndarjen e automjeteve në mbështetje operative të SHPK-së, në bazë të formulës së definuar në mënyrë të qartë;
- Program i menaxhuar në lidhje me secilin automjet, nga prokurimi deri në shitjen e fundit, që siguron vlerën maksimale për të hollat e tatimpaguesve në plane afat-gjate;
- Sistem ekonomik dhe efikas të mirëmbajtjes dhe të riparimit i cili i plotëson nevojat operative të SHPK-së në nivel lokal;
- Masat për ta shtuar ndjenjën e 'pronësisë dhe përgjegjësisë' për automjetet e SHPK-së në nivelin regjional; dhe
- Sistemi i rreptë i menaxhimit të ngasësve policor dhe zvogëlimi i aksidenteve dhe dëmtimeve të automjeteve të SHPK-së.

Këto do të diskutohen tani në hollësi

<sup>16</sup> Si shembull, Inspektoratit Policor u janë siguruar dokumentete në lidhje me riparimin e automjetit të SHPK-së, Toyota Land Cruiser (092-KS-418) pas një aksidenti në maj të vitit 2005 kostoja e riparimeve arriti vlerën afër 10,000 EURO.

<sup>17</sup> Është e rëndësishme që të sqarohet se çka IPK-ja nënkupton me këto terme. *Politika* përbënë një strukturë ideshë të cilat janë të formuluara si deklarata rreth veprimeve të synuara të SHPK-së si përgjigje e përdorimit të automjeteve në përmbushjen e objektivave të SHPK-së. *Politika* e parkut të automjeteve duhet të tregojë qëllimet specifike të cilat zyrtarët e lartë relevant kanë për qëllim t'i arrijnë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ndërsa, *strategjia* është një plan i hollësishëm për arritjen e atyre qëllimeve të cilat gjenden në dokumentin e politikave (rregullave). *Strategjia* e parkut të automjeteve duhet t'u sigurojë udhëzime të hollësishme menaxherëve të administratës dhe komandantëve të regjioneve/shtabit në lidhje me atë se çfarë duhet të bëhet, taktikat dhe metodat e preferuara si dhe burimet të cilat janë në dispozicion

**Rekomandimi kryesor nr. 3**

*Këshillohet që SHPK-ja ta inicojë procesin e dizajnit të politikës gjithpërfshirëse të parkut të automjeteve dhe të strategjisë implementuese në lidhje me prokurimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e parkut të tyre të automjeteve. Ky proces dizajnuet duhet të jetë i frymëzuar nga parimi i kostos së efektshmërisë dhe i udhëzuar nga një plan gjithpërfshirës policor, që i njeh anët pozitive dhe kufizimin e automjeteve patrulluese lëvizëse për arritjen e qëllimeve të SHPK-së.*

4.2 Tabela 4 ofron një përmbledhje momentale të shpërndarjes së automjeteve të SHPK-së<sup>18</sup>: Inspektorati e ka vërejtur se asnjëri nga zyrtarët e lartë të cilët janë intervistuar nuk kanë qenë të vetëdijshëm në lidhje shpërndarjen racionale. Politika e parkut të automjeteve duhet t'i drejtojë pyetjet themelore për tipin më të favorshëm të automjeteve për përdorim nga ana e policisë, si dhe numrin dhe shpërndarjen e automjeteve në mënyrë të duhur. Përgjigjet në këto pyetje duhet të bëhen në mbikëqyrje të nevojës për koston minimale operative, si dhe duhet të merren parasysh më shumë përvojat dhe politikat e organizatave policore në vendet fqinje të Ballkanit sesa ato të organizatave me ekonomi të zhvilluar. Është me rëndësi, në lidhje me këtë, se asnjë vend tjetër në regjion nuk ka investuar më tepër në automjetete 'që tërheqin me katër rrota' (4 X 4)<sup>19</sup>: Politikat efektive preferojnë parqe të vogla me vetura standarde të cilat ofrojnë shpenzime më të vogla të derivateve dhe qasje më të lehtë dhe më të lirë për pjesë/servisim (p.sh. Volkswagen Golf).

**Tabela 4: Shpërndarja e automjeteve të SHPK-së (gusht 2006)**

Regjioni	Numri i automjeteve të SHPK-së	Përqindja e totalit
<b>Komanda kryesore (SHQ)</b>	<b>263</b>	<b>23.8%</b>
Prishtinë	198	17.9%
Pejë	132	11.9%
Mitrovicë	121	10.9%
Prizren	137	12.4%
Gjilan	101	9.1%
Ferizaj	75	6.8%
Policia kufitare	69	6.2%
Të tjera	6	0.54%
<b>Totali</b>	<b>1102</b>	

<sup>18</sup> Numrat në tabelën 4 janë marrë nga baza e të dhënave në parkun e automjeteve: është vërejtur se ekziston një mospërputhje në mes të numrit total të automjeteve në bazën e të dhënave (1102) dhe numrit total të automjeteve të dhënë nga ushtruesi i detyrës së menaxherit për parkun e automjeteve.

<sup>19</sup> Mbi 80% të automjeteve janë të modelit 'që tërheqin me katër rrota' (4 X 4), duke i përfshirë edhe Toyota Land Cruisers, Land Rover Defender, dhe kryesisht modeli KIA Sportage dhe Sorento.

4.3 Inspektorati Policor vëren se madhësia ekzistuese e parkut të automjeteve të SHPK-së (1172) mund të dëshmohej si ekonomikisht e paqëndrueshme në plan afatmesëm duke pasur parasysh parashikimet e fundit të të ardhurave vjetore dhe shpenzimet e qeverisë në Kosovë. Shumë zyrtarë të SHPK-së të operativës ngritën zërin e pakënaqësisë rreth numrit të pamjaftueshëm të automjeteve, duke e bazuar këtë mendim në një përpjestim të thjeshtë: numri i automjeteve ndaj numrit të zyrtarëve policor. Siç shihet në tabelën 5, që nga viti 2003 një shumë totale e të hollave, prej 11.19 milion eurosh, është investuar në automjetet e SHPK-së dhe në pjesë për automjete: një shumë prej 6.79 milion eurosh është investuar në blerjen e automjeteve të reja. Politika e parkut të automjeteve duhet të udhëzohet në bazë të nevojës për zvogëlimin e kostos dhe identifikimit të numrit optimal dhe të tipit të automjeteve në bazë të kërkesave operative policore, siç është praktika në Evropën perëndimore dhe në Amerikën veriore. Kërkesat operative lidhen me kërkesat reaktive (numri mesatar dhe lloji i incidentit që kërkon një reagim në lëvizje) dhe kërkesat proaktive (numri mesatar dhe lloji i masave proaktive të aktiviteteve policore për të cilën nevojitet automjeti). Në këtë mënyrë, planet e aktiviteteve policore lokale që përshkruhen në rregullorën 2005/54 do të ofrojnë të dhëna themelore për ata të cilët e përpilojnë politikën e parkut të automjeteve.

**Tabela 5: Investimi kapital në automjetet e SHPK-së (2003 – 2006)**

Viti	Kostoja e pjesëve të automjeteve Milionë EURO	Kostoja prokurimit të automjeteve Milionë EURO	Investimi total Milionë EURO
2003	0.29	4.96	5.25
2004	1.96	0.53	2.49
2005	1.69	1.3	2.99
2006	0.46	0	0.46
<b>Totali</b>	<b>4.4</b>	<b>6.79</b>	<b>11.19</b>

**Rekomandimi kryesor nr. 4**

*Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve, personeli i lartë i SHPK-së këshillohet që të rishikojë madhësinë e parkut të automjeteve, llojet e automjeteve të cilat përdoren dhe shpërndarjen e tyre në mbështetje të masave proaktive dhe reaktive. Duhet të ekzistojnë lidhje në mes të planeve të aktiviteteve policore lokale të përshkruara në rregullorën 2005/54..*

4.4 Politika ekzistuese e SHPK-së përfshinë shfrytëzimin e secilit automjet përderisa ai bëhet ekonomikisht i padobishëm (p.sh. më i vjetër se 7 vite apo me mbi 250.000 km. të kaluara). Është marrë një vendim formal se nuk ka levërdi nga riparimi i automjeteve, dhe pastaj kur automjeti prishet: pjesët e dobishme përdoren në parkun e automjeteve për qëllime të ndryshme dhe çdo mbeturinë e mbetur nga metali

shitet. Rreth 52 automjete të SHPK-së që janë rreth gjashtë vite të vjetra janë procesuar në këtë mënyrë<sup>20</sup>. Inspektorati Policor beson se nga SHPK-ja duhet të merren parasysh politika të tjera, duke i përfshirë edhe ato të përdorura në ekonominë e zhvilluara. Për shembull, nëse rritet niveli i kujdesit ndaj automjeteve të SHPK-së, atëherë mund të konsiderohet si më e leverdishme nëse veturat përdoren vetëm tri vite (ose më së shumti 150 000 km) para se të shiten nëpërmjet ndonjë tenderi publik dhe shuma e parave të fituara shfrytëzohet për financimin e pjesërisht të zëvendësimeve. Një skemë e tillë, që ka të bëjë me çmimin e ulur fillestar dhe shfrytëzimin e garancionit të prodhuesit, mund ta zvogëlojë në masë të madhe koston e parkut në periudhë afatgjate, sipas standardeve të larta

#### Rekomandimi kryesor nr. 5

*Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, personeli i lartë i SHPK-së inkurajohet që të konsiderojë skemat alternative për prokurim dhe largimin e automjeteve nga përdorimi. Duhet të bëhet një studim rreth skemave operative në organizatat tjera policore të cilat mund të sigurojnë kosto me përfitime më të mëdha në periudha afatgjate, sipas standardeve të larta.*

4.5 Inspektorati Policor ka vërejtur një besim të njëanshëm në mesin e zyrtarëve regjional se servisimi, riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të SHPK-së duhet të jetë plotësisht e decentralizuar. Siç është përmendur më lartë, skema e prezentuar kohëve të fundit ku njësitë e mirëmbajtjes mobile ofrojnë riparime dhe servise të thjeshta, ka zvogëluar vonesat dhe është treguar si më e leverdishme në aspektin ekonomik. Inspektorati policor përkrah atë që personeli i lartë i SHPK-së duhet të bëjë një studim të beneficioneve përkatëse- në lidhje me koston dhe shpejtësinë- për të rritur nivelin e decentralizimit të mirëmbajtjes së automjeteve. Një studim i tillë duhet gjithashtu të ketë parasysh mundësitë e ndërlidhjes me kompanitë private dhe duhet të mbështetet në një politikë e cila bazohet në përdorimin e automjeteve rrugore standarde, që janë më të shpeshta në Kosovë dhe ofrojnë pjesë dhe servisim më të lirë (p.sh Volkswagen Golf), siq është diskutuar në paragrafin 4.2.

4.6 Inspektorati Policor ka vërejtur një mungesë të kuptimit të 'pronësisë dhe përgjegjësisë' për parkun e automjeteve të SHPK-së, në nivel lokal ose regjional. Kjo ndoshta është pasojë e menaxhmentit të parkut, të centralizuar në masë të madhe dhe frustrimeve të qarta në lidhje me vonesat në servisim dhe riparim. Edhe pse Inspektorati vërejtë përdorimin e formularëve të pranimit-dorëzimit<sup>21</sup> dhe fletërehistrit të automjeteve<sup>22</sup> si shembuj të praktikës së mirë - gjatë inspektimit - është vërejtur se në shumë automjete mungonin pajisjet themelore dhe kishte shenja të mungesës së standardeve të larta të kujdesit, gjatë përdorimit të tyre. Rritja e kuptimit të 'pronësisë dhe përgjegjësisë' për automjetet e SHPK-së duhet të jetë pjesë e politikës efektive të parkut të automjeteve të SHPK-së - kjo do të ndihmojë në zvoglimin e dëmeve të panevojshme dhe do të rrisë ndjenjën e kujdesit në automjetet të shpërndara në stacionet e veçanta dhe njësitet speciale.

<sup>20</sup> Gjatë inspektimit të rëndomtë 16 automjete (duke filluar nga viti 2000) janë konsideruar të jenë jashtë përdorimit dhe janë çmontuar. 36 automjete tjera janë në pritje të vendimit për çmontim.

<sup>21</sup> Formulari i 'dorëzimit-pranimit' përdoret që të shënohet gjendja e automjeteve të SHPK-së dhe e pajisjeve të saj me rastin e dorëzimit të automjeteve të SHPK-së nga njëri pjesëtar i SHPK-së tek tjetri. Këta formularë kontrollohen nga mbikëqyrësi përkatës.

<sup>22</sup> 'Rexhistri i automjeteve' është një formular i cili ndodhet në çdo automjet të SHPK-së dhe në të cilin shënohen hollësitë e shfrytëzimit të veturës në fjalë, duke përfshirë: datën/kohën, vozitësin, kilometrazha fillestare dhe në mbarim.

**Rekomandimi kryesor nr. 6**

*Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, personeli i lartë i SHPK-së këshillohet që të bëjë një studim të benificioneve përkatëse — në lidhje me koston dhe shpejtësinë - për të rritur nivelin e decentralizimit të mirëmbajtjes së automjeteve. Ky studim duhet të ketë parasysh benificionet e rritjes së kuptimit të pronësisë të parkut të automjeteve të SHPK-së në nivel lokal dhe regjional.*

4.7 Inspektorati Policor nxitë zyrtarët e lartë të SHPK-së që sa më parë që është e mundur, si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të zhvillojë një strukturë masash më efikase për ta luftuar shkallën e lartë të papranueshme të aksidenteve, ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së, duke pasur parasysh rrezikun për jetë, koston e konsiderueshme të taksapaguesve<sup>23</sup>dhe efektet e ndërsjella të imazhit profesional të SHPK-së. Një strategji e tillë duhet të bazohet në të dhënat e arsyeshme analitike rreth shkaktarëve të aksidenteve, masat përmirësuese që kanë të bëjnë me shkaktarët kryesor dhe të përfshijë një procedurë të qëndrueshme për ballafaqimin me zyrtarët të cilët shkatojnë aksidentet në mënyrë të pakujdeshme ose me vetëdije. Më tutje, këshillohet që zyrtarët e lartë të SHPK-së në mënyrë të kujdesshme të konsiderojnë përvojën dhe strategjitë e përdorura nga organizatat tjera policore në Ballkan gjatë zhvillimit të strategjisë për zvoglimin e aksidenteve policore.

**Rekomandimi kryesor nr. 7**

*Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së nxitën të krijojnë dhe implementojnë një sistem më të qëndrueshëm në zvoglimin e numrit të aksidenteve, ku janë përfshirë automjetet e SHPK-së.*

<sup>23</sup> Inspektorati ka dëshmi dokumentuese në lidhje me 40 automjete të SHPK-së (3.41% të parkut të automjeteve të cilat janë shkatërruar në mënyrë të plotë që nga viti 2001

### 3. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Manaxhimi i objekteve të SHPK-së

#### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi i tretë i rëndomtë është bërë më datë 20, 21 dhe 22 shtator të vitit 2006, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresën Administrative 2006/9. Ky inspektim i udhëhequr nga z. Enver Rustemi, ushtrues i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 19 inspektorëve, kishte të bëjë vetëm me menaxhimin e ndërtesave. Vizitat u bënë në Shtabin Qendror në Prishtinë, në të gjitha regjionet dhe në disa stacione policore nëpër Kosovë. Inspektorët hasën në bashkëpunim dhe në gatishmëri nga ana e të gjithë pjesëtarëve të SHPK-së.

1.2 SHPK-ja ka trashëguar një numër të madh të ndërtesave të cilat më parë ishin përdorur nga policia në nivel komunal, krahinor dhe në nivel të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë, para ardhjes së Administratës së Kombeve të Bashkuara sipas RKSKB-së 1244. Edhe pse në sipërfaqe të konsiderueshme, prona e patundshme policore në Kosovë ka pësuar për vite me radhë si rezultat i pakujdesisë dhe mungesës së investimeve. Megjithatë procesi i renovimit dhe modernizimit të stacioneve policore dhe ndërtesave të tjera të SHPK-së ka filluar, kjo përfshinë shpenzime të konsiderueshme dhe në planin afatmesëm do të paraqesë një sfidë të madhe financiare.

1.3 Menaxherët e SHPK-së vazhdojnë të ballafaqohen me kërkesa sfiduese rreth buxhetit të kufizuar gjatë kësaj periudhe kritike të tranzicionit të kompetencave për policinë, nga UNMIK-u tek Ministria e re e Punëve të Brendshme. Në 12-24 muajt e ardhshëm do të përqendrohen më tepër përpjekje në përmirësimin e ndërtesave dhe infrastrukturës policore, në mënyrë që të përmirësohet gatishmëria për punë dhe mënyra e kryerjes së detyrave operative.

1.4 Qëllimi i inspektimeve në këtë inspektim të rëndomtë është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmëria me standardet relevante brenda *Kodit Evropian të Etikës Policore* (KEEP-së);
- Të nxitet menaxhimi profesional i ndërtesave dhe objekteve policore;
- Të ndihmohet përmirësimi i gjendjes së ndërtesave dhe objekteve që përdoren nga zyrtarët SHPK-së, personat e paraburgosur dhe qytetarët tjerë; dhe
- Të identifikohet dhe të shpërndahet praktika më e mirë.

1.5 Gjatë periudhës së inspektimit personeli i IPK-së vizitoi dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Udhëheqësi i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të SHPK-së
- Përfaqësuesi i Drejtorisë për Objekte
- Udhëheqësi i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa



- Udhëheqësi i Drejtorisë për Kontraktim
- Komandantët Regjional
- Intervista me komandantët e stacioneve (shembuj të rastit)
- Vizita në objektet e SHPK-së (shembuj të rastit)

1.6 Nëpërmes një bashkëpunimi të mirë të personelit përkatës të zyrtarëve të lartë të SHPK-së, Inspektorati Policor siguroi një numër të mjaftueshëm të të dhënave, duke përdorur protokollin mbi menaxhimin e objekteve<sup>24</sup>. Ky raport nuk i paraqet të gjitha informatat dhe të dhënat e siguruara gjatë inspektimit, mirëpo përqendrohet në çështjet kryesore të menaxhmentit, e që Inspektorati Policor mendon se janë fusha të rëndësishme për zhvillim organizativ në fushën e menaxhimit të objekteve dhe të ndërtesave.

1.7 Ky raport është i përgatitur në bazë të parimit të përgjegjësisë dhe transparencës ndaj popullatës që përkrahet nga neni 19 i Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. KRYERJA E DETYRAVE NË MENAXHIMIN E NDËRTESAVE

### Aspekti i sfidës së rëndësishme

2.1 Gjatë kohës së inspektimit të rëndomtë është parë se prona e SHPK-së (p.sh. objektet dhe infrastrukturat përkatëse) në përgjithësi është në gjendje të keqe dhe se përfaqëson dobësi të konsiderueshme në organizatën e re policore. Kjo dobësi në organizatë nuk është faji i personelit të ri të caktuar në administratën e SHPK-së apo i administratës së përkohshme të UNMIK-ut; por, gjendja e keqe e ndërtesave policore është si pasojë e historisë së fundit dhe e mungesës së investimeve kapitale në vitet e '90-ta dhe dëmeve të shkaktuara gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s. Që nga viti 1999 nevoja për investime të mëdha kapitale në ndërtesat policore është dashur të garojë me disa kërkesa që kanë qenë më urgjente në burimet e kufizuara të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK), siç janë pagat e policëve, automjetet dhe pajisjet themelore.

2.2 Pra, vetëm në 18 muajt e fundit (apo më pak) ka filluar të investohet ky kapital mjaft i nevojshëm në ndërtimin e ndërtesave të reja dhe renovimin e atyre ekzistuese. Planet afatmesme për buxhet (2007–2009) tregojnë vendosshmërinë që të vazhdohet me një detyrë mjaft të shtrenjtë, të krijimit të pronës policore e cila plotëson nevojat e organizatës së re dhe përmbush kushtet themelore të punës për zyrtarët policor dhe personelin tjetër. Kjo detyrë përfaqëson një rën nga sfidat më të mëdha të menaxhmentit financiar për udhëheqësinë e re të SHPK-së për 3-5 vitet e ardhshme, duke pasur parasysh se të hyrat e Qeverisë ka gjasa të zvogëlohen në masë të konsiderueshme gjatë po kësaj periudhe<sup>25</sup>. Një sfidë e tillë do të kërkojë një nivel të avancuar të kompetencave në planifikimin strategjik për të gjithë zyrtarët përkatës të lartë policorë dhe menaxherët e shërbimit civil.

<sup>24</sup> Paragrafi 1(e) I Urdhërësës Administrative 2006/9 definon termin "protokoll" si një udhëzim me shkrim që definon procedurat operative. Përmban një numër të pyetjeve në lidhje me temat mbi menaxhmentin (p.sh. Kryerja e detyrave policore në trafikun rrugor) dhe vepron si një udhëzues procedural për një 'inspektim të rëndomtë'.

<sup>25</sup> Rapori i shtyllës së BE –së. Ndikimi i "UNMIK-ut në ekonominë e Kosovës", Prishtinë, korrik, 2006.

## 2. Organizimi

2.3 Struktura aktuale e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të ndërtesave është mjaft e centralizuar nën administratën e SHPK-së, në Shtab. Me personelin e përbërë prej 314 personash (policë dhe civilë) që gjenden në Prishtinë dhe në regjione, administrata e SHPK-së është e ndarë në tri departamente kryesore: Departamenti i Shërbimeve Administrative, Departamenti i Trajnimeve dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse. Nën Departamentin e përmendur në fund bën pjesë Drejtorati i Objekteve (ose ndërtesave) me gjithsejt 105 pjesëtarë personel. Drejtorati i Objekteve është një fushë e re dhe në zhvillim, nën kompetencat e menaxhmentit të SHPK-së: ky Drejtorat përbëhet nga një ekip i madh arkitektësh, inxhinierësh dhe specialistë tjerë, dhe ka mundësi që në vitin 2006 numri i personelit të rritet në 165.

2.4 Edhe pse Inspektorati Policor nuk ishte në gjendje që ta gjejë një përshkrim të hollësishëm të strukturës aktuale të Drejtoratit për Objekte, shihet se administrata e SHPK-së mundohet që të zhvillojë dhe mirëmbajë pronën e policisë me anë të përdorimit të personelit të vet sa më shumë që është e mundur. Aktualisht puna ndahet në dy fusha kryesore: në zhvillim dhe mirëmbajtje. Zhvillimi i objekteve të reja të policisë, siç janë ndërtesa e re e Komandës Regjionale në Prizren dhe Baza e Logjistikës në Prishtinë, fillon me përgatitjen e dizajnit dhe hollësive të projektit nga ekspertët në Drejtorinë e Objekteve. Kjo punë formon bazat për kontratën me organizatat e jashtme duke përdorur procesin e zakonshëm i njohur si 'ofertë për tender; pastaj ndërtimi rishikohet dhe inspektohet nga inxhinierët e Drejtoratit për Objekte. Mirëmbajtja dhe renovimi ndahen në dy nivele. Mirëmbajtja rutinore (ose 'niveli i ulët') kryhet nga ana e personelit të Drejtoratit të Objekteve në nivel lokal dhe duke përdorur pajisjet (furnizimet) nga depoja qendrore. Riparimet dhe renovimet më të mëdha bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse puna zhvilluese: dizajni dhe hollësitë nga Drejtorati i Objekteve, ndërlihdja me organizatat e jashtme nëpërmes kontratave dhe mbikëqyrja nga Drejtorati i Objekteve.

2.5 Në kohën kur është bërë inspektimi, SHPK-ja nuk e kishte emëruar drejtorin e Drejtorisë së Objekteve. Në mungesë të menaxherëve, zyrtarët e Inspektoratit Policor janë udhëzuar që të flasin me një arkitekthe, e cila megjithëse shumë e dobishme, ka ngurruar që t'i paraqesë çështjet në lidhje me politikën dhe strategjinë. Mungesa e menaxherëve të kualifikuar dhe me përvojë në këtë fushë të rëndësishme të zhvillimit organizativ paraqet një dobësi të madhe për SHPK-në. Inspektorati Policor vendosmërisht rekomandon që SHPK-ja t'i paraqesë këto dobësi sa më shpejtë që është e mundur.

### Rekomandimi kryesor nr. 1

*SHPK-ja nxitet që ta caktojë një drejtor të kualifikuar për Drejtorinë e Objekteve, sa më shpejtë që është e mundur. Funkzioni i këtij menaxhmenti është vendimtar për suksesin e qëllimeve të SHPK-së, në mënyrë që t'i zhvillojë dhe t'i mirëmbajë ndërtesat adekuate për tërë personelin e SHPK-së në periudhën afatmesme.*

### Gjendja aktuale

2.6 Zyra ligjore e administratës së SHPK-së e ka informuar Inspektoratin Policor për problemet e mëdha në lidhje me gjendjen ligjore të ndërtesave në pronësi apo aktualisht të shfrytëzuara nga SHPK-ja. Katalogu për tokat dhe ndërtesat 'që i takojnë policisë' tregon se ka mjaft ngatërresa në lidhje me pronësinë dhe të drejtat. Gjithsejt janë 110 objekte policore në Kosovë prej të cilave vetëm 45 (40.9%) mund të thuhet se janë pronë e SHPK-së (Ministrisë së Punëve të Brendshme) dhe shumë prej tyre nuk shfrytëzohen nga SHPK-ja. Në disa vende (p.sh. në Mitrovicë dhe në Veri të Kosovës) SHPK-ja është duke shfrytëzuar 'pronat shoqërore', të cilat tani janë nën Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, dhe në disa qendra (p.sh. Gjilan) toka dhe/ose ndërtesat i takojnë komunës. Ka raste kur toka që i takon policisë (Ministrisë së Punëve të Brendshme) është shfrytëzuar për ndonjë ndërtim ilegal<sup>26</sup>.

2.7. Siç është treguar në tabelën nr. 1 Inspektorati Policor vizitoi gjithsejt 18 objekte policore, d.m.th. rreth 54% nga objektet kryesore që aktualisht janë të zëna dhe shfrytëzohen nga SHPK-ja. Ky shembull ofron një vështrim të dobishëm në lidhje me problemet e pronësisë, mungesës së hapësirës dhe gjendjes së keqe të shumë objekteve të SHPK-së. Inspektorët të cilët vizituan ndërtesat panë se dy prej tyre (11.1%) ishin në gjendje shumë të dobët, 3 (16.6%) në gjendje të dobët, 5 në gjendje të kënaqshme (27.7%), 7 (38.8%) në gjendje të mirë dhe vetëm një (5.5%) në gjendje shumë të mirë. Në këtë mënyrë, shumica prej tyre (55.5%) janë në gjendje të kënaqshme ose të keqe. Inspektoratit Policor gjatë intervistave me policët operativ iu bë e ditur se gjendja e këtyre ndërtesave të cilat nuk i plotësojnë standardet e kërkuara dhe atyre në gjendje të keqe, ndikon negativisht në motivin e policëve për punë.

2.8. Shumica e ngatërresave në lidhje me gjendjen e pronës policore është trashëgimi e historisë së fundit në Kosovë. Në disa qytete stacionet e mëparshme policore janë shkatërruar gjatë bombardimeve të NATO-s dhe SHPK-ja ka vazhduar t'i shfrytëzojë këto objekte alternative (qoftë pronat komunale apo shoqërore), të cilat janë marrë në shfrytëzim nga policia civile e UNMIK-ut në vitin 1999. Shumica e atyre stacioneve të mëparshme policore të cilat i kanë shpëtuar bombardimeve të NATO-s janë të vendosura në tokën e komunës për shkak se janë trashëguar nga struktura policore në Republikën Federative të Jugosllavisë, përmes së cilës strukturë policia vepronte në nivelet shtetërore, krahinore dhe komunale. SHPK-ja pajtohet me atë se duhet të bëhen më shumë përpjekje në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të shumta në lidhje me pronën dhe krijimin e objekteve të reja policore si pjesë e strategjisë së saj afatmesme në zhvillimin e një prone policore adekuate nën pronësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

<sup>26</sup> Inspektorati Policor është informuar nga zyra ligjore e administratës së SHPK-së që hoteli 'Victoria', Prishtinë, zë tokën që është 'pronë shtetërore' e që konsiderohet si pronë e Minsitrisë së Punëve të Brendshme.

Tabela 1 Ndërtesat policore të inspektuara nga IPK-ja (Shtator 2006)						
Nr.	Ndërtesa	Pronarët ligjorë	Kati përdhësë (Metër katror)	Numri i personelit	E vizituar nga IPK-ja (Shtator2006)	Gjendja e vlerësuar
1	Ndërtesa e komandës kryesore (Prishtinë)	Shtetëror (Sekretariati i Punëve të Brendshme)	1393.86	N/D	PO	Mirë
2	Stacioni Qendror Prishtinë	Komuna e Prishtinës	1378.12	182	PO	Mirë
3	Stacioni Jugor Prishtinë (Nr. 4)	Kompania e KEK-ut	376	200	PO	Shumë dobët
4	Stacioni - Fushë Kosovë	Komuna e Fushë Kosovës	439.87	76	PO	Dobët
5	Stacioni në Obiliç	Komuna e Obiliqit	8322.00, (me tokë)	83	PO	Mirë
6	Komanda regjionale-Mitrovica	Komuna e Mitrovicës	555.76	185	PO	Kënaqshëm
7	Komanda regjionale-Pejë	Komuna e Pejës	N/D	N/D	PO	Kënaqshëm
8	Stacioni qendror-Deçan	SHPK	N/D	91	PO	Mirë
9	Stacioni qendror Gjakovë	Auto-shkolla	N/D	N/D	PO	Shumë dobët
10	Komanda regjionale dhe stacioni qendror Gjilan	Komuna e Gjilanit	1200	452	PO	Dobët
11	Stacioni qendror në Novobërdë	Komuna e Novobërdës	240	35	PO	Kënaqshëm
12	Stacioni qendror në Kamenicë	Komuna e Kamenicës	1260	162	PO	Shumë mirë
13	Komanda regjionale - Ferizaj	Shtetëror (Ministria e Punëve të Brendshme)	564	89	PO	Mirë
14	Stacioni qendror - Ferizaj	Shtetëror (Ministria e Punëve të Brendshme)	564	199	PO	Mirë
15	Stacioni qendror-Shtime	SHPK	192	78	PO	Kënaqshëm
16	Komanda regjionale -Prizren	AKM-së	820	189	Po	Mirë
17	Stacioni qendror-Prizren	SHPK	960	231	Po	Kënaqshëm
18	Stacioni policor - Suharekë	SHPK	700	128	Po	Dobët

Notimi: Shumë dobët – Dobët – Kënaqshëm – Mirë – Shumë mirë

2.9 Sipas Drejtoratit të Objekteve nuk ekziston ndonjë politikë për sigurimin e ndërtesave të SHPK-së kundër rrezikut nga zjarri. Inspektorati Policor gjithashtu vërejtë se niveli i standardeve për mbrojtjen nga zjarri në ndërtesat e SHPK-së është nën nivelin e duhur. Pajisjet për siguri nga zjarri janë të pamjaftueshme, aparatet e zjarrit - nëse ekzistojnë - shpesh nuk i nënshtohen inspektimeve/kalibrimeve rutinore, si dhe gjithashtu nuk bëhet asnjë stërvitje për mbrojtje nga zjarri (p.sh. për të siguruar se personeli di të dalë nga ndërtesa shpejt dhe sigurt në raste zjarri). Për shkak se shumë policë janë duke i shfrytëzuar ndërtesat të cilat nuk kanë qenë të parapara për përdorim nga ana e policisë dhe /ose janë në gjendje të keqe, kjo mungesë e menaxhimit për mbrojtje kundër zjarrit krijon rrezik të konsiderueshëm për punonjësit policor.

#### Rekomandimi kryesor nr. 2

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që urgjentisht t'i rishikojnë standardet për mbrojtje nga zjarri në të gjitha stacionet policore, me qëllim të futjes në përdorim dhe mirëmbajtjes së pajisjeve për mbrojtje nga zjarri si dhe stërvitjet e rregullta të personelit.*

2.10 Inspektorati Policor vërejtë se në asnjë stacion policor nuk ekzistojnë objekte të duhura për çlodhje (pushim). Ankesa e përbashkët në mes të policëve të të gjitha gradave ishte mungesa e bufësë në ndërtesat policore. Përkundër kërkesave të shpeshta, administrata e SHPK-së ka refuzuar lejen për të krijuar ndërtesa të këtitilla, edhe atëherë kur ka hapësirë të mjaftueshme, e po ashtu edhe në raste të propozimit të planit për vetfinancim, si pjesë e kërkesës së tyre. Inspektorati Policor përkrahë idenë që politika ekzistuese në lidhje me mensat të rishikohet nga ana e zyrtarëve të lartë. Një masë e tillë do ta përmirësojë moralin e policëve për punë, do ta ndihmojë SHPK-në në përshtatjen ndaj legjislacionit të ri i cili ndalon pirjen e duhanit në vende publike (shih nenin 13.7(e), UA 2006/9) dhe të përfundojë imazhin negativ të qytetarëve ndaj policëve të uniformuar të mbledhur nëpër kafeteri.

#### Rekomandimi kryesor nr. 3

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së inkurajohen të rishikojnë politikën e cila aktualisht pengon hapjen e menseve nëpër stacionet policore, si mënyrë e përmirësimit të moralit të policëve për punë dhe zvogëlimin të imazhit negativ për policët e mbledhur në kafeteri.*

Tabela 2						
Shpenzimet e shërbimeve themelore komunale në regjione – krahasimi i viti 2005 me vitin 2006 (1,000 Euro) <sup>27</sup>						
Regjioni	2005 (Janar – Dhjetor)			2006 (Janar – Korrik)		
	Uji	Telefoni	Mbeturinat	Uji	Telefoni	Mbeturinat
Prishtinë	129.9	96.8	20.4	66.0	N/D	13.3
Pejë	6.8	13.9	8.1	4.2	N/D	5.1
Mitrovicë	7.1	10.9	8.9	5.1	N/D	8.5
Prizren	13.2	23.1	7.2	4.8	N/D	3.1
Gjilan	4.2	43.3	4.7	1.9	N/D	1.7
Ferizaj	2.0	22.1	8.1	1.6	N/D	5.1
Policia kufitare	3.6	N/K	7.6	0.3	N/D	3.8
Gjithsejt	167.3	211.3	65.4	84.3	157.6	41.0

2.11 Tabela nr. 2 ofron një analizë të shkurtë për disa shpenzime komunale themelore të bëra në ndërtesat policore në tërë Kosovën. Ekzistojnë dy fusha të mëdha brengosëse. Së pari, shpenzimet e furnizimit me ujë për regjionin e Prishtinës janë shumë më të mëdha se sa shpenzimet e furnizimit me ujë nëpër regjionet tjera dhe paraqesin 29% të shpenzimeve të përgjithshme të furnizimit me ujë dhe shpenzimeve të telefonit për tërë organizatën, për vitin 2005! Një gjë shumë interesante është që faturat e furnizimit me ujë janë më të larta sesa faturat telefonike në regjionin e Prishtinës në vitin 2005. Edhe pse lejohet për një numër më të madh të personelit, prapeseprapë shpenzimet janë jashtëzakonisht të tepruara dhe kërkohet një hetim i menjëhershëm nga administrata e SHPK-së në lidhje me gabimet e mundshme në faturim ose në matës. Së dyti, shpenzimet e përgjithshme për telefon në gjashtë muajt e parë të vitit 2006 (157, 600 Euro) paraqesin një rritje prej 47.7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2005 (75,200 Euro). Kjo është një fushë brengosëse dhe gjithashtu kërkon një hetim të mëtutjeshëm nga ana e administratës së SHPK-së, në lidhje me politikat për përdorimin e telefonave dhe metodat e përmirësuara për ndalimin e keqpërdorimit të këtyre burimeve të shpenzimeve.

#### Rekomandimi kryesor nr. 4

*Administrata e SHPK-së nxitet të fillojë një hetim të plotë për faturat tejet të mëdha të ujit në regjionin e Prishtinës si dhe rritjen alarmuese të shpenzimeve të telefonit në SHPK.*

<sup>27</sup>Të dhënat e marrura nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, Administrata e SHPK-së, shtator 2006.

## Politika dhe strategjia

2.12 Inspektorati Policor është në dijeni se ekziston një strategji e përgjithshme e SHPK-së në lidhje me krijimin e stacioneve të reja policore dhe objekteve të posaçme specializuere si dhe renovimin e objekteve policore ekzistuese. Megjithatë, është po aq e qartë se kjo strategji nuk është artikuluar në mënyrë të plotë në një dokument të vetëm ose nuk i është komunikuar qartë komandantëve regional dhe personelit të tyre. Megjithëse, Inspektoratit Policor i është ofruar një numër dokumentesh të cilat numërojnë ndarjen e buxhetit për kontratat në lidhje me ndërtime dhe riparime për periudhën 2005 – 2009 (siç është përmbledhur në tabelën 2), nuk ka gjetur ndonjë dokument i cili do të ofronte shpjegime të hollësishme. Posaçërisht, ekziston një mungesë e kriterëve për prioritizimin e punës, standardeve minimale në lidhje me hapësirën e punës për punonjësit, masat për mbrojtje kundër zjarrit dhe kushtet specifike për stacionet policore. Inspektorati këshillon SHPK-në që të plotësojë këtë hapësirë në strategjinë ekzistuese të menaxhimit të ndërtesave dhe të sigurojë që kjo t'iu komunikohet në mënyrë përkatëse komandantëve regionalë.

Tabela 3

Buxheti për ndërtim dhe renovim <sup>28</sup>

2005 (Milion EURO)	2006 (Milion EURO)	2007 (Milion EURO)	2008 (Milion EURO)	2009 (Milion EURO)
2.33	2.5	2.22	2.21	0.72

### Rekomandimi kryesor nr. 5

*Inspektorati këshillon SHPK-në të zhvillojë një dokument të plotë për strategjinë e menaxhimit të ndërtesave dhe të sigurojë se kjo strategji i komunikohet në mënyrë përkatëse komandantëve regionalë. Ky dokument duhet të përfshijë kriterin për prioritizimin e punës, standardet minimale në lidhje me hapësirën e punës për punonjësit, masat për mbrojtje kundër zjarrit dhe kushtet specifike për stacionet policore.*

2.13 Inspektorati Policor vërejti një ankesë të shpeshtë në mesin e personelit regional për faktin se nuk janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me ndërtimin e objekteve të reja dhe renovimin e objekteve ekzistuese. Si shembull është plani i dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesës së re për komandën regionale në Prizren në të cilin plan janë përfillë pak ose fare sugjerimet e personelit, të cilët do ta shfrytëzojnë atë objekt. Paavrësisht nga anët pozitive dhe ato negative të përgjithshme të një sistemi mjaft të centralizuar të menaxhimit të ndërtesave, mungesa e konsultimeve në mes të 'grupeve kryesore shfrytëzuese' është e panevojshme dhe ka tendencë të rezultojë në sigurimin e hapësirës e cila nuk i plotëson nevojat aktuale të personelit në regjione Inspektorati Policor nxit administratën e SHPK-së që të përfshijë në mënyrë të plotë personelin nëpër regjione, në procesin e planifikimit të objekteve të reja dhe renovimin e ndërtesave ekzistuese.

<sup>28</sup> Të dhënat e siguruar nga drejtorati për objekte, shtator, 2006

**Rekomandimi kryesor nr. 6**

*Inspektorati Policor nxit administratën e SHPK-së që të përfshijë në mënyrë të plotë personelin nëpër regjione në procesin e planifikimit të objekteve të reja dhe renovimin e ndërtesave ekzistuese në kuadër të sferës së tyre komanduese.*

2.14 Me marrjen e kompetencave të plota mbi policinë në Kosovë, SHPK-ja ka krijuar pasuri në vlerë prej miliona eurosh: nga ndërtesat deri tek kompjuterët, nga automjetet deri te gjeneratorët, një shtrirje e gjërë e kësaj prone është e shpërndarë nëpër tërë organizatën. Përdorimi i këtyre burimeve nga Prokurimi deri te shpërndarja finale, kërkon një sistem menaxhimi të planifikuar me kujdes. Inspektorati Policor e vlerëson 'Menaxhimin e pronës për shtabin regjional dhe stacionet' (SHPK: 9 korrik 2006) si një kornizë procedurale për përkujdesje të duhur dhe menaxhimin e të gjitha objekteve të vlerësuara me vlerë prej më shumë se 500 Euro, duke përdorur modelin e 'ciklit jetësor'. Ky dokument i shkruar si udhëzues mbi menaxhmentin është një shembull i praktikës më të mirë në menaxhmentin e SHPK-së.

2.15 Kanë mbetur të bëhen edhe shumë gjëra në lidhje me implementimin e sistemit të përshkruar në dokumentin 'Menaxhimi i pronës për shtabin regjional dhe stacionet' dhe Inspektorati Policor dëshiron të shoh se si do të zhvillohet procesi i ri në vitin 2007. Inspektorati Policor në veçanti mirëpret përqendrimin e këtij dokumenti në menaxhimin e decentralizuar të pronës. Me implementimin e tij, komandantët regjional do të mbajnë përgjegjësinë për 'operim dhe mirëmbajtje' të të gjitha pronave regjionale<sup>29</sup> dhe kjo mund të ketë një shtrirje të konsiderueshme në kuptim të marrjes së vendimeve në nivel regjional në lidhje me ndarjen e buxhetit, mirëmbajtjen dhe renovimin e ndërtesave dhe sigurimin e pajisjeve.

<sup>29</sup> 'Menaxhimi i pronës për shtabin regjional dhe stacionet', SHPK, korrik, 2006, faqe 7.



## 4. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Arrestimi dhe ndalimi

### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi I katërt I rëndomtë I SHPK-së u krye me 18, 19, dhe 20 tetor të vitit 2006, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqëndrua vetëm në kryerjen e detyrave nga ana e menxhmentit për arrestim dhe ndalim dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rrustemi, ushtrues I detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit policor të Kosovës dhe ekipit prej 19 inspektorëve. Janë vizituar të gjitha komandet regjionale dhe një numër I stacioneve policore nëpër tërë Kosovën. Poashtu u vizituan edhe një numër I dhomave për ndalim policor. Pa përjashtim, inspektorët hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë të SHPK-së për të ndihmuar.

1.2 Në përgjithësi Inspektorati policor vërejt se menaxhimi I personave të ndaluar – në bazë të ligjit të aplikueshëm – është një fushë për të cilën pjesëtarët e SHPK-së duhet të bëjnë më shumë përpjekje. Duke përdorur kornizën ligjore të definuar në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (2004), SHPK-ja aktualisht demonstroi një pajtueshmëri të plotë me ligjin dhe standardet ndërkombëtare, në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar. Sidoqoftë, duhet të punohet më shumë në menaxhimin, organizimin dhe përmirësimin e objekteve për ndalim.

1.3 Inspektorati vërejt se ndalimi policor në të kaluarën ka qenë temë e raporteve të OSBE-së dhe se shumica e rekomandimeve nga këto raporte janë përfillur. Pavarësisht nga rekomandimet e mëparshme të OSBE-së, ende vërehet mungesa e njëtrajtshmërisë në përdorimin e formularëve procedural, standardeve operative dhe atyre për trajnimin e personelit. Inspektorati policor mendon se përmirësimi I kryerjes së detyrave në këtë fushë të rëndësishme mund të arrihet relativisht lehtë dhe- si pjesë e strategjisë më të gjërë për përmirësimin e objekteve policore – me shpenzime relativisht të vogla në një periudhë afatmesme. Në lidhje me këtë, Inspektorati policor përgatiti një listë të rekomandimeve kryesore të krijuara për të ndihmuar zyrtarët e lartë policor në përmirësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave.

1.4 Qëllimi I këtyre inspektimeve të rëndomta është të bëhen rekomandimet për atë se si menaxherët e SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- Pajtueshmërinë me standardet relevante brenda Procedurës së përkohshme penale të Kosovës dhe dispozitave tjera të ligjit të aplikueshëm.;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Për përkrahjen e menaxhimit profesional të personave të cilët iu kanë nënshtruar arrestimit dhe ndalimit policor;
- Për të ndihmuar në përmirësimin e kualitetit të ndërtesave dhe objekteve për personat e ndaluar, për personelin e SHPK-së dhe pjesëtarët tjerë të popullatës; dhe
- Për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mirë.

1.5 Gjatë inspektimit, personeli I Inspektoratit policor vizitoi dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Komandantët regional dhe/ose zëvendës komandantët
- Komandantët e stacioneve dhe/ose zëvendës komandantët (RASTËSISHT)
- Intervistat me personelin e SHPK-së për ndalim policor (RASTËSISHT)
- Vizitat në 'dhomat e ndalimit' të SHPK-së (RASTËSISHT)
- Intervistat me personat e ndaluar nga ana e SHPK-së (RASTËSISHT)

1.6 Nëpërmes një bashkëpunimi të mirë të personelit të lartë përkatës të SHPK-së , Inspektorati policor grumbulloi një numër të konsiderueshëm të të dhënave, duke përdorur protokollin mbi menaxhimin e arrestimit dhe ndalimit<sup>30</sup>. Ky raport nuk l paraqet të gjitha informatat dhe të dhënat e mbledhura gjatë inspektimit, mirëpo përqëndrohet në çështjet e caktuara kryesore për të cilat Inspektorati policor l konsideron si fusha të rëndësishme për zhvillimin organizativ në fushën e menaxhimit të arrestimit dhe ndalimit.

1.7 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike l cili parim është l mbështetur nga neni 19 l Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. KRYERJA E DETYRAVE NGA ANA E MENAXHMENTIT TË NDALIMIT

### Organizimi

2.1 Ky inspektim është l përqëndruar vetëm në 'ndalimin policor', siç është e definuar në nenin 211 dhe 281 të *Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (tani e tutje 'Kodi')*. Mirëpo, ky inspektim nuk ka të bëjë me autorizimet e gjykatës për caktimin e paraburgimit apo burgimit. Kodi përmban dispozitat e detajizuara për bazat dhe kushtet e ndalimit policor si dhe të drejtat e personave të ndaluar gjatë ndalimit. Ndalimi policor nuk mund të kalojë periudhën kohore prej më shumë se 72 orë nga koha e arrestimit (çdo 24 orë në raste me të miturit), pas së cilës periudhë kohore policia duhet ta lirojë të ndaluarin, vetëm nëqoftëse gjykatësi l procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.

2.2 Sikurse është praktikuar para vitit 1999, çdo stacion kryesor l SHPK-së ka një numër të caktuar dhomash ndalimi ose 'qeli' për qëllim të ndalimit të personave deri në 72 orë. Menaxhimi ditor i këtyre dhomave të ndalimit është përgjegjësi e komandantit të stacionit përkatës, në pajtim me Kodin dhe Parimet dhe Procedurat e SHPK-së. Ndonëse përdorimi l politikave dhe procedurave të centralizura implikon një përpjekje drejt njëtrajtshmërisë së praktikave dhe standardeve, Inspektorati policor vërejt se – në praktikë- mungon njëtrajtshmëria në aplikimin e procedurave. Mungesa e njëtrajtshmërisë në veçanti është evidente në përdorimin e formularëve të ndalimit: secili regjion përdor formularë të ndryshëm dhe në disa raste, në një regjion përdoret më shumë se një lloj formulari.

<sup>30</sup> Neni 1(e) i Urdhërësës Administrative 2006/9 definon termin "protokoll" si një udhëzues i shkruar që definon procedurat operative. Përbëhet nga një varg pyetjesh mbi temën e menaxhmentit (p.sh kryerja e detyrave në trafikun rrugor) dhe vepron si udhëzues procedural për një "inspektim të rëndomtë".

**Rekomandimi kryesor nr. 1**

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që urgjentisht të unifikojnë procedurat dhe formularët shoqërues për ndalim policor, me qëllim të ofrimit të standardeve të njëjta në tërë Kosovën.*

2.3 Në të vërtetë caktimi i punonjësve të SHPK-së në detyrë në dhomat e ndalimit bëhet në baza *ad hoc*. Mbikqyrësit e ndërrimit (ose 'udhëheqësit e ekipit') zgjedhin policët patrullues të uniformuar nga një grup I policëve në dispozicion për detyra patrulluese rutinore dhe I cakton ata në detyrë në dhomat e ndalimit në baza ditore. Nuk kërkohet ndonjë trajnim paraprak. Qarkullimi I madh I personelit dhe mungesa e trajnimit kontribon në perceptim të pjesëtarëve të SHPK-së se detyrat e përkujdesjes ndaj personave të ndaluar janë të 'prioritetit të ultë'. Këtë perceptim edhe më shumë e rritë gjendja e keqe e dhomave të ndalimit në shumicën e stacioneve policore. Inspektorati policor vërejtë se disa dhoma të caktuara të ndalimit policor nuk përdoren për shkak se ekipi i OSBE-së për monitorim i ka vlerësuar ato si të papërshtatshme për përdorim<sup>31</sup>.

**Gjendja aktuale**

2.4 Tabela 1 ofron një analizë të kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së për arrestimin dhe ndalimin policor gjatë viteve të fundit. Për t'u habitur, kjo tregon një numër të vogël arrestimesh. Të dhënat tregojnë numrin e arrestimeve- që është një tregues kryesor efikas – dhe kërkesat aktuale për hapësirat e ndalimit nëpër të gjitha regjionet. Për shkak të dendësisë së madhe të popullsisë, regjioni i Prishtinës, ka numrin më të madh të personave të arrestuar (mesatarisht 4.3 në ditë), e pastaj Peja (3.2 në ditë), Prizreni (2.4 në ditë), Mitrovicë (1.9 në ditë), Gjilan (1.9 në ditë) dhe Ferizaji (0.4 në ditë). Në një ditë mesatare në Kosovë, vetëm 14.1 persona arrestohen dhe i nënshtrohen ndalimit policor. Kjo paraqet përafërsisht një person të arrestuar dhe i cili i nënshtrohet ndalimit policor në 500 policë, në një ditë mesatare në Kosovë. Inspektorati policor vërejtë se gjatë vitit 2005 nuk është ditur numri i saktë i personave të arrestuar si pasojë e urdhëresave të gjyqit dhe udhëzimeve të prokurorit publik.

2.5 Të dhënat në tabelën 1 gjithashtu tregojnë një model jo të zakonshëm në lidhje me kryerjen e detyrave policore. Nuk është e qartë pse Gjakova arrin mesataren prej 1.5 persona të arrestuar në ditë (10.6%), përderisa qyteti i Mitrovicës vetëm 1.2 në ditë (8.5%). Gjatë dhjetorit të vitit 2006, Inspektorati Policor do të ekzaminojë kryerjen e detyrave të menaxhmentit të hetimeve të krimit nëpër të gjitha regjionet dhe do të kërkojë korrespondencë në mes të shkallës së arrestimeve policore dhe shkallës së krimit.

2.6 Kushtet e dhomave të ndalimit policor dhe objekteve përkatëse janë në përgjithësi të dobëta dhe kjo qartë është si rrjedhojë e kushteve të këqija në shumë stacione policore (shih Raportin e Përkohshëm nr. 3 – Kryerja e detyrave nga ana e menaxhmentit të ndërtesave). Tabela 2 ofron një përmbledhje të shkurtë të lokacionit dhe gjendjes së dhomave të ndalimit në tërë Kosovën. Pothuajse në të gjitha rastet dhomat e ndalimit- nëse shfrytëzohen- nuk do të plotësonin standardin minimal prej

<sup>31</sup> Inspektorati u informua se në Vushtrri dhe Podujevë janë mbyllur të gjitha dhomat e ndalimit për shkak se konsiderohen si të papërshtatshme si dhe gjithashtu janë mbyllur edhe dy dhoma të ndalimit në stacionin 'A' në Prizren, për arsye të njëjta.

7 m<sup>2</sup> per person<sup>32</sup>. Në kuptim të gjendje së përgjithshme, Inspektorati vërejti një fotografi të përzier. Në 19 vendet për ndalim të cilat u vlerësuan nga zyrtarët e IPK-së, 36% (7) u vlerësuan si shumë të dobëta, 21% (4) si të dobëta, 10.5% (2) të kënaqshme, 15.7% (3) si të mira dhe 15.7% (3) si shumë të mira. Pasi që shumica (68.4%) janë vetëm të kënaqshme apo më të këqija, Inspektorati policor rekomandon se ky aspekt i kryerjes së detyrave policore është konsideruar si një çështje prioritare nga ana e zyrtarëve të lartë të SHPK-së për periushën e ardhshme 12- mujore.

Tabela 1							
Numri I personave të cilët u nënshtrohen 'ndalimit policor nga regjioni/stacioni – 2002 dhe 2006							
Regjioni	Stacioni	2002	2003	2004	2005	Mesatarja e personave në ditë (2005)	2006 <sup>33</sup>
Prishtinë	Qendra	1553	2138	1790	1595	4.3	1306
Pejë	Pejë	414	459	231	220	0.6	192
	Gjakovë	407	926	561	562	1.5	417
	Deçan	-	-	-	149	0.4	113
	Istog	-	-	-	123	0.3	60
	Kline	64	101	122	116	0.3	110
<b>Totali</b>		-	-		1170	3.2	
Mitrovicë	Jug	-	-	156	263	0.7	204
	Veri	-	99	146	201	0.5	172
	Vushtrri	18	132	139	198	0.5	57
	Skenderaj	149	116	66	27	0.07	-
	Leposaviq	20	35	33	31	0.08	14
	Zubin Potok	-	-	-	-	-	25
<b>Totali</b>					720	1.9	

<sup>32</sup> Komisioni për parandalimin e torturës (KPT), (1991) raporti I dytë I përgjithshëm, Para 43.

<sup>4</sup> Këto shifra I referohen periudhës prej janarit deri në tetor të vitit 2006

Tabela 1 - vazhdim							
Numri I personave të cilët iu nënshtrohen 'ndalimit policor nga regjioni/stacioni – 2002 dhe 2006							
Regjioni	Stacioni	2002	2003	2004	2005	Mesatarja e personave në ditë (2005)	2006 <sup>34</sup>
Prizren	Suharekë	-	-	-	-	-	50
	Malishevë	-	-	-	-	-	21
	Rahovec	173	282	284	135	0.3	182
	Dragash			67	40	0.1	26
	Prizren			657	729	1.9	565
<b>Totali</b>					904	2.4	
Gjilan	Gjilan	802	781	721	718	1.9	383
	Kamenicë	-	-	-	-	-	26
	Vitia/Vitina	-	-	-	-	-	51
<b>Totali</b>					718	1.9	
Ferizaj	Kaçanik	71	153	197	149	0.4	187
	Shtime	-	-	-	-	-	
	Shtërpcë	-	-	-	-	-	
<b>Totali</b>					149	0.4	-

<sup>34</sup> Këto shifra i referohen periudhës prej janarit deri në tetor të vitit 2006

2.7 Pothuajse në të gjitha fushat, Inspektorati policor vërejtí nevojën për investime më të mëdha në objektet për ndalim policor me qëllim të plotësimit të standardeve ndërkombëtare<sup>35</sup>. Niveli I kushteve për pastrim rutinor është I ulët dhe hapësirat e ndalimit në shumicën e rasteve nuk janë të ventiluara mirë dhe/ose nuk kanë ngrohje përkatëse. Në shumë vende, të ndaluarit shfrytëzojnë shtretërit me korniza të hekurta app nga druri<sup>36</sup>, dyshekë dhe mbulesa të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e të ndaluarve dhe vetë personelit të SHPK-së. Në një stacion, Inspektorët vërejtën se të ndaluarit mbahen në dhoma me dyer 'me grila' e në të njëjtin vend gjenden edhe toaletët, që do të thotë se personat e ndaluar nuk kanë privatitet përderisa e përdorin toaletin. Në shumë vende, hapësirat për ndalim nuk janë të sigurta si për të ndaluarit ashtu edhe për personelin e SHPK-së dhe nuk iu mundësojnë hetuesve të SHPK-së që t'i ndajnë të ndaluarit në mënyrë që ta parandalojnë mundësinë për marrëveshje të fshehta gjatë hetimit. Në disa stacione, të ndaluarit dhe personeli I SHPK-së duhet ta përdorin tualetin e njejte pa ndonjë hapësirë të posaqme për mbajtjen e higjienës personale.

2.8 Sigurimi i ushqimit dhe pijeve për personat e ndaluar është kontradiktor, në kuptim të mjeteve financiare dhe standardeve. Në disa stacione policore ushqimi sigurohet nga restorantet lokale duke përdorur mjetet nga 'peti kesh', e në disa vende tjera ushqimi sigurohet nga komuna përkatëse. Ndonëse Inspektorati policor nuk u njoftua për ndonjë ankesë në lidhje me ushqimin nga ana e të ndaluarve, ekziston një brengë lidhur me atë se aranzhimi aktual 'ad hoc' nuk I plotëson nevojat për standardet minimale.

2.9 Menaxhimi i dosjeve të ndalimit dhe pronës personale të të ndaluarve është e ndryshme nëpër tërë Kosovën. Dosjet e ndalimit në shumë vende vendosen vetëm në libra me lidhje dhe nëpër raftet në vend që të vendosen në ndonjë vend të sigurtë. Në shumicën e vendeve nuk bëhen kopjet e dosjeve të ndalimit dhe nuk ekzistojnë masa paraprake në rast të humbjes ose shkatërrimit të formularëve origjinal të ndalimit. Në disa vende prona personale e të ndaluarve nuk sigurohet në sirtar të mbyllur (blokuar) ndërsa në disa vende vendosen në dollap të mbyllur. Inspektorati policor beson se një praktikë e tillë nuk siguron në mënyrë përkatëse që paratë e gatshme dhe gjësendet me vlerë sigurohen.

#### Rekomandimi kryesor nr. 2

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të rishikojnë procedurat dhe politikat aktuale me qëllim të rritjes së sigurisë së dosjeve të ndalimit dhe pronës personale të personave të ndaluar.*

<sup>35</sup> Referenca është marrë nga raporti I dytë I përgjithshëm, paragrafi 42, I Komisionit për parandalimin e torturës (KPT)(1991): "... Të gjitha qelitë policore duhet të jenë të madhësisë së arsyeshme për numrin e personave si dhe të kenë ndriçim adekuat (p.sh ndriçim të mjaftueshëm për lexim, duke përjashtuar periudhën e fjetjes) dhe ventilim; preferohet që qelitë të kenë dritë natyrore. Gjithashtu, qelitë duhet të jenë të pajisura me orëndi për pushim (p.sh karrigë ose ulëse të fiksuar), dhe personat që duhet të qëndrojnë brenda natës në paraburgim duhet të pajisen me dyshekë dhe mbulesa të pastërta. Personat në paraburgim duhet të kenë të drejtë në nevoja natyrore, kur është e nevojshme, në gjendje të pastërt dhe të përshtatshme e poashtu edhe në hapësirat për pastrim përkatës. Atyre duhet t'u ofrohet ushqimi në khë të duhur, përfshirë së paku një racion të plotë (që do të thotë diçka më ushqyese se sendviçi) për çdo ditë (KPT gjithashtu thekson se personave të mbajtur në paraburgim policor për 24 orë apo më shumë duhet që sa më shumë që është e mundur t'iu lejohen aktivitetet në hapësirë të hapur, për çdo ditë.)"

<sup>36</sup> Inspektorati vërejtí se disa korniza nga druri kanë gozhda të dalura mbi kornizë në atë mënyrë që mund t'i shkaktojnë lëndime personave të ndaluar.

Tabela 2 Gjendja e hapësirave për ndalim në SHPK - 2006						
Regjioni	Stacioni	Dhomat e ndalimit	Madhësia mesatare (m <sup>2</sup> )	Kapaciteti i përgjithshëm	Në përdorim (Po/Jo)	Vlerësimi nga ana e zyrtarëve të SHPK-së (tetor 2006)
Prishtinë	Qendra	8	13.3	22	Yes	Kënaqshëm
	Glllogovc	6	10.1	10	Yes( 6 orë)	Shumë mirë
	Graçanicë	1	5.3	2	N/D	-
	Lipjan	2	-	-	Jo	dobët
	Obiliq	2	8.4	3	N/D	-
	Podujevë	1	7.5	2	Po (6 orë)	Shumë dobët
	Pejë	Pejë	2	4.9	4	Po
Gjakovë		3	5.5	5	Po	Shumë dobët
Deçan		2	3	4	Po	Shumë dobët
Istog		1	6.8	2	Po	Shumë mirë
Kline		1	9.3	2	Po	Shumë dobët
Mitrovicë	Jug	4	12.5	6	Po	Shumë dobët
	Veri	4	11.3	5	Po	-
	Vushtrri	2	-	2	Jo	-
	Skenderaj	3	12.8	5	Jo	-
	Leposaviq	4	11.3	6	PO	-
	Zubin Potok	-	-	-	Jo	-
Vlerësimi : Shumë dobët –Dobët – Kënaqshëm – Mirë –Shumë mirë						

2.10 Sa i përket standardeve për shëndet dhe siguri – si për të ndaluarit ashtu edhe për personelin e SHPK-së – kryerja e detyrës është e dobët. Në të vërtetë në të gjitha vendet, Inspektorati policor e pa se SHPK-ja nuk posedon pajisjet e ndihmës së parë dhe personeli i SHPK-së nuk pajiset me dorëza mbrojtëse për t'i mbrojtur ata nga lëndimi i mundshëm gjatë kontaktit me gjak apo me lëngje tjera trupore. Kur inspektorët i pyetën menaxherët e SHPK-së, ata thanë se nuk ekziston ndonjë plan i evakuimit në rast të ndonjë gjendje të jashtzakonshme dhe se personeli i SHPK-së asnjëherë nuk kanë ushtruar ndonjë ushtrim evakuimi për personelin dhe të ndaluarit. Inspektorati policor rekomandon se zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të rishikojnë procedurat e ndalimit dhe të sigurojnë se plotësohen të gjitha aspektet e shëndetit dhe sigurisë .

Tabela 2 –Vazhdim

Gjendja e hapësirave për ndalim në SHPK - 2006

Regjioni	Stacioni	Dhomat e ndalimit	Madhësia mesatare (m <sup>2</sup> )	Kapaciteti i përgjithshëm	Në përdorim (Po/Jo)	Vlerësimi nga ana e zyrtarëve të SHPK-së (Tetor 2006)
Prizren	Suharekë	4	-	6	Po	Dobët
	Malishevë	5	-	8	Po	Mirë
	Rahovec	4	-	8	Po	Mirë
	Dragash	2	-	4	Po	-
	Prizren	5	-	10	Po	Shumë dobët
Gjilan	Gjilan	4	4.35	8	Po	Dobët
	Kamenica	4	13.3	6	Jo <sup>37</sup>	Shumë mirë
	Vitia	1	11.7	2	Po	Mirë
Ferizaj	Qendra	2	5	2	PO (6 orë)	Dobët
	Kaçanik	6	10.9	10	Po	Kënaqshëm
	Shtime	2	9.7	3	Po	-
	Shtërpcë	2	9.7	3	-	-
Vlerësimi : Shumë dobët – dobët – kënaqshëm – mirë – shumë mirë						

## Rekomandimi kryesor nr. 3

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen të rishikojnë aspektet për shëndet dhe siguri të procedurave të SHPK-së, që kanë të bëjnë me ndalimin policor. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ushtrimeve të evakuimit, përdorimit të dorzave, dhe sigurimit të paisjeve për ndihmën e pare..*

2.11 Gjatë inspektimit të rëndomtë, Inspektorati Policor nuk hasi në asnjë dëshmi për mopajtueshmëri me dispozitat e ligjit të aplikueshëm lidhur me të drejtat themelore të të ndaluarve. Ndonëse – siç është cekur më herët - SHPK-ja përdorë formularë të ndryshëm nëpër regjione, këta formularë janë të dizajnuar për të siguruar se personat e ndaluar informohen për të drejtat e tyre ligjore përderisa janë në ndalim policor. Pa përjashtime, formularët e inspektuar ishin plotësuar ashtu si duhet.<sup>37</sup>. Gjatë diskutimeve joformale me personat e ndaluar në lidhje me trajtimin e tyre,

<sup>37</sup> Nuk ishte e qartë pse dhomat e ndalimit në Kamenicë nuk përdoren edhe pse gjendja e tyre ishte shumë e mirë.

<sup>38</sup> Inspektorati Policor vërejtë se formularët e ndalimit në Ferizaj nuk ishin të nënshkruara nga personat e ndaluar dhe nuk ishte shënuar asnjë arsye për mungesën e këtij nënshkrimi në formular.



Inspektorati Policor nuk u informua për baza të ndonjë ankese për atë se polici përkatës I SHPK-së ka vepruar në mospërputhje me ligjin.

2.12 Përkundër mungesës së ankesave, Inspektorati Policor beson se kushtet jopërkatëse të hapësirave mund të rezultojnë në praktikë të dobët. Si shembull, Inspektorati Policor e kuptoi se 8 persona janë mbajtur në një sallë të madhe në stacionin e Ferizajit. Secili prej tyre ishte i ulur në karrigë me fytyrë kah muri përderisa kanë pritur për t'u intervistuar lidhur me supozimet për veprën penale. Pas kërkimeve, Inspektorati e kuptoi se këta persona ishin transportuar fillimisht nga Ferizaji për në Kaçanik, për t'u mbajtur në dhoma ndalimi përkatëse e pastaj janë dërguar përsëri në Ferizaj për t'u intervistuar. Mungesa e dhomave përkatëse të ndalimit në Ferizaj bëri që policët të vendosin 8 persona në një dhomë e cila nuk ishte e përshtatshme për ndalim. Inspektorati policor nxiti zyrtarët e lartë për të rishikuar strategjinë aktuale lidhur me zhvillimin e hapësirave përkatëse dhe të mjaftueshme të ndalimit në mënyrë që të parandalojnë praktikën e tilla si në Ferizaj.

#### Rekomandimi kryesor nr. 4

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së nxiten që të rishikojnë politikën dhe procedurat e tyre në lidhje me sigurimin e hapësirave të mjaftueshme dhe përkatëse të ndalimit në mënyrë që të parandalohen praktikën e këqija dhe të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me ligjin e aplikueshëm..*

#### Politika dhe strategjia

2.13 Në kohën e inspektimit të rëndomtë, Inspektorati policor nuk u njoftua për ndonjë strategji të shkruar të përgjithshme në lidhje me menaxhimin e personave të ndaluar nga policia. Mungesa e një strategjie të shkruar, e kombinuar me perceptimin e dobët të këtij funksioni policor, tregon se kjo nuk është konsideruar si një fushë me rëndësi e vëmendjes së SHPK-së .

2.14 Inspektorati policor përkrah një rishikim urgjent nga ana e zyrtarëve të lartë të SHPK-së të dispozitave të ndalimit policor në tërë Kosovën, me qëllim të zhvillimit të

një strategjie të shkruar gjithpërfshirëse. Strategjia e krijuar duhet të merr parasysh një numër faktorësh të përmendur në këtë raport, si dhe këshillat e ofruara nga raportet e mëparshme të OSBE-së në këtë fushë. Problem gjithpërfshirës është çështja e mjeteve financiare dhe nevoja për planifikim për raste të papritura në kuptim të numrit të të ndaluarve policor, siq u dëshmua në mars të viti 2004.

#### Rekomandimi kryesor nr. 5

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së fuqimisht këshillohen të zhvillojnë një strategji të shkruar për ndalimin policor sa më shpejt që është e mundur. Kjo strategji duhet të kërkojë racionalizimin e sigruimit të dhomave të ndalimit, duke rritur në masë të madhe cilësinë dhe kapacitetin e këtyre hapësirave duke patur parasysh problemet gjithpërfshirëse financiare*

2.15 Qartë, strategjia e ndalimit duhet të ndërlidhet me strategjinë e menaxhimit të ndërtesave (shih raportin e përkohshëm nr.3) dhe të përpiqet të racionalizojë përdorimin e dhomave të ndalimit. Në vend të përpjekjeve për sigurimin e dhomave të ndalimit në disa lokacione në secilin rajon, zyrtarët e lartë të SHPK-së duhet të kenë parasysh ndërtimin e një ose dy qendrave më të mëdha të ndalimit. Qendrat e

tilla të ndalimit mund të jenë në interes të investimeve më të mëdha në masa të sigurisë si dhe ekipeve të përbërë nga personeli I SHPK-së I dedikuar dhe I trajnuar përkatësisht. Çdo hapësirë do të ishte e dizajnuar në atë mënyrë që të përfshijë dhomat e ndalimit të ndara dhe të pajisura në mënyrë përkatëse, dhomat për intervistim, dhomat për vizitorë, për vëzhgim, dhe paisjet për siguri. Hapësirat e dedikuara gjithshu do të ofronin mundësinë e zvoglimit të shpenzimeve dhe sigurimin e standardeve të njëtrajtshme në lidhje me sigurimin e ushqimit dhe pijeve për personat e ndaluar. Përveq kësaj, një qasje e tillë do mund të plotësonte nevojën urgjente për dhomat e ndalimit të ndara për gjininë femrore si dhe për të mitur.

#### Rekomandimi kryesor nr. 6

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen që të shqyrtojnë mundësinë për përdorimin e një ose dy qendrave të ndalimit në çdo regjion si mjet I përmirësimit të cilësisë së punës në mënyrën më efektive.*

2.16 Ndërprerja e përdorimit të praktikës aktuale të marrjes së policëve për ndalim nga grupi I policëve të uniformuar në dispozicion gjithashtu duhet të konsiderohet si pjesë e strategjisë së re. Ndalimi do të mund të bëhej një funksion I specializuar I SHPK-së, me personel të trajnuar dhe të zgjedhur me kujdes. Përveq njohurive dhe përdorimit të të ligjit të aplikueshëm si dhe procedurave të SHPK-së, trajnimi I specializuar do të duhej të përqëndrohej në ofrimin e ndihmës së parë, përdorimit të, forcës përkatëse dhe kontrollit të të ndaluarve si dhe çështjeve për shëndet dhe siguri. Personeli I caktuar në këto qendra ndalimi gjithashtu do të duhej të pajisej me dorëza mbrojtëse dhe të vaksinohet kundër hepatitit dhe sëmundjeve tjera ngjitëse të cilat mund të transmetohen nga personat e ndaluar.

#### Rekomandimi kryesor nr. 7

*Zyrtarët e lartë të SHPK-së këshillohen të adaptojnë politikën e zgjedhjes dhe trajnimit të personelit të dedikuar të SHPK-së për menaxhimin dhe operimin e qendrave të ndalimit policor. Kjo qasje do të ndihmonte në tendencën për të përmirësuar standardet të cilat do të jenë në dobi të të ndaluarve dhe personelit të SHPK-së.*

## 5. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Burimet njerëzore

### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi i pestë i rëndomtë i SHPK-së është kryer prej datës 14 deri më 17 nëntor 2006, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim ishte i përqendruar vetëm në kryerjen e detyrave nga ana e menaxhmentit të burimeve njerëzore dhe është ndërmarrë nga z. Enver Rustemi, Ushtrues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ekipit prej 19 inspektorëve. Janë vizituar të gjitha komandat regjionale dhe një numër i stacioneve policore në tërë Kosovën. Gjithashtu është kryer edhe një anketë me rreshterët dhe policët patrullues në lidhje me opinionet e tyre. Inspektorët kanë hasur në bashkëpunimin dhe vullnet të mirë për të ndihmuar nga ana e policëve të SHPK-së.

1.2 Shërbimi Policor i Kosovës është një organizatë e re dhe në rritje. Gjatë inspektimit të burimeve njerëzore Inspektorati Policor i Kosovës ka konfirmuar se procesi për konsolidimin e strukturës organizative, roleve dhe përgjegjësive dhe mekanizmave të brendshëm të SHPK-së është një proces në vazhdim e sipër. Një krahasim i mirë për këtë proces është treni në lëvizje në të cilin - përderisa ende është në lëvizje – kompania e trenave dhe personeli janë ndërruar, pajisjet e trenit janë rinovuar dhe vagonët e udhëtarëve janë ngjyrosur. SHPK-ja jo vetëm që duhet të marrë përgjegjësi të reja dhe t'i konsolidojë të tanishmet shpesh me menaxher relativisht të papërvojë - por duhet të veprojë në këtë mënyrë përderisa ofron shërbime policore. Ky proces i konsolidimit i referohet jo vetëm transferimit në vazhdim e sipër të përgjegjësive nga ana e Policisë Civile të UNMIK-ut por gjithashtu edhe atyre fushave të komandës së operativës dhe mbështetjes qendrore që janë transferuar nga UNMIK-u gjatë 12 muajve të fundit. Inspektorati veçon se ky është një proces i ndërlikuar dhe i vështirë, i cili vazhdon t'i testojë shkathtësitë e menaxherëve të lartë të SHPK-së.

1.3 Menaxhimi i burimeve njerëzore është fushë vitale për çdo organizatë të madhe policore. Paraqitja e procesit dinamik të ndryshimeve të përshkruara më lartë, menaxhimi i burimeve njerëzore në SHPK është një tipar kryesor i detyrave në themelimin e plotë të SHPK-së në baza të qëndrueshme. Një sasi e konsiderueshme e të dhënave është grumbulluar gjatë inspektimit të pestë të rëndomtë dhe raporti i tanishëm do të fokusohet vetëm në disa çështje të njohura. Në mënyrë specifike raporti do të përqendrohet në tiparet e përgjithshme të strukturës organizative dhe personelit të SHPK-së, sa i përket principeve të efikasitetit dhe efektshmërisë dhe pajtueshmërisë me standardet dhe ligjet e KEEP-së.

1.4 Qëllimi i këtyre inspektimeve të rëndomta është të bëhen rekomandimet për atë se si menaxherët e SHPK-së mund të përmirësojnë kryerjen e detyrave policore në realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin lidhur me të.
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Inkurajon menaxhimin profesional të burimeve njerëzore;

- Mundëson përgatitjen e shërbimeve cilësore në mbështetje të personelit të SHPK-së; si dhe identifikon dhe shpërndan praktikën më të mirë.

1.5 Gjatë inspektimit, personeli i Inspektoratit Policor vizitoi dhe intervistoi punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Menaxherët e lartë të SHPK-së në komandën kryesor për Administratë;
- Komandantët regional dhe/ose zëvendëskomandantët;
- Komandantët e stacioneve dhe/ose zëvendëskomandantët;
- Intervistat me rreshterë dhe policë patrullues të SHPK-së;
- Intervistat me personelin civil mbështetës të SHPK-së.

1.6 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike i cili parim është i mbështetur nga neni 19 i Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. KRYERJA E DETYRAVE NGA ANA E MENAXHMENTIT TË BURIMEVE NJERËZORE

### Gjendja aktuale

2.1 Në kohën e kryerjes së këtij inspektimi të rëndomtë struktura organizative e SHPK-së është vërejtur të jetë në gjendje fluksi (në lëvizje), derisa policia civile e UNMIK-ut vazhdon t'i transferojë përgjegjësitë për funksionet policore te organizata e re policore dhe zyrtarët e lartë policorë të SHPK-së vazhdojnë t'i konsolidojnë fushat tani më të transferuara. Shtojca A paraqet një përmbledhje të strukturës organizative të miratuar nga Komisari i Policisë në tetor 2006 dhe tregon fushat në të cilat tani SHPK-ja ka autoritet ekzekutiv. Janë gjashtë çështje kryesore në vlerësimin e Inspektoratit Policor në lidhje me strukturën e tanishme organizative dhe personelin:

- Shkalla – sa është madhësia optimale e organizatës së SHPK-së?
- Shtrirja e kontrollit – sa është numri i saktë i niveleve të menaxhimit dhe shtrirja e kontrollit për secilin nivel?
- Roli/përcaktimi i detyrave – deri në çfarë mase janë të përcaktuara rolet dhe detyrat brenda strukturës organizative të SHPK-së?
- Struktura komanduese – çfarë është optimumi i strukturës komanduese për kryerjen e detyrave operacionale policore në regjionet e SHPK-së?
- Balanci etnik/ gjinor – a i plotëson SHPK-ja standardet e *KEEP*-së lidhur me përbërjen etnike/gjinore?
- Pushimi mjekësor – cila është shkalla e pushimeve mjekësore dhe mosprezencës në vendin e punës?

Tabela 1

Madhësia e organizatave policore – krahasimi me dymbëdhjetë shtetet anëtare të BE-së dhe Kosovës<sup>39</sup>

Vendi	Rajoni (1,000 kilometra katror)	Numri i policëve për kilometër katror	Numri i policëve (2001)	Policë për 100,000 banorë
Austri	83.8	0.3	28 440	337
Belgjikë	30.5	1.2	37 432	360
Danimarkë	42.9	0.2	10 228	190
Francë	547.0	0.38	211 258	381
Gjermani	257.0	0.92	237 198	289
Greqi	131.9	0.38	51 254	461
Irlandë	70.2	0.16	11 815	306
Itali	301.3	0.89	270 696	472
Holandë	41.5	1.11	46 341	274
Portugali	91.9	0.52	48 339	461
Spanjë	510.0	0.36	184 604	457
Angli dhe Uells (MB)	241.6	0.52	125 682	241
Mesataret		<b>0.57</b>		<b>352</b>
<b>Kosova</b>	<b>10.9</b>	<b>0.65</b>	<b>7,185</b>	<b>342</b>

2.2 Për sa i përket madhësisë, SHPK-ja aktualisht ka 8,960 punonjës; 7,185 zyrtar policor, 594 oficer të sigurimit dhe 1,181 punonjës civil. Shuma e përgjithshme e pagave për vitin 2006 është 26.5 milion euro, 46% e buxhetit të përgjithshëm të SHPK-së. Tabela 1 paraqet krahasimin e numrit të zyrtarëve policor (për 100,000 banorë/kilometër katror) në një shembull grupor të dymbëdhjetë shteteve të BE-së dhe SHPK-së<sup>40</sup>. Më përafërsisht 342 policë për 100,000 banorë<sup>41</sup>, SHPK-ja bie nën numrin mesatar të këtij shembulli grupor (352 për 100,000 banorë) dhe me numër më të madh se Gjermania, Irlanda, Holanda, Danimarka, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar. Sa i përket dendësisë gjeografike SHPK-ja ka përafërsisht 0.65 policë për

<sup>39</sup> Të dhënat për 12 shtetet e BE-së janë marrë nga Barclay, G. & Tavares, C. Krahasimi ndërkombëtar i statistikave të së drejtës penale 2001, botuar më 12/03, 24 tetor 2003, faqe 18.

<sup>40</sup> Duke ditur se shumica e organizatave policore fqinje në këtë rajon të Ballkanit janë duke kaluar ose duke marrë parasysh reformat e rëndësishme, Inspektorati Policor beson se një krahasim me organizatat e shteteve të BE-së mund të tregohet më i dobishëm për përcaktimin e numrit të përshtatshëm të policëve në SHPK.

<sup>41</sup> Numri i saktë i banorëve të Kosovës nuk dihet dhe ky kalkulim është bazuar në numrin e përafërt të banorëve prej 2.1 milionë banorë.

kilometër katror, më shumë se mesatarja (0.57 për kilometër katror), për shembullin grupor dhe vetëm më pak se Belgjika, Gjermania, Italia dhe Holanda.

2.3 Derisa niveli i tanishëm i personelit të SHPK-së është rezultat i ekzistimit të një vendimi të politikës së UNMIK-ut, Inspektorati është i interesuar në identifikimin e këtyre faktorëve të cilët do të ishin udhërrëfyes për strategjinë e ardhshme të organizatës në lidhje me personelin nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së. Një faktor i rëndësishëm në strategjinë e ardhshme është ngarkesa me punë ose kërkesat e SHPK-së. Tabela 2 ofron një analizë të të gjitha incidenteve që kanë kërkuar reagim nga ana e policisë gjatë shtatorit të vitit 2006<sup>42</sup>. Totali 1211 incidenteve të regjistruara që kanë ndodhur gjatë muajit shtator duket të jetë e niveli tipik të kërkesave<sup>43</sup>. Sa i përket efikasitetit të SHPK-së, të dhënat tregojnë se ka pasur (përafërsisht) 40.3 incidente çdo ditë dhe për secilin incident aty kanë qenë 178 policë<sup>44</sup>. Derisa, gjatë një muaji të tërë aty është vetëm një incident përafërsisht për çdo 5.9 policë të SHPK-së, puna e kërkuar në policinë reaktive (e kundërta proaktive) duket të mos jetë shumë e madhe<sup>45</sup>.

2.4 Inspektorati Policor i Kosovës pranon se ky nuk është përshkrimi i përgjithshëm i ngarkesës me punë të SHPK-së gjatë një muaji. Është bërë i njohur angazhimi i SHPK-së në një numër aktivitete të punës policore proaktive siç janë zbulimi i kundërvajtjeve në trafik, i cili shkakton një numër të madh të gjobave në trafik për çdo muaj. Njëkohësisht, Inspektorati beson – që në mungesë të më shumë dëshmime të punës policore proaktive – mund të bëhet shumë pak për të mbështetur një argument për rritjen e numrit të policëve të SHPK-së. Derisa kërkesa për punë reaktive mbetet e ulët, zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së u jepet mundësia që të përfitojnë nga një numër i madh i policëve të cilët mund të shpërndahen në një linjë të masave proaktive. Kjo çështje do të shqyrtohet thellësisht në inspektimin e ardhshëm të rëndomtë (Menaxhimi i hetimit të krimit).

#### Rekomandimi kyç nr. 1

*Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të përgatisin të dhëna të hollësishme lidhur me efikasitetin e SHPK-së, sa i përket incidenteve të punës reaktive policore dhe iniciativave proaktive. Të dhënat e tilla janë të rëndësishme si mjete për matjen e efikasitetit në arritjen e objektivave të SHPK-së, si dhe të merren vendime të bazuara për shpërndarjen e policëve.*

<sup>42</sup> Këto të dhëna janë nxjerrur nga 'Raportet ditore të situatës' nga policia e UNMIK-ut për muajin tetor 2006.

<sup>43</sup> Për shembull gjatë tetorit ka pasur 1034 incidente reaktive.

<sup>44</sup> Në tetor 2006 SHPK ka pasur gjithsej 7,187 policë.

<sup>45</sup> Shprehja punë policore reaktive i referohet punës e cila është rezultat i reagimeve policore në incidente aktuale kur ato ndodhin, ndërsa puna policore proaktive i referohet punës së bërë nga aktivitetet policore që kanë për qëllim të zvogëlojnë krimin, trafikimin dhe incidente të tjera.

Tabela 2 Puna reaktiv policore – Analizimi i incidenteve në lidhje me policinë në Kosovë (shtator 2006)								
Regjioni	Vjedhje	Incidente të tjera kriminale	Shpërthime / MPE (UXO)	Aksidente në trafik	Aksidentet fatale	Arrestime	Të tjera	Totali
Prishtinë	34	102	9	32	10	117	32	336
Mitrovicë	19	64	2	29	4	37	21	176
Pejë	6	63	5	6	3	64	11	158
Prizren	15	38	6	25	11	43	12	150
Ferizaj	12	40	2	20	2	26	13	115
Gjilan	7	32	7	8	0	18	16	88
Policia kufitare	2	122	1	0	0	18	45	188
<b>Totali</b>	<b>95</b>	<b>461</b>	<b>32</b>	<b>120</b>	<b>30</b>	<b>323</b>	<b>150</b>	<b>1211</b>

Tabela 3 Shpërndarja e personelit të SHPK-së – 2006				
Regjionet	Zyrtar policor	Oficer të sigurimit	Shërbyes civil	Totali
Prishtinë	1,479	-	183	1,662
Mitrovicë	935	-	149	1,084
Pejë	906	-	120	1,026
Prizren	842	-	117	959
Ferizaj	523	-	96	619
Gjilan	760	-	94	854
Policia kufitare	959	-	25	984
Komanda kryesore	781	594	397	1,772
<b>Totali</b>	<b>7,185</b>	<b>594</b>	<b>1,181</b>	<b>8,960</b>

2.5 Tabela 3 ofron një analizë të shpërndarjes së tanishme të personelit të SHPK-së. Pasqyrimi i strukturës së tepërmi të centralizuar të organizatës, përafërsisht 14% e policëve dhe personelit civil mbështetës janë të vendosur në Komandën Kryesore.


Duke ditur se një numër i funksioneve të specialistëve ende pritet të transferohet në SHPK nga Policia Civile e UNMIK-ut, madhësia përkatëse e Komandës Kryesore është e mundshme të rritet edhe më shumë në vitin 2007. Në kohën kur është kryer inspektimi i rëndomtë Inspektorati Policor nuk ka qenë në dijeni për ndonjë plan të personelit për periudhën 2007 e cila tregon se si personeli mund të shpërndahet në mbështetje të funksioneve të transferuara. Megjithatë, Inspektorati Policor vëren punësimin në rritje të shërbyesve civilë në administratë dhe funksione mbështetëse, si në Komandën Kryesore po ashtu edhe në regjione. Kjo politikë është e mirëseardhur për disa arsye. Policët mund të shpërndahen në masë më të madhe në kryerjen e detyrave policore se sa të kryejnë punë administrative. Kostoja relative për transferimin e mëtutjeshëm të përgjegjësive nga UNMIK-u mund të kompensohet me tërheqjen e sa më shumë policëve nga punët administrative. Detyrat administrative themelore (p.sh. teknologji informative, menaxhim të flotës së automjeteve, mbështetje ligjore, menaxhim të ndërtesave), të cilat kërkojnë ekspertizë teknike dhe përvojë të gjatë, e të cilat më së miri ofrohen nga shërbyesit civil, se sa nga policët të cilët kanë për qëllim të vazhdojnë më tej në zhvillimin më të madh të ngritjes profesionale (karrierës).

2.6 Paragrafi 17 i Kodit Evropian për Etikën Policore (KEEP) deklaron se 'një organizatë policore duhet të sigurojë zinxhir të qartë komandues' dhe të jetë i atillë që 'mundëson përcaktimin se cili udhëheqës është në fund përgjegjës për veprat apo lënien pas dore të personelit të policisë'. Një gjë me rëndësi me rastin e vlerësimit të strukturës së SHPK-së është numri optimal i niveleve të menaxhmentit dhe shtrirja e kontrollit në secilin nivel të menaxhmentit. Shtrirja e kontrollit i referohet numrit të bashkëpunëtorëve të cilët raportojnë në mënyrë direkt te menaxheri apo mbikëqyrësi i caktuar. Tabela 3 paraqet strukturën e SHPK-së në tetor 2006 para tranzicionit përfundimtar nga UNMIK-u te organizata e re policore. Si shtesë të tetë niveleve të menaxhmentit në atë kohë, gradat më të larta të komisarit dhe zëvendëskomisarit do të shtohen në një të ardhme të afërt. Ka një numër total prej 1228 policëve në menaxhment dhe grada udhëheqëse, 17% i numrit total të personelit policor. Megjithatë kjo tregon raportin e përgjithshëm të 1:4.8 menaxherëve të policëve të patrullës, një studim i shtrirjes së kontrollit në secilin nivel të strukturës së SHPK-së tregon një model të pazakontë. Ndryshe nga vija e parë e menaxhimit (rreshterët) shtrirja e kontrollit duket shumë e ngushtë, në veçanti në gradat mesatare (kolonel: 1.8, nënkolonel: 1.1).

2.7 Koncentrimi i tillë i menaxherëve të vijës së mesme duhet të ngre pyetje serioze për rolin dhe qëllimin e tyre. A është një nivel kaq i rreptë mbikëqyrjeje i nevojshëm dhe, nëse jo, çfarë është qëllimi i mbajtjes së gradës së kolonelit dhe nënkolonelit nga aq shumë policë? Studimi tregon se vlerësimi i saktë i shtrirjes së kontrollit për një nivel të menaxhmentit duhet të jetë i lidhur me standardizimin e punëve të kryera nga ata që janë nën mbikëqyrje<sup>46</sup>. Me fjalë të tjera, sa më të ngjashme që janë punët që kryhen nga individët në cilindo nivel – standardizimi i punëve - një menaxher mund të kontrollojë dhe koordinojë më shumë njerëz. Më qartë, menaxherit të cili i duhet të mbikëqyrë shumë të punësuar të cilët bëjnë punë të ndryshme i kërkohet më shumë kohë dhe energji sesa menaxherit i cili ka numër të ngjashëm të punësuarve që kryejnë punën e njëjtë.

<sup>46</sup> Mullins, L.J. (2005) *Management and Organisational Behaviour*, London, Prentice Hall (p.p. 610-11)





**Tabela 4: Struktura e gradimit në SHPK dhe shtrirja e kontrollit (tetor 2006)**

2.8 Definicioni i saktë i shtrirjes së duhur të kontrollit në një nivel të menaxhmentit është në tërësi kontingjent mbi definicionin e plotë të rolit dhe përgjegjësi të secilës gradë (apo rolit menaxhues). Në kohën e kryerjes së inspektimit të rëndomtë Inspektorati Policor ka qenë në gjendje të siguroj përshkrimin e hollësishëm të vendit të punës të vetëm 19 pozitive brenda SHPK-së. Nga këto përshkrime të vendit të punës 13 kanë qenë në lidhje me nivelin e mesëm dhe të lartë të pozitive menaxhuese në organizatë. Është bërë e ditur nga Inspektorati Policor se procesi i definimit të qartë të roleve dhe përgjegjësi në tërë SHPK-në është proces i cili ende nuk ka përfunduar. Megjithatë, mungesa e përshkrimeve të hollësishme të vendeve të punës dhe profileve të punës<sup>47</sup> tregon një zbrazëti serioze në modelin organizativ të SHPK-së. Nëse një nivel i menaxhmentit/detyrës së dhënë nuk është definuar plotësisht, nuk është e mundur të zgjedhet polici i cili do ta mbajë atë gradë. Është gjithashtu e pamundur të vendoset maksimumi (apo minimumi) i numrit të personave të cilët zyrtari policor duhet t'i mbikëqyrë. Për më tepër në mungesë të kësaj definimi i hollësishëm i rolit do të jetë i pamundur - nga pikëpamja e modelit organizativ – për të vendosur nëse grada e dhënë është e tepërt apo e panevojshme.

<sup>47</sup> Profili i punës është një listë gjithëpërfshirëse e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimit të kërkuar për të kryer detyrën apo funksionin e dhënë në organizatë. Ky dokument duhet të formoj bazat e cilitdo trajnim specialistësh apo vlerësimin pasues të vendit të punës të personit në detyrë.

**Rekomandimi kyç nr. 2**

*Inspektorati Policor inkurajon zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të sigurohen se të gjitha gradat dhe rolet brenda strukturës së SHPK-së të jenë të definuara në mënyrë të duhur me shkrim dhe në formë të dokumentuar. Definimi i tillë i roleve duhet të përmbajë profilin e plotë të punës, si dhe përshkrimin standard të vendit të punës.*

2.9 Tabela 5 ofron një analizë të shpërndarjes së tanishme të zyrtarëve policor të SHPK-së sipas gradave. Shtrirja e kontrollit (e treguar në kllapa) zbulon një model jo të rregullt në regjione dhe me siguri është rezultat i procesit të shpejtë të gradimit në vazhdim e sipër, derisa UNMIK-u është duke transferuar përgjegjësitë. Edhe nëse lejohet procesi i ndryshimeve që janë duke ndodhur, megjithatë, disa dallime janë shkak për shqetësim. Derisa rreshterët në Mitrovicë ku secili nga ata mbikëqyrë mbi 16 policë të patrullës, rreshterët në Komandën Kryesore dhe në Prizren mbikëqyrin më pak se një të tretën e këtij numri. Siç mund të shihet në Tabelën 2, aty ekzistojnë diferenca të ngjashme në lidhje me numrin e personave të mbikëqyruar nga kapitenët dhe togerët në tërë regjionin.

**Rekomandimi kyç nr. 3**

*Inspektorati Policor rekomandon që procesi i stabilizimit të strukturës së menaxhimit brenda njësisë të komandës regjionale duhet të përshpejtohet, në këtë mënyrë do të bëhet largimi i dallimeve të mëdha në menaxhmentin e SHPK-së në shtrirjen e kontrollit dhe zvogëlimin e nivelit të mbikëqyrjes në mes të tri gradave të para.*

2.10 Tabela 5 gjithashtu ofron dëshmi të tjera që mund të mbështesin argumentin se struktura fillestare komanduese brenda regjioneve duhet të zvogëlohet nga gjashtë grada menaxhuese në 5 apo edhe në 4. Për shembull Regjioni i Prishtinës mund të rimodelohet në sistem komandues katër gradash siç vijon: 1 Major (5); 5 Kapitenë (5); 25 Togerë (5); 125 Rreshterë (10.5); dhe 1322 policë patrullues. Numri në kllapa tregon shtrirjen e kontrollit. Shtrirja më e madhe e kontrollit për gradën e rreshterit duhet të jetë fleksibile, duke pasur parasysh numrin e vogël të incidenteve reaktive dhe standardizimin e detyrave fillestare të patrullës. Një strukturë e thjeshtësuar (ose 'e ngjeshur') duhet të përmirësojë efektshmërinë e zinxhirit komandues dhe komunikimit në SHPK, problem i cili është vënë re edhe më herët në raportet e përkohshme. I kombinuar me përshkrimet e definuara qartë të roleve dhe i shoqëruar me iniciativat e trajnimeve të policëve në vend të punës për katër gradat e menaxhimit, ky model i thjeshtësuar i menaxhimit mund të ndihmojë në përmirësimin e detyrave menaxhuese.

Tabela 5 Shpërndarja e gradave të SHPK-së – 2006 ('Shtirirja e kontrollit' e treguar në kllapa)									
Regjioni	Gjen.N/ Kolonel	Gjeneral Major	Kolonel	N/Kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rresh	Polic patrolle
Prishtinë	-	-	1 (2)	2 (1.5)	3 (3.6)	11 (3.3)	37 (3.1)	118 (11)	1307
Mitrovicë	-	-	2 (0.5)	1 (1)	1 (9)	9 (3)	27 (1.9)	52 (16.2)	843
Pejë	-	-	1 (3)	3 (0.6)	2 (3)	6 (4.8)	29 (3.9)	115 (6.5)	750
Prizren	-	-	1 (2)	2 (1.5)	3 (3.3)	10 (2.2)	22 (6)	132 (5)	672
Ferizaj	-	-	1 (2)	2 (1)	2 (1)	2 (10)	20 (2.25)	45 (10)	451
Gjilan	-	-	2 (2)	2 (0.5)	1 (10)	10 (3.2)	32 (3)	97 (6.3)	616
Policia kufitare	-	-	-	-	-	12 (1.8)	22 (4.6)	103 (7.9)	822
Komanda kryesore	1 (4)	4 (2)	8 (2)	16 (1.3)	21 (1.5)	33 (2.2)	74 (1.7)	128 (3.8)	496
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>16</b>	<b>28</b>	<b>33</b>	<b>93</b>	<b>263</b>	<b>790</b>	<b>5957</b>

#### Rekomandimi kyç nr. 4

*Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së duhet ta rishikojnë strukturën fillestare komanduese në nivele regjionale dhe të marrin parasysh dobitë potenciale të një modeli të bazuar në 4 (ose 5) grada të menaxhimit. Rishikimi duhet të ketë parasysh se si 'zinxhiri komandues' dhe komunikimi mund të përmirësohen, si dhe lidhja në mes 'shtirirjes së kontrollit' dhe definimit të rolit.*

<b>Tabela 6</b>				
<b>Përbërja etnike dhe gjinore e SHPK-së (2006)</b>				
<b>Etniciteti</b>	<b>Femra</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Totali</b>	<b>Totali %</b>
Shqiptar	838	5193	6031	83.9%
Serb	93	647	740	10.3%
Ashkali	-	21	21	0.29%
Boshnjak	33	195	228	3.1%
Çerkez	-	5	5	0.07%
Kroat	1	2	3	0.04%
Egjiptian	1	5	6	0.08%
Goran	-	38	38	0.53%
Maqedonas	1	-	1	0.01%
Malazias	1	1	2	0.03%
Rom	1	22	23	0.32%
Turq	8	78	86	1.2%
Tjerë	-	1	1	0.01%
<b>Totali</b>	<b>977</b>	<b>6208</b>	<b>7185</b>	
<b>Meshkuj</b>	<b>86.4%</b>			
<b>Femra</b>	<b>13.6%</b>			

2.11 Paragrafi 25 i Kodit Evropian të Etikës Policore deklaron që politika e rekrutimit në organizata policore “do të synojë të punësojë femra dhe meshkuj nga shtresa të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë grupe të pakicave etnike, me qëllim që përbërja e personelit policor të reflektojë shoqërinë të cilës ata i shërbejnë”. Siç është treguar në Tabelën 6, SHPK-ja ka arritur një shkallë të lartë të pajtueshmërisë me kërkesat e KEEP-së. Sa i përket përbërjes së saj etnike (dhe përhapjes) SHPK-ja nga afër reflekton shoqërinë të cilës i shërben dhe kjo është një fushë e arritjeve të mëdha, veçanërisht kur krahasohet me organizatat tjera në regjionin e Ballkanit dhe më tutje. Ndonëse, përbërja gjinore nuk e pasqyron shoqërinë e Kosovës në mënyrë të përkryer, SHPK-ja ka një përqindje më të lartë të femrave police se shumë organizata tjera policore.

2.12 Tabela 7 ofron një analizë të shkurtë të kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së në lidhje me numrin e ditëve të humbura gjatë pushimeve mjekësore, si dhe numrin e mundshëm që rezulton nga forma të tjera të pushimit. Shkalla e pushimeve mjekësore në një organizatë policore është një tregues i rëndësishëm i përkushtimit (motivit për punë, disponimit për punë, etj.), si dhe shëndetit – shkalla e lartë e pushimeve mjekësore në shumicën e rasteve më shumë ka të bëjë me disponimin e

personelit sesa me ndjeshmërinë e tyre ndaj sëmundjeve. Ndonëse numri i përgjithshëm i ditëve të humbura gjatë pushimeve mjekësore mund të duket i vogël në përqindje (3.7%) nga numri i përgjithshëm i ditëve të mundshme të punës, vlen të mbahet mend që ky nivel është baras me gati 263 policë që nuk kanë qenë në dispozicion për punë tërë vitin.

**Tabela 7**  
**Numri i ditëve të humbura të punës nga policët e SHPK-së (Janar – Nëntor 2006)**

Regjioni	Nr. total i policëve	Totali i ditëve të mundshme të punës <sup>48</sup>	Totali i pushimeve mjekësore (%)	Totali i ditëve kur nuk janë prezent në punë (%) <sup>49</sup>
Prishtinë	1,479	359,397	20,034 (5.5%)	127,549 (35.4%)
Mitrovicë	935	227,205	11,732 (5.1%)	70,184 (30.8%)
Pejë	906	220,158	5,068 (2.3%)	28,709 (13%)
Prizren	842	204,606	8,805 (4.3%)	60,127 (29.3)
Ferizaj	523	127,089	3,829 (3%)	26,090 (20.5%)
Gjilan	760	184,680	6,557 (3.5%)	46,042 (24.9%)
Policia kufitare	959	233,037	7,421 (3.1%)	42,984 (18.4%)
Komanda kryesore	781	189,783	1,917 (1%)	41,008 (21.6%)
<b>Totali</b>	<b>7,185</b>	<b>1,745,955</b>	<b>65,363 (3.7%)</b>	<b>442,693 (25.3%)</b>

2.13 Në shumicën e organizatave shkalla e pushimeve mjekësore që kalon 7 ditë për person është shkak për brengosje<sup>50</sup> – shkalla aktuale në SHPK është 9 ditë për person. Prandaj zyrtarët e lartë policor të SHPK-së duhet që në mënyrë aktive të hetojnë shkaktarin e kësaj tendence, si dhe zhvillimin e strategjisë për ta zvogëluar shkallën e pushimeve mjekësore. Në veçanti, Inspektorati Policor fuqishëm rekomandon që komandantët regjional në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren duhet të ndër marrin veprime urgjente për të hetuar dhe ndaluar shkallën e lartë të pushimeve mjekësore në mesin e policëve të tyre.

Kjo duhet të përfshij një regjim më rigoroz të monitorimit të pushimit mjekësor 'të paautorizuar' (p.sh. 1 – 3 ditë pushim mjekësor, për të cilin nuk nevojitet vërtetim nga mjeku).

2.14 Kolona e fundit në Tabelën 7 tregon numrin e përgjithshëm të ditëve të marrura përmes pushimit mjekësor, pushimit zyrtar, pushim për rast vdekje, pushimit të lehonisë, pushimit të atësisë dhe pushimit pa pagesë. Ekziston një korrelacion i qartë në mes të pushimit mjekësor (të marrë vetë) dhe numrit të përgjithshëm të ditëve të

<sup>48</sup> Llogaritjet i referohen numrit të ditëve të punës kur polici është në dispozicion, minus ditët e pushimit dhe ditët e pushimit vjetor në vitin kalendarik; domethënë 243 ditë.

<sup>49</sup> Këto shifra i referohen numrit të përgjithshëm të ditëve të mosprezencës në punë përmes një vargu të llojeve të pushimeve, përfshirë: nuk përfshin pushimin vjetor dhe ditët e kaluara në trajnim.

<sup>50</sup> Studim ekzekutiv i shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës mungesa gjatë pushimit mjekësor dhe shëndetësor i kryer nga GfKNOP, BM. Korrik - Tetor 2005.

marrura si rezultat i llojeve të ndryshme të pushimeve në secili regjion. Veçanërisht, modeli i pushimit mjekësor në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren reflekton korrespondim të lartë me nivelin e pushimit të përgjithshëm. Kjo i jep një rëndësi më të madhe argumentit që komandantët regjional në këto fusha duhet ta adresojnë këtë si çështje prioritare. 30% e burimeve policore në këto regjione nuk janë në dispozicion për një periudhë kohore prej një viti, çka e bën të papranueshme për Inspektoratin Policor.

#### Rekomandimi kyç nr. 5

*Inspektorati Policor rekomandon që komandantët regjional - veçanërisht ata në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren duhet të ndërmarrin veprime urgjente për të hetuar dhe ndaluar shkallën e lartë të pushimeve mjekësore në mesin e policëve të tyre. Kjo duhet të përfshij një regjim më rigoroz të monitorimit të pushimit mjekësor 'të paautorizuar' (p.sh. 1 – 3 ditë pushim mjekësor, për të cilin nuk nevojitet vërtetim nga mjeku).*

2.15 Të dhënat e paraqitura në Tabelën 7 tregojnë një sfidë të madhe të shkathtësive dhe aftësive të zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Niveli i përgjithshëm prej 25.3% i ditëve të punës në dispozicion të humbura përmes formave të ndryshme të pushimit (pas zbritjes së pushimi vjetor) barazohet me 1,796 policë të cilët nuk janë në dispozicion për punë gjatë gjithë vitit. Kur bashkohet me numrin e ditëve të kaluara në trajnim (që nuk ka qenë e njohur gjatë kohës kur është kryer inspektimi i rëndomtë), shkalla e të mos qenit prezent në vendin e punës duket të jetë shumë e lartë dhe e papranueshme. Në të vërtetë, me siguri është për shkak të shkallës relativisht të ulët të kërkesave për punë policore reaktive, për këtë arsye shkalla e lartë e mosprezencës në punë është bërë e tolerueshme, sa i përket dispozitave themelore të shërbimit.

#### Rekomandimi kyç nr. 6

*Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së duhet, në rastin e parë që do t'ju jepet, të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse që dukshëm do të reduktoj numrin e ditëve të humbura përmes formave të ndryshme të mosprezencës në punë. Strategjia duhet të identifikoj numrin e caktuar të ditëve për policë, si dhe një varg masash të disejnuara për të arritur objektivin për vitin 2007.*

### Politikat dhe strategjia

2.16 Në kohën e kryerjes së inspektimit të rëndomtë Inspektorati Policor nuk ka qenë në dijeni për ndonjë politikë apo strategji të shkruar<sup>51</sup> në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Një strategji e shkruar dhe e qartë është e nevojshme për një numër arsyesh. Mungesa e një strategjie të tillë mund të ndikojë në mosmarrëveshje

<sup>51</sup> Është e rëndësishme se aty ekziston qartësi se çka IPK-ja mendon me këto shprehje. Politikat janë një grup idesh që janë të formuluar si deklarata për veprimet e planifikuara të SHPK-së në sigurimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të nevojshme për të arritur synimet e SHPK-së. Politika e burimeve njerëzore duhet të tregojë qëllime specifike që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së kanë për qëllim t'i arrijnë gjatë një periudhe kohore të caktuar. Kurse, strategjia është një plan i detajuar për arritjen e këtyre qëllimeve të shkruara në dokumentin e politikave. Strategjia e burimeve njerëzore duhet të siguroj udhëzime të hollësishme për menaxherët përkatës administrativ, menaxherët e trajnimeve dhe komandantët regjional/komandës kryesore se çka nevojitet të bëhet, metodat dhe taktikat e preferuara si dhe burimet të cilat do të jenë në dispozicion.

te pjesëtarët e SHPK-së. Synimi i zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së mund të mos jetë i kumtuar qartë tek policët e niveleve më të ulëta në hierarki nga të cilët pritet që t'i implementojnë këto synime. Modeli i vjetruar i kryerjes së detyrave është i vështirë për t'u ndryshuar dhe modifikuar. Ndryshimet vijnë qoftë nga vlerësimet subjektive apo intuitive të cilat bëhen gjithnjë e më shumë të pasigurta përderisa shkalla e ndryshimeve rritet. Zhvillimi i një strategjie kërkon përpjekje kreative, si dhe grumbullim dhe analizim të kujdesshëm të një vargu të të dhënave të burimeve njerëzore. Nëse planifikimi strategjik tregohet i suksesshëm, gjithashtu kërkohet nga zyrtarët e lartë policor të SHPK-së që të veprojnë sipas këndvështrimeve të tërë pjesëtarëve të personelit të SHPK-së.

2.17 Gjatë kryerjes së inspektimit të rëndomtë Inspektorati Policor ka bërë një anketë me rreshterë dhe policë të patrullës në lidhje me mendimet e tyre. Shuma prej 225 policëve (3.3% i grupit të caktuar) janë zgjedhur rastësisht dhe nga ata është kërkuar të plotësojnë një pyetësor të thjeshtë, i përpiluar për të parë këndvështrimin e tyre në lidhje me atë se çfarë është duke funksionuar mirë në SHPK, çfarë nuk është duke funksionuar mirë dhe çka nevojitet të ndryshohet në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm. Pyetjet kanë qenë të 'hapura' dhe ata që janë përgjigjur nuk kanë qenë të ndikuar në asnjë mënyrë nga inspektorët policor. Megjithëse numri i personave të anketuar ka qenë shumë i vogël (3.3%) rezultatet janë interesante, si tregues i përafërt i çështjeve që i shqetësojnë policët në lidhje me mënyrën dhe të priturat në lidhje me kryerjen e detyrave nga ana e menaxhmentit të SHPK-së.

<b>Tabela 8</b>				
<b>Rezultatet e një ankete të vogël me rreshterë dhe policë të patrullës</b>				
<b>Pyetja</b>	<b>Përgjigjja më e lartë (%)</b>	<b>Përgjigjja e dytë më e lartë (%)</b>	<b>Përgjigjja e tretë më e lartë (%)</b>	<b>Përgjigjja e katërt më e lartë (%)</b>
<b>Çfarë është duke funksionuar mirë në SHPK?</b>	<b>Marrëdhëniet me publikun (27.1%)</b>	<b>Marrëdhëniet me kolegët (23.5%)</b>	<b>Efikasiteti në punë (10.2%)</b>	<b>Zbatimi i ligjit (9.33%)</b>
<b>Çfarë nuk është duke funksionuar mirë në SHPK?</b>	<b>Pagat e policëve (32.8%)</b>	<b>Menaxhmenti (20.8%)</b>	<b>Sistemi i gradimeve (16.4%)</b>	<b>Logjistika (14.2%)</b>
<b>Çka nevojitet të ndryshohet në 12 muajt e ardhshëm?</b>	<b>Pagat e policëve (45.3%)</b>	<b>Furnizimi me uniforma dhe pajisje (20%)</b>	<b>Sistemi i gradimit (17.7%)</b>	<b>Menaxhmenti (15.5%)</b>

2.18 Siç shihet në Tabelën 8 rezultatet e anketës tregojnë disa nga shqetësimet në fushat në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Niveli i tanishëm i pagave të policëve është njëra ndër shqetësimet më të mëdha në mesin e rreshterëve dhe policëve të patrullës – këta janë policët të cilët mbajnë barrën më të madhe në "vijën e parë" operacionale të punës policore. Përgjigjja më e lartë (32.8%) ishte në pyetjen se çka është duke shkuar keq në lidhje me çështjen e pagave të policisë, si dhe ende më e rëndësishme është përgjigjja e dhënë 45.3% në pyetjen çfarë duhet

të ndryshohet. Sugjerohet të merret në konsiderim mendimi i policëve në lidhje me pagën fillestare të policëve nga ana e zyrtarëve të lartë policor të SHPK-së, derisa ata zhvillojnë një strategji afatmesme në lidhje me burimet njerëzore. I njëjti menaxhmet gjithashtu këshillohet të merr parasysh edhe treguesit e fuqishëm të pakënaqësisë me sistemin e gradimit si dhe furnizimin me uniforma dhe pajisje.

#### Rekomandimi kyç nr. 7

*Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse lidhur me burimet njerëzore për një periudhë kohore prej 1 – 3 vjet, strategji e cila merr parasysh pikëpamjet e personelit të SHPK-së, veçanërisht rreshterëve të operativës dhe policëve të patrullës. Strategjia duhet të bëjë të njohur rëndësinë e këtyre çështjeve që ndikojnë në motivimin e personelit dhe shkallën e pushimeve mjekësore.*

2.19 20% e grupit të të anketuarve mendojnë se menaxhmenti në SHPK nuk ka funksionuar si duhet dhe 15.5% mendojnë se menaxhmenti i SHPK-së ka nevojë të ndërrohet, kjo duhet të jetë shkak për shqetësim. Me të vërtetë të gjitha çështjet e ngritura nga grupi lidhen në mënyrë direkt me motivimin në vendin e punës: p.sh. pagat, uniforma, pajisjet, gradimet dhe mbështetja logjistike. Është shumë e mundur se këta policë e ndjejnë se menaxherët e tyre janë duke dështuar në këto fusha kyçe të motivimit. Inspektorati Policor inkurajon zyrtarët e lartë të SHPK-së t'i marrin për bazë këto shqetësime dhe të veprojnë në lidhje me to në procesin e zhvillimit të një strategjie për burimet njerëzore.

2.20 Duke parë rezultatet e anketës dhe komentet e policëve të SHPK-së në pozitat e gradave të mesme në lidhje me sistemin e gradimit, Inspektorati Policor vëren se ka pakënaqësi të madhe në këtë fushë të rëndësishme të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në mënyrë që në tërësi të shqyrtohet me kujdes sistemi i gradimit në secilin nivel, si dhe të jenë në dijeni për pikëpamjet e policëve të secilës gradë, Inspektorati Policor do të kryej inspektime të rëndomta të sistemit të gradimit në SHPK në fazën e hershme të vitit 2007 si çështje në vete.



## 6. Mënyra e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së – Hetimi i krimit

### 1. HYRJE

1.1 Inspektimi I gjashtë I rëndomtë I SHPK-së u krye prej datës 12-14 dhjetor 2006, në bazë të Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9. Ky inspektim u përqëndrua vetëm në kryerjen e detyrave në menaxhimin e hetimit të krimit dhe është ndërmarrë nga Z. Enver Rrustemi, ushtrues detyre I kryeshefit ekzekutiv të Inspektoratit policor të Kosovës dhe ekipit prej 18 inspektorëve. Janë vizituar të gjitha komandat regjionale dhe një numër I stacioneve policore nëpër tërë Kosovën. Inspektorët policor hasën në bashkëpunim dhe gatishmëri të plotë të SHPK-së për të ndihmuar.

1.2 Në kohën kur u krye inspektimi, procesi I konsolidimit të fushave të transferuara së voni të përgjegjësive së hetimit të krimit ishte ende në vazhdim. Inspektorati policor vërejt se – sikurse në fushat tjera të menaxhimit të lartë – zyrtarët e SHPK-së të cilët tani udhëheqin fushat e transferuara të hetimit të krimit, kanë shumë pak përvojë. Në shumicën e rasteve zyrtarët përkatës janë në këto pozita për vetëm disa muaj. Për shkak të mungesës së përvojës, nuk është për t'u çuditur se disa aspekte të kryerjes së detyrës së menaxhimit të kësaj fushe të rëndësishme janë identifikuar si të dobëta. Megjithatë, Inspektorati policor në mënyrë të njëjtë njih vullnetin e mirë dhe entuziasmin në mesin e hetuesve të SHPK-së të të gjitha gradave. Puna e tyre e zellshme dhe përkushtimi – shpesh në kushte mjaft të vështira pune dhe përballë rrezikut të lartë - ngrit besimin në organizatën e SHPK-së dhe ngjall shpresën për të ardhmen e Kosovës.

1.3 Ky raport prezenton sfida më të mëdha të Inspektoratit Policor sesa dokumentet e mëparshme në lidhje me mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e SHPK-së. Menaxhimi I hetimit të krimit nga ana e pjesëtarëve të SHPK-së nuk është diçka që duhet të bëhet plotësisht veçmas. Hetimi policor në Kosovë përbëhet prej përpjekjeve të përbashkëta të gjykatës, prokurorëve publik dhe policisë - e cila gjë mund të arrihet duke punuar së bashku. Pamjaftueshmëritë e përpjekjeve nga njëra prej këtyre grupeve do të ndikojnë tek grupet tjera dhe në rezultatet e përpjekjeve të përbashkëta. Pasiqë Inspektorati policor nuk ka as kompetencë e as dëshirë për të vëzhguar efektivitetin e gjyktave dhe prokurorëve publik, duhet që në mënyrë të pashmangshme të rëxhistrojë ato çështje të cilat janë nën përgjegjësinë e përbashkët të policisë dhe grupeve tjera.

1.4 Ende nuk janë implementuar plotësisht dispozitat e reja të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (2004). Në veçanti, njësitet e policisë gjyqësore nuk janë përzgjedhur dhe caktuar nëpër pozita ende, të cilat njësitet do të mundësonin zbatimin e një numri të madh të autorizimeve policore proaktive. Ky mossakses është për t'u gjykuar duke pasur parasysh rritjen e ndjenjës së pakënaqësisë në lidhje me mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e sistemit të së drejtës penale, në veçanti në lidhje me dështimin për të gjetur dhe për t'i ndjekur penalisht atë të cilët kanë kryer vrasje dhe vepra tjera të rënda penale. Është më se e nevojshme që të bëhen përmirësime në shumë shkaqe të dështimeve në sistem dhe SHPK-ja duhet të kontribuojë në mënyrë të plotë në atë përpjekje, në bashkëpunim me prokurorët publik dhe gjykatat.

1.5 Qëllimi I inspektiveve të zakonshme është që të bëhen rekomandime për mënyrën se si menaxherët e SHPK-së mund të përmirësojnë mënyrën e kryerjes së detyrave në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe legjislacionin përkatës;
- Pajtueshmërinë me standardet relevante në kuadër të *Kodit Evropian të Etikës Policore (KEEP)*;
- Përkrahjen e menaxhimit profesional të resurseve njerëzore;
- Për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve cilësore në përkrahje të tërë personelit të SHPK-së dhe
- Për të identifikuar dhe shpërndarë praktikën më të mirë.

1.6 Gjatë inspektimit, pjesëtarët e Inspektoratit Policor vizituan dhe intervistuan punonjësit e SHPK-së në vijim:

- Asistent I Zëvendës Komesarit, hetime të krimit
- Drejtor, Departamenti për hetimin e krimeve të rënda
- Drejtor, Departamenti për hetimin e krimit të organizuar
- Drejtor, Departamenti i krimteknikës (forenzikës)
- Drejtor, Departamenti I Analizës së krimit
- Menaxherët e lartë të SHPK-së në Administratën qendrore (shtabin kryesor)
- Komandantët regional dhe/ose Zëvendës Komandantët Regional/ hetimet e krimit
- Shefat regional të njësiveve të specializuara për hetime
- Shefat e njësive të hetimit të krimit në nivel stacioni

1.4 Ky raport është përgatitur në bazë të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës publike I cili parim është I mbështetur në nenin 19 të Kodit Evropian të Etikës Policore.

## 2. Kryerja e Detyrave në Menaxhimin e Hetimit të Krimit

### Organizimi

2.1 Kosova ka trashëguar një sistem të së drejtës penale të zhvilluar nëpër tërë RF të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky sistem është një ndryshim në sistemin e kodifikuar 'frëngo-belg' në të cilin 'gjyqtarët hetues' udhëheqin hetimet penale në një sistem inkuizitorial dhe në të cilin policia luan rol sekondar dhe ndihmës. Në vitin 2004 u ndryshua sistemi I së drejtës penale të Kosovës: Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (2004) paraqiti ndryshime të cilat ndihmuan që sistemi të jetë në pajtueshmëri me praktikën moderne franceze. Në Kodin e ri nuk ekziston institucioni I gjyqtarit hetues dhe prokurorëve publik u jep autorizime të konsiderueshme në udhëheqjen e hetimeve penale me ndihmën e 'policisë gjyqësore'. Prokurorëve publik u ipen një varg I gjërë autorizimesh të reja – përfshirë vëzhgimin dhe kontrollimin - të cilat ekzekutohen nga policia gjyqësore Ligji në mënyrë të qartë parasheh prokurorin publik si një udhëheqës energjik të ekipeve

dinamike dhe proaktive të policisë gjyqësore, në luftimin e krimit të organizuar dhe veprave të rënda penale.

2.2 Për arsye të ndryshme nuk është kuptuar vizioni I Kodit. Gjatë inspektimit të rëndomtë, Inspektorati policor vërejtë se policia gjyqësore nuk është implementuar ende. Shumica e masave proaktive të Kodit mbeten të pazbatuara pasi që prokurorët publik dhe zyrtarët policor operojnë në masë të madhe sipas strategjisë reaktive (d.m.th presin derisa të kryhet krimi e pastaj ndjekin kriminelët). Inspektorati policor beson se shumë dobësi dhe të meta në sistemin e tanishëm të hetimit të krimit mund të rregullohen ose përmirësohen me angazhimin e kujdesshëm dhe fazor të njësiteve të policisë gjyqësore nëpër të gjitha regjionet. Për më tepër, Inspektorati përkrah skemën implementuese e cila do t'iu mundësonte prokurorëve publik që të udhëheqin në mënyrë aktive njësitet e policisë gjyqësore në vend të praktikës së tanishme sipas së cilës prokurorët veprojnë sipas një mënyre mjaft të pavarur.

#### Rekomandimi kryesor nr. 1

*Inspektorati Policor fuqimishtë rekomandon që kodi I Përkohshëm I Procedurës Penale (2004) të implementohet plotësishtë. Në veçanti, njësitet e policisë gjyqësore duhet të formohen si njësite të cilat në mënyrë aktive drejtohen nga prokurorët publik dhe veprojnë siaps një qasjeje më proaktive në fushën e hetimit të krimit.*

2.3 Në vitin 2006 Komisioneri I Policisë riorganizoi përbërësit qendror të strukturës së hetimit të krimit. Ekzistojnë tri nivele të angazhimit në fushën e hetimit të krimit në SHPK: njësi në nivel shtabi, në nivel regjional dhe në nivel të stacioneve. Departamentet (ose Drejtoratet) e Krim-teknikës (Forenzikës), e krimeve të rënda dhe analizës së krimit janë transferuar plotësishtë tek SHPK-ja nga policia civile e UNMIK-ut, në strukturë të riorganizuar. Këto departamente ofrojnë përkrahje nga specialistë, politika dhe procedura operative, kontroll të centralizuar të inteligjencës dhe të dhënave për krimin dhe përkrahje operative në raste të krimit të organizuar dhe veprave të rënda penale.

2.4 Në kuadër të secilit regjion të SHPK-së ekziston një numër policësh të caktuar në detyrë- të cilët punojnë kryesisht në uniformë – si specialistë të hetimit të krimeve. Ndarja e punës nëpër regjione është e definuar sipas kategorisë së krimit: rastet e vrasjeve, dhunimit, lëndimeve të rënda trupore, drogës, trafikimit dhe të gjitha rastet e humbjeve financiare që kalojnë shumën prej 15,000 EURO hetohen nga njësitet regjionale të hetimit të krimit. Të gjitha rastet tjera hetohen nga njësitet e hetimit të krimit në nivel të stacionit. Shpërndarja e personelit brenda njësiteve regjionale ndryshon prej një vendi në tjetrin; sidoqoftë, në shumicën e rasteve policët janë të caktuar në njësite varësishtë nga lloji I veprës penale (p.sh vrasje, drogë, krimet ekonomike, veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe veprat penale kundër pasurisë).

2.5 Sipas dispozitave të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (2004) policët e të gjitha gradave duhet të punojnë në bashkëpunim të plotë me prokurorin publik I cili me ligj është I autorizuar për të kryer hetimet dhe për të urdhëruar përdorimin e autorizimeve nga ana e policisë. Inspektorati policor vërejtë se në shumë vende, policët e SHPK-së treguan se niveli I bashkëpunimit të tyre me prokurorët publik nuk është I mirë. Referencë e veçantë u është bërë problemeve në lidhje me komunikimin fizik me prokurorë dhe perceptimit se prokurorët ' nuk do të jenë në dispozicion' në situata të papërshtatshme për ta. Strukturës së tanishme I mungojnë kanalet efektive të informimit në mes të SHPK-së dhe gjykatave dhe prokurorëve

publik. Kjo e dobësi e menaxhimit do të thotë që SHPK-ja – në zona të caktuara gjeografike- nuk mund të merr lehtë informatat për statusin e rasteve të ndjekura ose vendimeve në lidhje me hetimin e tyre.

#### Rekomandimi kryesor nr. 2

*Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë së drejtësisë, të përpilojë dhe miratojë procedurat e punës të cilat do të përmirësojnë komunikimin në mes të gjitha grupeve.*

2.6 Ndoshta tani është shumë herët për të matur efektivitetin e sistemit të tanishëm të shpërndarjes në detyrë të policëve hetues. Siq do të diskutohet më vonë në këtë raport, ekziston pamjaftueshmëri e të dhënave gjithpërfshirëse në lidhje me mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e njësiteve të ndryshme të hetimit të krimit. Në çfardo rasti, siq është përmendur më herët, krijimi i policisë gjyqësore duhet domosdo të përfshijë një ristrukturim radikal të mënyrës sipas së cilës SHPK-ja vepron në përkrahjen e prokurorëve publik sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale. Gjatë këtij procesi të ristrukturimit duhet të shqyrtohen dy çështje organizative. Së pari, prokurorët publik dhe hetuesit e SHPK-së (policia gjyqësore) duhet të bashkëpunojnë më shumë dhe të formojnë *ekipe* e jo të punojnë në mënyrë të ndarë dhe në grupe të pavarura. Vetëm në këtë mënyrë do mund të adaptojnë një qasje më proaktive në luftimin e krimeve të rënda dhe zvoglimin e problemeve aktuale të komunikimit.

2.7 Së dyti, hetuesit e SHPK-së duhet të jenë të angazhuar në mënyrë të gjeneralizuar e jo të specializuar, në kuptim të llojeve të ndryshme të veprave penale. Në këtë mënyrë prokurorëve publik dhe hetuesve të lartë do t'iu mundësojë fleksibilitet më të madh në angazhimin e resurseve maksimale në një hetim të veçantë, sipas nevojës. Prioritetet e punës duhet të caktohen në kuptim të seriozitetit të veprës penale dhe resurset policore duhet të angazhohen në pajtim me prioritetet e tilla. Për shembull, vrasja e një personi të një grupi etnik duhet që menjëherë të tërheq resurse të konsiderueshme policore në dëm të resurseve që duhet të angazhohen për raste të vjedhjeve të automjeteve apo të rasteve tjera të vjedhjeve. Në situatën aktuale një qasje e tillë nuk është e mundur pasi që policët janë të caktuar në detyrë varësishtë nga kategoritë e veprave penale.

#### Rekomandimi kryesor nr. 3

*Inspektorati policor rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë e drejtësisë, të miratojë procedurat e punës për policinë gjyqësore dhe prokurorët publik të cilat do t'iu mundësojnë atyre që të punojnë në ekipe dhe të angazhohen në mënyrë të gjeneralizuar e jo të përqendrohen sipas kategorive të caktuara të krimeve.*

2.8 Përzgjedhja (selektimi) e zyrtarëve të njësiteve për hetime të krimit është një çështje që brengosë. Praktika e tanishme përfshinë shpalljen e pozitave të lira dhe intervistimin e policëve të cilët plotësojnë kriterin minimal. Inspektorati policor beson se standardet e kryerjes së detyrave në njësitet e hetimit të krimit – e më me rëndësi- policia e ardhshme gjyqësore mund të ngriten me ndihmën e testeve përzgjedhëse, të dizajnuara për identifikimin e policëve të cilët posedojnë njohuri të nevojshme,

shkathësi dhe qëndrim për kryerjen e hetimeve. Të gjithë pjesëtarët e policisë gjyqësore dhe hetuesit tjerë duhet t'i nënshtrohen testimit për përzgjedhje paraprake dhe ky testim duhet të organizohet në dy nivele, njëri për policët e dy gradave të para, dhe tjetri që duhet të jetë më rigoroz, për zyrtarët më të lartë. Për më tepër, Inspektorati policor përkrah posedimin e diplomës së fakultetit juridik si kërkesë minimale për zyrtarët më të lartë të njësiteve të policisë gjyqësore.

#### Rekomandimi kryesor nr. 4

*Inspektorati policor rekomandon që SHPK-ja të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të testeve përzgjedhëse paraprake për të gjithë pjesëtarët e policisë gjyqësore dhe hetuesit tjerë, si dhe zyrtarët e lartë të njësiteve të policisë gjyqësore të jenë të pajisur me diplomë fakulteti në fushën e juridikut. Kjo do të ndihmojë në ngritjen e standardeve të përgjithshme të kryerjes së detyrave në fushën e hetimeve.*

2.9 Inspektorati policor vërejt një numër çështjesh brengosëse në mesin e policëve hetues, e veçanarisht në njësitet regjionale. Shumë policë mendojnë se sistemi aktual i pagesës në SHPK nuk merr parasysh rrezikun e zmadhuar gjatë hetimeve e në veçanti në rastet e veprave të rënda penale dhe krimit të organizuar. Tek shumica e policëve ekziston një frymë jogatishmërie për t'u angazhuar në rastet kur kryerësit e supozuar mund të paraqesin kërcënim për policët ose familjet e tyre. Përveq kësaj, shumë policë mendojnë se mungesa e sigurimit të rrobave civile (në mënyrë që të kryhen operacionet e vëzhgimit dhe punët tjera operative), automjeteve të pashenjuara të policisë, paisjet e vëzhgimit dhe lehtësitë tjera pengojnë SHPK-në në adaptimin e një qasje më proaktive në uljen e shkallës së krimit. Siq është përmendur në Raportin e Përkohshëm nr.3 (menaxhimi I ndërtesave), policët gjithashtu kanë shprehur pakënaqësinë për mungesën e dhomave përkatëse për intervistim dhe atyre për përpilimin e raporteve.

#### Rekomandimi kryesor nr. 5

*Inspektorati policor rekomandon që sa më parë të jetë e mundur SHPK-ja të rishqyrtojë mundësinë e pagesës dhe kushteve tjera, për pjesëtarët e njësiteve për hetime të krimit. Ky shqyrtim duhet të jetë element thelbësor i strategjisë së SHPK-së për uljen e krimit në periudhë afatmesme dhe duhet t'i adresohet të gjithë faktorëve të nevojshëm në mënyrë që të rriten mundësitë e organizatës policore për përpjekjet proaktive në luftimin e krimit.*

2.10 Në kohën kur u krye inspektimi i zakonshëm në fjalë, laboratorit i krimteknikës (forenzikës) i SHPK-së i përfunduar kohëve të fundit ishte nën rregullimin menaxherik të Administratës qendrore. Ekziston një konsensus i gjërë në mesin e zyrtarëve të lartë të SHPK-së në Drejtoratin Qendror të Hetimit të Krimit se Laboratori i Krimteknikës do të duhej të vendoset nën Departamentin e krimteknikës, respektivisht nën Drejtoratin Qendror të Hetimit të Krimit. Inspektorati policor pajtohet me këtë. Vendndodhja aktuale e laboratorit është në kundërshtim me modelin funksional<sup>52</sup> të organizatës e poashtu edhe me praktikën e rëndomtë të organizatave të mëdha policore.

<sup>52</sup> Modeli funksional i organizatës është ai i cili funksionet e llojit të njëjtë (p.sh ato të cilat kanë të bëjnë me hetimin e krimit ose ato që kanë të bëjnë me financa dhe administratë) grupohen së bashku, dhe në

**Rekomandimi kryesor nr. 6**

*Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të shqyrtojnë vendndodhjen aktuale të laboratorit të krimteknikës në strukturën organizative. Sikurse në fushat tjera, SHPK-ja duhet të ketë parasysh futjen në përdorim të një strukture organizative të bazuar në funksione të specializuara duke e përmirësuar në këtë mënyrë mënyrën e kryerjes së detyrave të nivelit menaxhues të SHPK-së.*

**Gjendja aktuale**

2.11 Numri I veprave penale të rexhistruara në Kosovë është I vogël. Tabela 1 paraqet një krahasim të dobishëm të shkallës së krimeve në Kosovë (2005) me 12 shtetë të BE-së (në vitin 2001). Me vetëm 13.8 vepra penale të evidentuara në 1000 banorë, Kosova qëndron larg nën mesatarën e vendeve të krahasuara të BE-së e cila shifër është 60.3 vepra penale në 1000 banorë e pas Republikës së Irlandës me 22.7 vepra penale në 1000 banorë (më e ulta). Veç besimit të përgjithshëm për shkallën e ultë të krimit, ekzistojnë tregues të qëndrueshëm për kërkesën e ulët (reaktive) për polici në Kosovë. Siç është treguar në tabelën 1, sasia aktuale e punës prej 4 veprave penale për çdo zyrtar policor të SHPK-së do të thotë që Kosova qëndron larg nën mesataren e BE-së që shënon 20 vepra penale për polic dhe menjëherë pas Spanjës me 5.5 vepra penale për polic (më e ulta) .

këtë mënyrë bëhet e mundur që ato të menaxhohen nga personat e kualifikuar në atë fushë të veçantë funksionale.

<b>Tabela 1</b>				
<b>Statistikat për krimin – një krahasim I 12 shtetve të BE-së me Kosovën<sup>53</sup></b>				
<b>Shteti</b>	<b>Numri I zyrtarëve policor</b>	<b>Numri I përgjithshëm i krimit të rexhistruar</b>	<b>Krimi në 1000 banorë</b>	<b>Numri I krimit të rexhistruar, për policë</b>
Austria	28 440	522,710	62.2	18.3
Belgjika	37 432	848,648 <sup>54</sup>	82.3	22.6
Danimarka k	10 228	473,290	89.3	46.2
Franca	211 258	4,061,792	73.3	19.2
Gjermania	237 198	6,363,865	77.6	26.8
Greqia	51 254	439,630	39.6	8.5
Irlanda	11 815	86,621	22.7	7.3
Italia	270 696	2,163,830	37.7	7.9
Holanda	46 341	1,219,653	72.1	26.3
Portugalia	48 339	372,170	35.7	7.6
Spanja	184 604	1,015,640	25.2	5.5
Anglia dhe Uells (MB)	125 682	5,525,316	106	43.9
Mesatarja e vendeve të BE-së			<b>60.3</b>	<b>20</b>
<b>Kosova</b>	<b>7,185</b>	<b>29,185</b>	<b>13.8</b>	<b>4</b>

2.12 Inspektorati policor vërteton se krimi I evidentuar është vetëm një tregues I përgjithshëm I shkallës së krimit ekzistues në shumicën e shoqërive, duke ditur që shumë viktima të krimit zgjedhin që të mos e njoftojnë policinë. Pa dyshim që një numër I panjohur i viktimave të krimit vendos që të mos e njoftojë policinë- e si edhe në shoqëritë tjera – ky vendim sipas së gjitha gjasave ndërlidhet me perceptimin publik për gjasat që kryerësi të sillet para drejtësisë, si dhe me faktorët tjerë. Numri i vogël i rasteve të krimit për polic krijon një përparësi reale për zyrtarët e lartë të SHPK-së: një kërkesë e tillë e vogël në kuptim të kryerjes së detyrave policore në mënyrë reaktive mundëson që një numër më I madh I resurseve policore të përqëndrohet në përpjekjet proaktive<sup>55</sup>. Përpjekjet e tilla proaktive mund të

<sup>53</sup> Të dhënat për 12 shtete të BE-së janë marrë nga m Barclay, G. & Tavares, C. *Krahasimi në nivel ndërkombëtar I statistikave të sistemit të së drejtës penale 2001*, Botimi 12/03, 24 tetor, 2003, faqe 18. Vëreni se statistikat nga vendet e EU-së janë të vitit 2001, ndërsa statistikat e Kosovës nga viti 2005 .

<sup>54</sup> I referohet vitit 2000 – shifra për vitin 2001 nuk ishte në dispozicion.

<sup>55</sup>

përqëndrohen në ato vepra penale – në veçanti vepra të rënda penale- të cilat aktualisht nuk janë raportuar ose rexhistruar.

<b>Tabela 2</b>						
<b>Statistikat e krimit – një krahasim i krimeve të caktuara në dymbëdhjetë shtete të BE-së dhe në Kosovë<sup>56</sup></b>						
<b>Shteti</b>	<b>Vrasja</b>	<b>Numri i vrasjeve në 100,000 banorë</b>	<b>Grabitja</b>	<b>Numri i grabitjeve në 100,000 banorë</b>	<b>Vjedhja e mjeteve motorike</b>	<b>Numri i vjedhjeve të mjeteve motorike në 100,000 banorë</b>
Austria	82	0.9	2,763	32.8	8,601	102.3
Belgjika	158	1.5	-	-	33,395	324.2
Danimarka	58	1.0	3,152	59.4	33,730	636.4
Franca	1,051	1.8	109,836	198.2	401,057	723.9
Gjermania	961	1.1	59,414	72.4	127,750	155.7
Greqia	158	1.4	1,707	15.3	5,702	51.3
Irlanda	56	1.4	1,397	36.7	15,964	420.1
Italia	818	1.4	67,424	117.6	243,890	425.6
Holanda	226	1.3	18,630	110.2	38,320	226.7
Portugalia	125	1.2	17,156	164.9	26,428	254.1
Spanja	460	1.1	93,504	232.0	134,583	333.9
Anglia dhe Uells (MB)	850	1.6	95,154	182.6	338,796	650.2
<b>Mesatarja e vendeve të BE-së</b>		<b>1.3</b>		<b>111.1</b>		<b>358.7</b>
<b>Kosova</b>	<b>67</b>	<b>3.1</b>	<b>486</b>	<b>23.1</b>	<b>638</b>	<b>30.3</b>

2.13 Edhe pse shkalla e përgjithshme e veprave penale të rexhistruara në Kosovë është e ulët, ekzistojnë tregues se shkalla e veprave të rënda penale është e lartë. Tabela 2 ofron një pasqyrë të gjërë të një ekuilibri mjaft të çuditshëm të veprave penale në Kosovë, në krahasim me shembujt e njejtë të vendeve të BE-së. Përderisa vjedhja e mjeteve motorike dhe grabitja janë relativisht në shkallë të ulët, vrasja vazhdon të jetë në shkallë të lartë. Siq është treguar në tabelën 2, në vitin 2005 në

<sup>56</sup> Të dhënat për 12 shtete të BE-së janë marrë nga m Barclay, G. & Tavares, C. *Krahasimi në nivel ndërkombëtar i statistikave të sistemit të së drejtës penale 2001*, Botimi 12/03, 24 tetor, 2003, faqe 18. Vëreni se statistikat nga vendet e BE-së janë të vitit 2001, ndërsa statistikat e Kosovës nga viti 2005. Të dhënat për Kosovën janë marrë nga 'Raporti vjetor i luhatjeve të Krimit – Periudha e mbuluar: 01/01/2005 – 31/12/2005', MHQ OPS CIAU, 16/04/2006.



Kosovë janë evidentuar 30.3 vjedhje të mjeteve motorike në 100,000 banorë, krahasuar me mesataren e shembujve të vendeve të BE-së prej 358.7 dhe 51.3 në Greqi (më e ulta). Ngjashëm, në Kosovë në vitin 2005 janë evidentuar vetëm 23.1 incidente të grabitjes në 100,000 banorë, krahasuar me mesataren e shembujve të vendeve të BE-së që është 111.1 dhe Greqi 15.3 (më e ulta).

2.14 Megjithatë, shkalla e vrasjeve në Kosovë është mjaft e lartë. Në vitin 2005 në Kosovë janë evidentuar 3.1 vrasje në çdo 100,000 banorë krahasuar me mesataren e shembujve të vendeve të BE-së prej 1.3 dhe 1.8 në Francë (më e larta). Duhet të përmendet se është shënuar një rënie e vazhdueshme e trendit të shkallës së vrasjeve në Kosovë, prej përafërsisht 282 (ose 13.4 për çdo 100,000 banorë) që ishte në vitin 2000. Ndonëse kjo rënie është e mirëpritur, zyrtarët e lartë të SHPK-së nuk duhet të ndalen së synuari drejt përpjekjeve të mëtutjeshme për zvoglimin e shkallës së vrasjeve në Kosovë. Inspektorati policor beson se SHPK-ja duhet të bazohet në të dhëna krahasuese, gjatë formulimit të një strategjie koherente dhe gjithpërfshirëse të uljes së krimit në Kosovë. Për zvoglimin e shkaktarëve të veprave penale kundër jetës dhe trupit duhet të vihen në përdorim më shumë resurse dhe metoda.

#### Rekomandimi kryesor nr. 7

*Inspektorati policor nxitë SHPK-në në përdorimin e të dhënave krahasuese për veprat penale si udhëzues në procesin e formulimit të një strategjie koherente dhe gjithpërfshirëse të uljes së krimit në Kosovë. Kjo strategji duhet të synojë në luftimin e shkaqeve rrënjësore të veprave penale kundër jetës dhe trupit.*

2.15 Sa l përket menaxhimit të përgjithshëm të hetimit të krimit, përdorimi aktual i statistikave të krimit në SHPK, si mjet i menaxhmentit, është shumë i dobët. Inspektorati Policor identifikoi dy fusha kryesore që janë brengosëse. Së pari, ekziston mungesë e njëtrajtshmërisë si në format poashtu edhe në përmbajtje të statistikave kryesore në nivele regjionale dhe qendrore të SHPK-së. Kjo jonjëtrajtshmëri është rezultat i mungesës së konsensusit në lidhje me definimin e kategorive të veprave penale dhe metodave përkatëse të grumbullimit të të dhënave dhe e cila gjë ka rezultuar në përdorimin e formave të ndryshme nëpër regjione të ndryshme. Rezultati përfundimtar është një nivel i papranueshëm i pasaktësisë dhe pasigurisë për rënien e saktë të llojeve të ndryshme të krimit. Urgjentisht kërkohet një qasje e re. SHPK-ja këshillohet që të zhvillojë një format dhe metodologji të vetme në mbledhjen dhe krahasimin e statistikave të krimit. Në mënyrë që të ndihmohet në krijimin e një 'standardi të ardhshëm'<sup>57</sup>, SHPK-ja duhet të mundohet të zhvillojë një sistem të statistikave të krimit që është në përputhshmëri me shtetet kryesore të BE-së dhe sa më shumë që është e mundur, me shtetet tjera të Ballkanit

<sup>57</sup> Termi 'standard' është përdorur në këtë rast për të shpjeguar praktikën e identifikimit të treguesve kryesor të kryerjes së detyrave në organizatën policore dhe krahasimin e tyre me treguesit e njejtë në organizatat tjera policore. Kjo mundëson një vlerësim më objektiv se sa mire funksionon një organizatë në një fushë të caktuar.

**Rekomandimi kryesor nr. 8**

*Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon SHPK-në në përdorimin e një formati dhe metodologjie të mbledhjes dhe krahasimit të të dhënave (statistikave) për vepra penale. Kjo qasje duhet të zbatohet fuqimishtë në 12 muajt e ardhshëm dhe duhet të jetë në përputhje me të dhënat statistikore të vendeve kryesore të BE-së.*

2.16 Së dyti, të dhënat e tanishme në dispozicion, për kryerjen e hetimeve penale nuk përmbajnë informatat kryesore për mënyrën e kryerjes së detyrave. Kjo tabelë tregon statusin e 890 rasteve të evidentuara të vrasjeve në Kosovë në mes vitit 2000 dhe 2005. Me përdorimin e një klasifikimi themelor të 'rasteve të mbyllura' dhe 'rasteve të hapura', ky sistem i klasifikimit, menaxhmentit të SHPK-së nuk i ofron të dhëna të mjaftueshme për marrjen e vendimeve në lidhje me përmirësimin e mënyrës së hetimeve të krimit në të ardhmen. Në të vërtetë, kjo tabelë më shumë nxitë pyetje sesa që përgjigjet. Çështjet themelore të menaxhimit të hetimit të krimit nuk janë trajtuar, përfshirë:

- Numri i personave të ndjekur penalisht me sukses;
- Periudha kohore në mes kryerjes së veprës dhe ndjekjes penale / mbyllja e rastit;
- Periudha kohore në mes vendimit për të ndjekur penalisht dhe ndjekjes penale /mbyllja e rastit;
- Arsyet (në përgjithësi) për dështimet gjatë hetimit/ndjekjes penale
- Përgjegjësia e prokurorit publik/ njësiteve hetuese.

2.17 Inspektorati policor e pranon faktin se ky sistem i klasifikimit është i trashëguar e jo i krijuar nga SHPK-ja. Përveq kësaj ky sistem dhe burimet e tij të të dhënave tanimë janë përpjekje e përbashkët e prokurorëve publik, gjykatave dhe Ministrisë së drejtësisë. Tabela 3 shumë pak e fsheh performancën shumë të dobët të sistemit të të së drejtës penale në Kosovë në lidhje me hetimet e vrasjeve për gjashtë vitet e fundit. Natyrisht se ekzistojnë shumë arsye për performancën e dobët dhe përgjegjësia bie mbi një numër organizatash. Sidoqoftë, për Inspektoratin policor nuk është me rëndësi që të caktohen fajtorët e as të zvogëlohet rëndësia e problemeve në hetimin e vrasjeve në Kosovë (jogatishmëria e bashkëpunimit nga ana e dëshmitarëve dhe informatorëve). Duhet të bëhen përpjekje në gjetjen e mënyrave të cilat do të ndihmonin që sistemi i së drejtës penale të jetë më efektiv dhe në veçanti, përmirësimin e efektivitetit të kontributit të SHPK-së në punën e prokurorëve publik dhe gjykatave.

Tabela 3								
Renditja e rasteve të evidentuara të vrasjeve në Kosovë: 2000 - 2005 <sup>58</sup>								
Statusi i rasteve		2000	2001	2002	2003	2004	2005	Totali
Rastet e 'hapura'	Jo aktive	23	12	10	3	2	1	51
	Nën hetime	151	77	35	28	34	32	357
	<b>Totali</b>	<b>174</b>	<b>89</b>	<b>45</b>	<b>31</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>408</b>
Rastet e 'mbyllura'	Të mbyllura nga gjykata	11	20	7	2	2	-	42
	Special të mbyllura	35	32	14	2	6	3	92
	Të refuzuara nga prokurori	3	1	-	-	-	-	4
	Nuk është ndërmarrë asnjë veprim	5	17	4	3	6	2	37
	Të ndjekura penalisht	52	70	56	50	33	39	300
	Të pagjetura	2	1	-	3	1	-	7
	<b>Totali</b>	<b>108</b>	<b>141</b>	<b>81</b>	<b>60</b>	<b>48</b>	<b>44</b>	<b>482</b>
<b>Totali përfundimtar</b>		<b>282</b>	<b>230</b>	<b>126</b>	<b>91</b>	<b>84</b>	<b>77<sup>59</sup></b>	<b>890</b>

2.18 Hapi I parë drejt përmirësimit përfshinë sigurimin e të dhënave të sakta dhe të dobishme në lidhje me mënyrën e kryerjes së detyrave në këtë fushë të rëndësishme. Kjo duhet të tregojë qartë shkallën e zbrazëtirës në kryerjen e detyrave – d.m.th numri i rasteve të vrasjes për të cilën nuk është ndjekur penalisht asnjë person. Gjithashtu duhet të përfshijë edhe informata që qarta dhe gjithëpërfshirëse për moskryerjen me sukses të detyrave policore- dmth problemet kyçe në identifikimin e të dyshimtëve dhe sigurimin e provave të mjaftueshme për të dënuar të dyshimtit e njohur (ditur). Përfundimisht, statistikave të krimit paraqesin mjetin për matjen e kohës së shpenzuar për kryerjen e hetimit dhe procesit të ndjekjes penale – raporti i numrit të rasteve nën hetime me numrin e muajve.

2.19 Kjo qasje e të dhënave për kryerjen e detyrave në fushën e hetimeve të krimit duhet të aplikohet te të gjitha kategoritë e veprave penale, e jo vetëm te vrasjet. Sigurimi i këtyre të dhënave mund të ndihmojë zyrtarët e lartë të SHPK-së në marrjen e vendimeve dhe hartimin e strategjive në fushën e hetimit të krimit. Këto të dhëna në lidhje me mënyrën e kryerjes së detyrave ndikojnë në procesin e marrjes

<sup>58</sup> Të dhënat në këtë tabelë janë marrë nga Departamenti I analizës së krimit, Shtabi I SHPK-së në dhjetor të vitit 2006.

<sup>59</sup> Është vërejtur se numri total i rasteve të vrasjeve për vitin 2005 në tabelën 3 dallon nga ai në tabelën 2. Që të dy shifrat Inspektorati policor I ka siguruar nga Departamenti I analizës së krimit, megjithëse për qëllime të ndryshme. Departamenti e pranon mospërputhjen si shembull i problemeve aktuale të shtëpisë së statistikave të SHPK-së dhe pohoi se hetimet për të dhëna të sakta janë në zhvillim.

së vendimeve të menaxhmentit në lidhje me shpërndarjen e resursve njerëzore, për nevojat për trajnim dhe logjistikë për policët e njësiteve të hetimit të krimit, teknikat e hetimit, iniciativat për informim publik dhe çështjet tjera relevante.

#### Rekomandimi kryesor nr. 9

*Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja – në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë- të bëjë një rishikim të përdorimit të të dhënave për mënyrën e kryerjes së detyrave në fushën e hetimit të krimit me qëllim të krijimit të një sistemi të ri, i cili do të ofronte informata përkatëse të cilat do të pasqyronin strategjinë e menaxhimit të SHPK-së në hetimin e krimit.*

#### Politika dhe strategjia

2.20 Zyrtarët e Inspektoratit policor vërejtën se mënyra e reagimit të policisë ndaj krimit nëpër regjione të ndryshme është pothuajse plotësisht reaktive: dmth zyrtarët policor reagojnë në rastet e krimit vetëm pasiqë krimi të jetë kryer. Zyrtarët e Inspektoratit ishin të zhgënjyer për shkak të mosekzistimit të politikave dhe strategjive të shkruara për hetime të krimit në njësitet regjionale të hetimit të krimit. Ky mosekzistim vie në shprehje edhe më shumë nëse mirret parasysh shkalla e ultë e krimit për polic, dhe angazhimi i një numri tejet të madh të policëve për përpjekjet proaktive në gjetjen e kriminelëve dhe luftimin e aktiviteteve kriminale. Urgjentisht kërkohet që SHPK-ja – në bashkëpunim të ngushtë me prokurorin publik - të fillojë me 'zvoglimin e pasojave' duke ndaluar së praktikuari qasjen reaktive për luftimin e të gjitha llojeve të krimit p.sh pritet derisa të kryhet ndonjë veprë penale e pastaj të ndërmiren veprimet.

2.21 Një hap i tillë drejt qasjes proaktive në luftimin e krimit duhet të inicohet nga maja e organizatës dhe në mënyrë përkatëse të artikulohet dhe komunikohet nëpërmes një strategjie formale. Kjo nevojë paraqet një sfidë të madhe për tërë organizatën, përshkak se një numër i madh i zyrtarëve të lartë kanë përvojë të kufizuar në pozitën e tyre të reja e poashtu organizata ka pak përvojë operative e cila duhet të fitohet tutje. Inspektorati policor përpigjet për angazhimin e këshilluesve ndërkombëtarë të cilët do të ndihmonin zyrtarët e lartë të SHPK-së në trajnimin në vendin e punës. Për dallim nga njohuritë kryesore teorike të cilat fitohen në trajnimin dhe edukimin në klasë, intervenimet e tilla në vendin e punës mund të ndihmojnë në procesin e krijimit dhe implementimit të strategjisë proaktive për luftimin e krimit.

#### Rekomandimi kryesor nr. 10

*Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë – të hartojë dhe zbatojë strategjitë për uljen e krimit, në nivele qendrore dhe regjionale. Ato strategji duhet të përfshijnë plotësishtë prokurorët publik dhe të kenë për qëllim zëvendësimin e metodave krejtësishtë reaktive në luftimin e të gjitha llojeve të krimit.*

## Lista e rekomandimeve kryesore

Inspektorati Policor i Kosovës ia paraqet rekomandimet në vijim Komisarit të UNMIK-ut dhe personelit të lartë të SHPK-së, në pajtim me dispozitat e Rregullores 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9.

### 1. Detyrat policore në trafikun rrugor

1. Është propozuar që SHPK-ja të udhëheq një rishikim urgjent të sistemit të tanishëm të servisimit dhe kalibrimit të të gjitha pajisjeve të zbulimit (p.sh. pajisje për zbulimin e shpejtësisë (radarit) dhe pajisje për zbulimin e alkoolit (alkotest) që shfrytëzohen nga Njësitë e Trafikut Regjional dhe të implementojë ndryshime për të siguruar maksimumin në arritjen e pajisjeve të tilla.
2. Sa më parë që është e mundur SHPK-ja duhet të prezentojë një procedurë standarde të operimit që kërkon shënime formale të mbledhjeve ndërmjet Komandantave të SHPK-së dhe komuniteteve vendore dhe autoriteteve komunale. Posaqërisht, këto shënime do të duhet të identifikojnë agjendën e mbledhjeve dhe rezultatet e arritura nga SHPK-ja dhe pjesëmarrësit e tjerë. Procedura e rishikuar, po ashtu, duhet të adresojë nevojën për progresin e raportit që ofron detaje të ndryshimeve të qarta që rezultojnë nga veprimet e ndërmarrura.
3. Rekomandohet fuqimisht që SHPK-ja të pajtohet dhe të implementojë një sistem të përbashkët të kategorizimit dhe prezentimit të informatave në lidhje me aksidentet.
4. SHPK-ja duhet të nxitet të përgatisë dhe implementojë një sistem të mbledhjes së informatave në lidhje me shkaqet e faktorëve të aksidenteve nga raportet e hetimeve të aksidenteve fatale dhe me lëndime. Informatat përfundimtare duhet të jenë në dispozicion të të gjithë stafit komandues regjional dhe të shrytëzohen në hartimin e politikave dhe strategjive të trafikut në rrugë.
5. SHPK-ja këshillohet të fillojë një rishikim të sofistikuar të dobësive të njohura dhe pëmirësimeve të mundshme në dispozitat ligjore në lidhje me shtimin e rasteve të kundërvajtjeve dhe shtimin e numrit të standardeve. Ky rishikim duhet të marrë parasysh sistemet e suksesshme të përdorura në pjesët e tjera të Evropës dhe duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoratin e Politikave për Kryerjen e Punës Policore (Ministria e Punëve të Brendshme), Ministrinë e Transportit dhe Ministrinë e Drejtësisë.
6. Në rastin e parë që t'i jepet SHPK-ja duhet të aranzhojë trajnim të përshtatshëm për zyrtarët në pozita udhëheqëse në përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe strategjive të trafikut rrugorë regjional.

## 2. Menaxhimi i parkut të automjeteve

1. SHPK-ja nxitet që ta dizajnojë dhe implementojë një sistem të krahasimit të faktorëve të cilët i shkaktojnë aksidentet, nga raportet për hetimin e aksidenteve në lidhje me të gjitha aksidentet ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së. Të dhënat përfundimtare duhet të përdoren nga personeli i lartë që të identifikojnë hapat përkatës në zvogëlimin e aksidenteve të tilla, si pjesë e një politike dhe të strategjive të përgjithshme.
2. SHPK-ja nxitet që të rishikojë procedurat e saj në lidhje me zyrtarët që shkaktojnë dëme në automjetet e SHPK-së, nga pakujdesia ose me vetëdije. Ky proces duhet të jetë në përputhshmëri me dispozitat e reja të Urdhëresës Administrative 2006/9 (shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës policore), dhe marrjen në konsideratë të aplikimit të diskualifikimeve të menjëhershme nga ngasja dhe ndëshkimet financiare përkatëse.
3. Këshillohet që SHPK-ja ta iniciojë procesin e dizajnit të politikës gjithpërfshirëse të parkut të automjeteve dhe të strategjisë implementuese në lidhje me prokurimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e parkut të tyre të automjeteve. Ky proces dizajnuet duhet të jetë i frymëzuar nga parimi i kostos së efektshmërisë dhe i udhëzuar nga një plan gjithpërfshirës policor që i njeh anët pozitive dhe kufizimin e automjeteve patrulluese lëvizëse për arritjen e qëllimeve të SHPK-së.
4. Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve, personeli i lartë i SHPK-së këshillohet që të rishikojë madhësinë e parkut të automjeteve, llojet e automjeteve të cilat përdoren dhe shpërndarjen e tyre në mbështetje të masave proaktive dhe reaktive. Duhet ekzistojnë lidhje në mes të planeve të aktiviteteve policore lokale të përshkruara në rregulloren 2005/54.
5. Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, personeli i lartë i SHPK-së inkurajohet që të konsiderojë skemat alternative për prokurim dhe largimin e automjeteve nga përdorimi. Duhet të bëhet një studim rreth skemave operative në organizatat tjera policore të cilat mund të sigurojnë kosto me përfitime më të mëdha në periudha afatgjate sipas standardeve të larta.
6. Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, personeli i lartë i SHPK-së këshillohet që të bëjë një studim të beneficioneve përkatëse — në lidhje me koston dhe shpejtësinë— për të rritur nivelin e decentralizimit të mirëmbajtjes së automjeteve. Ky studim duhet të ketë parasysh beneficionet e rritjes së kthimit të pronësisë të parkut të automjeteve të SHPK-së në nivel lokal dhe regjional.
7. Si pjesë e politikës së parkut të automjeteve të SHPK-së, zyrtarët e lartë të SHPK-së nxitet të krijojnë dhe implementojnë një sistem më të qëndrueshëm në zvogëlimin e numrit të aksidenteve, ku janë të përfshira automjetet e SHPK-së.

## 3. Menaxhimi i objekteve

1. SHPK-ja nxitet që ta caktojë një drejtor të kualifikuar për Drejtorinë e Objekteve, sa më shpejtë që është e mundur. Funkcioni i këtij menaxhimenti është vendimtar për suksesin e qëllimeve të SHPK-së në mënyrë që të zhvillojë dhe të mirëmbajë ndërtesat adekuate për tërë personelin e SHPK-së për periudhën afatmesme.

2. Zyrarët e lartë të SHPK-së këshillohen që urgjentisht t'i rishikojnë standardet e mbrojtjes nga zjarri në të gjitha stacionet policore, me qëllim të futjes në përdorim dhe mirëmbajtjes së pajisjeve për mbrojtje nga zjarri si dhe stërvitjen e rregullt të personelit.
3. Zyrarët e lartë të SHPK-së inkurajohen të rishikojnë politikën e cila aktualisht pengon hapjen e menseve nëpër stacionet policore, si mënyrë e përmirësimit të moralit të policëve për punë dhe zvogëlimit të imazhit negativ për policët e mbledhur në kafeteri.
4. Administrata e SHPK-së nxitet të fillojë një hetim të plotë për faturat tejet të mëdha për ujë në regjionin e Prishtinës si dhe rritjen alarmuese të shpenzimeve të telefonit në SHPK.
5. Inspektorati këshillon SHPK-në të zhvillojë një dokument të plotë për strategjinë e menaxhimit të ndërtesave dhe të sigurojë se kjo strategji iu komunikohet në mënyrë përkatëse komandantëve regjionalë. Ky dokument duhet të përfshijë kriterin për priorizimin e punës, standardet minimale në lidhje me hapësirën e punës për punonjësit, masat për mbrojtje kundër zjarrit dhe kushtet specifike për stacionet policore
6. Inspektorati Policor nxit administratën e SHPK-së që të përfshijë në mënyrë të plotë personelin nëpër regjione në procesin e planifikimit të objekteve të reja dhe renovimin e ndërtesave ekzistuese në kuadër të sferës së tyre komanduese.

#### 4. Arrestimi dhe ndalimi

1. Zyrarët e lartë të SHPK-së këshillohen që urgjentisht të unifikojnë procedurat dhe formularët shoqërues për ndalim policor, me qëllim të ofrimit të standardeve të njëjta në tërë Kosovën.
2. Zyrarët e lartë të SHPK-së duhet të rishikojnë procedurat dhe politikat aktuale me qëllim të rritjes së sigurisë së dosjeve të ndalimit dhe pronës personale të personave të ndaluar.
3. Zyrarët e lartë të SHPK-së këshillohen të rishikojnë aspektet për shëndet dhe siguri të procedurave të SHPK-së, që kanë të bëjnë me ndalimin policor. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ushtrimeve të evakuimit, përdorimit të dorzave, dhe sigurimit të paisjeve për ndihmën e parë.
4. Zyrarët e lartë të SHPK-së nxiten që të rishikojnë politikat dhe procedurat e tyre në lidhje me sigurimin e hapësirave të mjaftueshme dhe përkatëse të ndalimit në mënyrë që të parandalohen praktikatat e këqija dhe të sigurojnë pajtueshmëri të plotë me ligjin e aplikueshëm.
5. Zyrarët e lartë të SHPK-së fuqimisht këshillohen të zhvillojnë një strategji të shkruar për ndalimin policor sa më shpejt që është e mundur. Kjo strategji duhet të kërkojë racionalizimin e sigrimit të dhomave të ndalimit, duke rritur në masë të madhe cilësinë dhe kapacitetin e këtyre hapësirave duke patur parasysh problemet gjithpërfshirëse financiare.
6. Zyrarët e lartë të SHPK-së këshillohen që të shqyrtojnë mundësinë për përdorimin e një ose dy qendrave të ndalimit në çdo regjion si mjet i përmirësimit të cilësisë së punës në mënyrën më efektive.
7. Zyrarët e lartë të SHPK-së këshillohen të adaptojnë politikën e zgjedhjes dhe trajnimit të personelit të dedikuar të SHPK-së për menaxhimin dhe operimin e qendrave të ndalimit policor. Kjo qasje do të ndihmonte në tendencën për të

përmirësuar standardet të cilat do të jenë në dobi të të ndaluarve dhe personelit të SHPK-së.

## 5. Burimet njerëzore

1. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të përgatisin të dhëna të hollësishme në lidhje me efikasitetin e SHPK-së, sa i përket incidenteve gjatë punës reaktive policore dhe iniciativave proaktive. Të dhënat e tilla janë të rëndësishme si mjete për matjen e efikasitetit në arritjen e objektivave të SHPK-së, si dhe të merren vendime të bazuara për shpërndarjen e policëve.
1. Inspektorati Policor inkurajon zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të sigurohen se të gjitha gradat dhe rolet brenda strukturës së SHPK-së të jenë të definuara në mënyrë të duhur me shkrim dhe në formë të dokumentuar. Definimi i tillë i roleve duhet të përmbajë profilin e plotë të punës, si dhe përshkrimin standard të vendit të punës.
2. Inspektorati Policor rekomandon që procesi i stabilizimit të strukturës së menaxhimit brenda njësive të komandës regjionale duhet të përshpejtohet, në këtë mënyrë bëhet largimi i diferencave të mëdha në menaxhmentin e SHPK-së, shtrirjen e kontrollit dhe zvogëlimin e nivelit të mbikëqyrjes në mes të tri gradave të para.
3. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së duhet ta rishikojnë strukturën fillestare komanduese në nivele regjionale dhe të marrin parasysh dobitë potenciale të një modeli të bazuar në 4 (ose 5) grada të menaxhimit. Rishikimi duhet të ketë parasysh se si 'zinxhiri komandues' dhe komunikimi mund të përmirësohen, si dhe lidhja në mes 'shtrirjes së kontrollit' dhe definimit të rolit.
4. Inspektorati Policor rekomandon që komandantët regjional - veçanërisht ata në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren - duhet të ndërmarrin veprime urgjente për të hetuar dhe ndaluar shkallën e lartë të pushimeve mjekësore në mesin e policëve të tyre. Kjo duhet të përfshijë një regjim më rigoroz të monitorimit të pushimit mjekësor 'të paautorizuar' (p.sh. 1 – 3 ditë pushim mjekësor, për të cilin nuk nevojitet vërtetim nga mjeku).
5. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së duhet, në rastin e parë që do t'u jepet, të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse që dukshëm do të zvogëlojë numrin e ditëve të humbura përmes formave të ndryshme të mosprezencës në punë. Strategjia duhet të identifikojë numrin e caktuar të ditëve për policë, si dhe një varg masash të disejnuara për të arritur objektivin për vitin 2007.
6. Inspektorati Policor rekomandon që zyrtarët e lartë policor të SHPK-së të zhvillojnë një strategji gjithëpërfshirëse në lidhje me burimet njerëzore për një periudhë kohore prej 1 – 3 vjet, strategji e cila duhet t'i merr parasysh pikëpamjet e personelit të SHPK-së, veçanërisht rreshterëve të operativës dhe policëve të patrullës. Strategjia duhet të bëjë të njohur rëndësinë e këtyre çështjeve që ndikojnë në motivimin e personelit dhe shkallën e pushimeve mjekësore.



## 6. Hetimet e krimit

1. Inspektorati Policor fuqimishtë rekomandon që kodi I Përkohshëm I Procedurës Penale (2004) të implementohet plotësishtë. Në veçanti, njësitet e policisë gjyqësore duhet të formohen si njësite të cilat në mënyrë aktive drejtohen nga prokurorët publik dhe veprojnë siaps një qasjeje më proaktive në fushën e hetimit të krimit.
2. Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, të përpilojë dhe miratojë procedurat e punës të cilat do të përmirësojnë komunikimin në mes të të gjitha grupeve.
3. Inspektorati policor rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë e drejtësisë, të miratojë procedurat e punës për policinë gjyqësore dhe prokurorët publik të cilat do t'iu mundësojnë atyre që të punojnë në ekipe dhe të angazhohen në mënyrë të gjeneralizuar e jo të përqendrohen sipas kategorive të caktuara të krimeve.
4. Inspektorati policor rekomandon që SHPK-ja të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të testeve përzgjedhëse paraprake për të gjithë pjesëtarët e policisë gjyqësore dhe hetuesit tjerë, si dhe zyrtarët e lartë të njësiteve të policisë gjyqësore të jenë të pajisur me diplomë fakulteti në fushën e juridikut. Kjo do të ndihmojë në ngritjen e standardeve të përgjithshme të kryerjes së detyrave në fushën e hetimeve.
5. Inspektorati policor rekomandon që sa më parë të jetë e mundur SHPK-ja të rishqyrtojë mundësinë e pagesës dhe kushteve tjera, për pjesëtarët e njësiteve për hetime të krimit. Ky shqyrtim duhet të jetë element thelbësor I strategjisë së SHPK-së për uljen e krimit në periudhë afatmesme dhe duhet t'i adresohet të gjithë faktorëve të nevojshëm në mënyrë që të rriten mundësitë e organizatës policore për përpjekjet proaktive në luftimin e krimit.
6. Inspektorati policor rekomandon që zyrtarët e lartë të SHPK-së të shqyrtojnë vendndodhjen aktuale të laboratorit të krimteknikës në strukturën organizative. Sikurse në fushat tjera, SHPK-ja duhet të ketë parasysh futjen në përdorim të një strukture organizative të bazuar në funksione të specializuara duke e përmirësuar në këtë mënyrë mënyrën e kryerjes së detyrave të nivelit menaxhues të SHPK-së.
7. Inspektorati policor nxitë SHPK-në në përdorimin e të dhënave krahasuese për veprat penale si udhëzues në procesin e formulimit të një strategjie koherente dhe gjithpërfshirëse të uljes së krimit në Kosovë. Kjo strategji duhet të synojë në luftimin e shkaqeve rrënjësore të veprave penale kundër jetës dhe trupit.
8. Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon SHPK-në në përdorimin e një formati dhe metodologjie të mbledhjes dhe krahasimit të të dhënave (statistikave) për vepra penale. Kjo qasje duhet të zbatohet fuqimishtë në 12 muajt e ardhshëm dhe duhet të jetë në përputhje me të dhënat statistikore të vendeve kryesore të BE-së
9. Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja – në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë e drejtësisë- të bëjë një rishikim të përdorimit të të dhënave për mënyrën e kryerjes së detyrave në fushën e hetimit të krimit me qëllim të krijimit të një sistemi të ri, I cili do të ofronte informata përkatëse të cilat do të pasqyronin strategjinë e menaxhimit të SHPK-së në hetimin e krimit.

10. Inspektorati policor fuqimishtë rekomandon që SHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë – të hartojë dhe zbatojë strategjitë për uljen e krimit, në nivele qendrore dhe regjionale. Ato strategji duhet të përfshijnë plotësishtë prokurorët publik dhe të kenë për qëllim zëvendësimin e metodave krejtësishtë reaktive në luftimin e të gjitha llojeve të krimit.

## PROCEDURA STANDARDE E OPERIMIT (PSO)

### Inspektimet e Shërbimit Policor të Kosovës

#### 1. Hyrje

Direktivat në vijim në kryerjen e inspektimeve të Shërbimit Policor të Kosovës duhet të aprovohen nga Ministri i Punëve të Brendshme, në konsultim me OSBE-në, Misioni në Kosovë. Të gjithë anëtarët e personelit të Inspektoratit duhet t'u përmbahen këtyre direktivave, përveç nëse është shpallur ndryshe në ligjin në zbatim apo në instruksionet e dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme.

#### 2. Akreditimi i personelit të Inspektoratit

2.1 E drejta për të bërë inspektimin e SHPK-së, qoftë inspektim i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm, do të merret nga Ministri i Punëve të Brendshme. Autorizimi i tillë nuk do të merret përveç nëse oficeri i Inspektoratit e ka kaluar periudhën e trajnimit, zhvillimit dhe vlerësimit dhe ai ka demonstruar se është i aftë për të përmbushur standardin minimal të kompetencave. Kompetencat përbëhen nga njohuritë e nevojshme, shkathtësitë dhe qëndrimet e një nënpunësi të Inspektoratit dhe është përcaktuar në 'Përshkrimin e hollësishëm të punës' të nënpunësve të Inspektoratit.

2.2 Gjatë fazës së implementimit të Inspektoratit Policor, Grupi i OSBE-së për implementimin e projektit (tani e tutje 'Grupi Projektues') duhet të siguroj trajnimin e nevojshëm të zhvillimit dhe vlerësimit. Grupi Projektues do ta këshilloj Ministrin me shkrim për paraqitjen individuale të nëpunësve të Inspektoratit dhe të sigurojë dëshmi nëse ata i përmbushin standardet minimale. Pas fazës së implementimit dhe marrjes së autoritetit të plotë ekzekutiv nga kryeshefi ekzekutiv (KE) i Inspektoratit (apo kryesi i detyrës së KE-së, në mungesë të kryeshefit ekzekutiv) do të jetë përgjegjës për trajnim, zhvillim dhe vlerësim të rekrutëve të ri pas largimit të OSBE-së.

#### 3. Monitorimi i funksioneve të Inspektoratit

Pas fazës implementuese dhe marrjes së plotë të autoritetit ekzekutiv nga kryetari, Grupi Projektues do të vazhdojë të monitorojë paraqitjen e Inspektoratit në nivelin individual dhe grupor, sipas kërkesës, të sigurojë këshilla nga ekspertët, për kryeshefin ekzekutiv, kryesin e detyrës së KE-së dhe nëpunësit e Inspektoratit. Grupi Projektues duhet të sigurojë raporte të rregullta për Ministrin, udhëheqësin e Misionit të OSBE-së dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për paraqitjen e Inspektoratit.

#### 4. Kryerja e inspektimeve – Dispozitat e përgjithshme

4.1 Të gjitha inspektimet e SHPK-së do të bëhen në pajtueshmëri të plotë me ligjin në zbatim. Kryeshefi ekzekutiv (ose kryesi i detyrës së KE-së në mungesë të kryeshefit ekzekutiv) i Inspektoratit do të autorizojë Inspektoratin që të bëjë inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Shërbimit Policor të Kosovës

4.2 Inspektorati Policor duhet të përdor metodat në vijim për mbledhjen e të dhënave në fushat e paraqitjes policore, në rrjedhën e inspektimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme:

- a) Kontrollimi i gjendjes së ndërtesave, automjeteve dhe pajisjeve;
- b) Kontrollimi i regjistrave dhe dosjeve, qoftë me përmbledhje dokumentesh apo në mënyrë elektronike ose në formë të audio/videove;
- c) Intervista formale dhe jo formale me nëpunësit individualisht dhe të punësuarit e tjerë të SHPK-së;
- d) Intervista formale dhe jo formale me grupe të oficerëve policor, të punësuarve të SHPK-së dhe nëpunësve të tjerë civil;
- e) Intervista formale dhe jo formale me pjesëtarët e publikut, nëse mendohet se është e përshtatshme dhe e nevojshme me qëllim të sigurimit të të dhënave;
- f) Intervista formale dhe jo formale me personat e arrestuar ose të ndaluar;
- g) Përdorimin e pyetësorëve që janë plotësuar nga oficerët individualisht, të punësuarit e tjerë të SHPK-së dhe pjesëtarët e publikut.

4.3 Nëpunësit e Inspektoratit në rrjedhjen e një inspektimi të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm mund të sigurojnë kopjet e materialeve, referohu 4.2(b) më lartë, nëse kjo është e nevojshme për të përpiluar raportet e Inspektoratit dhe për të nënshkruar dëftesat në lidhje me të gjitha kopjet e tilla të materialeve policore.

4.4 Nëpunësit e Inspektoratit do të pajtohen me të gjitha dispozitat e ligjit në zbatim që i takojnë ruajtjes dhe shfrytëzimit të të dhënave personale dhe do të jenë në pajtueshmëri me ato dispozita të ligjit në zbatim që lidhen me ruajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave nga pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës.

4.5 Nëpunësit e Inspektoratit nuk duhet me asnjë kusht të publikojnë/lirojnë asnjë të dhënë të mbledhur në rrjedhën e detyrave të tyre, te asnjë person që nuk është nëpunës i Inspektoratit, pa autorizimin paraprak dhe me shkrim nga kryetari apo në mungesë të tij nga kryesi i detyrës së KE-së. Publikimi/lirimi i të dhënave të tilla me paramendim dhe i pa autorizuar – në çdo formë - do të rezultojë me suspendim të menjëhershëm nga puna e nëpunësit relevant të Inspektoratit, deri te një procedurë e plotë disiplinore e kryer sipas direktivave të Sekretarit të Përhershëm të Ministrit të Punëve të Brendshme.

4.6 Secilit nëpunës të Inspektoratit do t'i lëshohet një kartelë identifikimi e cila do të shërbej si dëshmi e autoritetit të tij që të veprojë në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme si nëpunës i pavarur. Një nëpunës i Inspektoratit mund të pajiset me kartelë identifikimi vetëm nëse ai ka kaluar periudhën e trajnimit dhe vlerësimit, siç është përcaktuar nga kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit në bashkëpunim me Grupin Projektues të OSBE-së. Kjo kartelë identifikuese do të lëshohet nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme.

4.7 Zyrtari policor i cilës do gradë apo i punësuar në polici do të ketë të drejtën të kërkojë kontrollimin e kartelës identifikuese të një nëpunësi të Inspektoratit para se t'i lejohet hyrja në ndonjë nga zonat të cilat janë nën kontroll policor dhe t'i lejohet të ketë qasje në materialet policore.

4.8 Në fillim të një inspektimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, nëpunësit e lartë të Inspektoratit të cilët bëjnë inspektimin duhet ta kenë kopjen e autorizimit me shkrim nga kryeshefi ekzekutiv (ose kryesi i detyrës së KE-së), për zyrtarët e lartë policor që janë përgjegjës për stacionet apo divizionet policore.

4.9 Me rastin e marrjes së autorizimit me shkrim zyrtari më i lartë do të ndihmoj qasje të pakufizuar në të gjitha zonat e stacionit dhe divizionit policor dhe ta udhëzoj personelin e tij që të sigurojnë ndihmesën e tyre të plotë për nëpunësit e Inspektoratit.

4.10 Kur zyrtari policor dështon që të jetë në pajtueshmëri me këto kërkesa, nëpunësi i Inspektoratit duhet të raportojë për të dhënat te kryeshefit ekzekutiv i Inspektoratit i cili do të vendosë nëse t'i dërgohet çështja Ministrit të Punëve të Brendshme, me synim që të merren masa disiplinore kundër oficerit.

4.11 Kryeshfi ekzekutiv mund t'i këshilloj oficerët e tij që të caktojnë disa intervista në rrjedhjen e një inspektimi të zakonshëm, nga një takim paraprak me menaxherët relevant të SHPK-së. Kjo duhet të jetë normë ku takimi i mëparshëm nuk do të kundërshtoj qëllimin e inspektimit.

4.12 Personeli i Inspektoratit do të bëjë inspektimin sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe në mënyrë që t'i shmangët ndonjë përçarje të panevojshme në punën e zyrtarëve policor dhe personelit mbështetës. Nëpunësit e Inspektoratit duhet të jenë të sjellshëm dhe profesional në të gjitha kontaktet me oficerët e SHPK-së dhe personelin mbështetës, si dhe me çdo pjesëtar të publikut me të cilët ata kanë kontakte profesionale.

## 5. Inspektimet e zakonshme

5.1 Autoriteti për të kryer inspektime të zakonshme do të bëhet në formë të autorizimit të shkruar që është i nënshkruar nga kryeshfi ekzekutiv i Inspektoratit. Autorizimi me shkrim për të kryer inspektim të zakonshëm do të skadojë në fund të vitit përkatës fiskal.

5.2 Një "Inspektim i zakonshëm" është një inspektim i efikasitetit të stacionit apo divizionit policor, si dhe pajtueshmëria e tij me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Inspektimet e zakonshme të SHPK-së do të adresojnë ato çështje të kryerjes së detyrave nga menaxhmenti të përcaktuara në ligjin në zbatim dhe do të përfshijnë;

- a) Menaxhimin e ndërtesave të policisë, buxhetit, financave, parkut të automjeteve dhe pajisjeve;
- b) Menaxhimin e burimeve njerëzore;
- c) Menaxhimin e armëve të zjarrit, municionit dhe armëve;
- d) Menaxhimin e arrestimit dhe ndalimit;
- e) Menaxhimin e krimeve kundër pakicave etnike dhe lirisë së lëvizjes;
- f) Menaxhimin e patrullave të trafikut dhe sigurinë në rrugë;
- g) Menaxhimin hetimit të krimit dhe zbulimit;
- h) Menaxhimin e ankesave kundër policisë dhe hetimin e shkeljes disiplinore;
- i) Menaxhimin e planeve lokale të policimit, sigurisë në bashkësi dhe iniciativat e policimit në bashkësi; dhe
- j) Menaxhimin e përpunimit të të dhënave personale dhe pajtueshmërinë me ligjin në zbatim.

Nëse e shih të arsyeshme dhe të nevojshme, ministri mund të përfshij edhe fusha tjera të menaxhimit të SHPK-së në këtë listë.

5.3 Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit do të përgatisë një varg protokolle që do të shfrytëzohen nga nëpunësit e Inspektoratit në kryerjen e inspektimeve të zakonshme. Kryeshefi ekzekutiv do t'i rishikojë të gjitha protokollet çdo 12 muaj dhe kur është e nevojshme t'i ndryshojë dhe përmirësojë këto dokumente. Ministri duhet ta autorizojë, lejojë, përdorimin e protokollit dhe të çdo amendamenti para se të përdoren nga nëpunësit e Inspektoratit.

5.4 Para fillimit të çdo viti fiskal kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit do të përgatisë një orar të inspektimeve të zakonshme, në lidhje me çdo zonë të menaxhimit të SHPK-së dhe çdo stacion dhe divizion të Shërbimit Policor të Kosovës. Orari duhet të sigurojë se secili stacion dhe divizion është subjekt i një kontrollimi të zakonshëm gjatë një viti fiskal.

## 6. Kryerja e inspektimeve të jashtëzakonshme

6.1 Një "inspektim i jashtëzakonshëm" është inspektim i stacioneve apo divizioneve policore ku Ministri ka bazë për të besuar se paraqitja apo kryerja e detyrave të menaxherëve policorë, apo një grupi të oficerëve policorë bie nën nivelin e të priturve nga publiku.

6.2 Autorizimi për të bërë një inspektim të jashtëzakonshëm do të bëhet në formë të autorizimit të shkruar që është i nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit dhe deklaron arsyen dhe qëllimin e inspektimit. Autorizimi me shkrim për të bërë një inspektim të jashtëzakonshëm do të skadojë brenda 72 orëve që nga koha e lëshimit.

6.3 Kryeshefi ekzekutiv mundet vetëm të filloj një inspektim të jashtëzakonshëm nëse ai është i udhëzuar për ta bërë atë nga Ministri i Punëve të Brendshme apo zëvendësministri, në mungesë të Ministrit. Udhëzimi i tillë do të bëhet me shkrim apo me gojë në raste urgjente. Në këto raste, kur udhëzimi është dhënë me gojë, Ministri (apo zëvendësministri) do të sigurojë udhëzim me shkrim, sa më shpejt që të jetë e mundur të arrihet.

6.4 Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit do të siguroj udhëzime me shkrim për nëpunësit e Inspektoratit në lidhje me secilin inspektim të jashtëzakonshëm

## 7. Raportet e inspektoratit

7.1 Kryesuesi i Inspektoratit do të siguroj direktivat në lidhje me të gjitha raportet e Inspektoratit që janë në përputhje me protokollet e referuara më lartë.

7.2 Një raport i Inspektoratit i lëshuar nga Inspektorati Policor do të rishikohet dhe nënshkruhet nga Kryeshefi Ekzekutiv apo në mungesë të tij nga kryesi i detyrës së KE-së, para se të publikohet.

7.3 Raportet e Inspektoratit qartë dhe shkurtimisht do të deklarojnë qëllimin e të dhënave të kryerjes së detyrës dhe rekomandimet e bazuara në këto të dhëna.

7.4 Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit duhet të siguroj që raportet e Inspektoratit të jenë të lira nga komentet subjektive apo ndonjë çështje tjetër që nuk është e bazuar në dëshmi objektive.

7.5 Kur të përfundohen raportet e Inspektoratit, kryesuesi i Inspektoratit do të siguroj që ato të jenë në pajtueshmëri me standardet më të larta të integritetit dhe t'i përmbushin objektivat e përmirësimit të paraqitjes dhe efektshmërisë së paraqitjes policore, si dhe pajtueshmërinë e plotë me ligjin në zbatim.

7.6 Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit do të siguroj se kopjet e të gjitha raporteve të Inspektoratit Policor dhe korrespondencën lidhur me të si dhe dëshmitë e dokumentuara të jenë të ruajtura dhe të arkivuara në mënyrë të sigurt, qoftë elektronike apo në formë dokumentesh.

## **8. Dëshmitë e shkeljeve disiplinore**

8.1 Nëse gjatë rrjedhës së një inspektimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, një nëpunës i Inspektoratit vihet në dijeni për dëshmitë e sjelljes së një pjesëtari të SHPK-së, që mund të tregojë se është duke u kryer apo është kryer shkelje e rëndë disiplinore, ai do ta përfundoj inspektimin menjëherë dhe ta njoftojë kryeshefin ekzekutiv (apo kryesin e detyrës së KE-së). Në rrethana të tilla nëpunësi i Inspektoratit menjëherë do të përpiqet të sigurojë dhe të ruaj secilën dëshmi të shkeljes disiplinore dhe të veprojë nën udhëheqjen e kryeshefit ekzekutiv dhe PSO-së përkatëse.

8.2 Nëse gjatë rrjedhës së një inspektimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, një nëpunës i inspektoratit vihet në dijeni për dëshmitë e sjelljes së një pjesëtari të SHPK-së, që mund të tregojë që një vepër kriminale është kryer apo është duke u kryer, ai do të përfundojë inspektimin dhe menjëherë ta njoftojë prokurorin publik dhe kryeshefin ekzekutiv (apo kryesin e detyrës së KE-së). Në rrethana të tilla nëpunësi i Inspektoratit menjëherë do të përpiqet që t'i sigurojë dhe ta ruajë secilën dëshmi të shkeljes disiplinore dhe të veprojë nën udhëheqjen e prokurorit publik, kryeshefin ekzekutiv dhe PSO-së përkatëse.

8.3 Nëse gjatë rrjedhës së një inspektimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, një nëpunës i Inspektoratit vihet në dijeni për dëshmitë e sjelljes së një pjesëtari të SHPK-së që mund të tregojë që një shkelje e lehtë disiplinore është kryer apo është duke u kryer, ai do të përfundoj inspektimin dhe menjëherë ta njoftoj kryeshefin ekzekutiv (apo kryesin e detyrës së KE-së) dhe Njësitin për Standarde Profesionale. Në rrethana të tilla nëpunësi i Inspektoratit menjëherë do të përpiqet ta sigurojë dhe ta ruajë secilën dëshmi të shkeljes disiplinore dhe të veprojë nën udhëheqjen e kryeshefit ekzekutiv dhe PSO-së përkatëse.

## Inspektorët e Inspektoratit Policor të Kosovës

Enver Rrustemi, Shef i inspektorëve dhe ushtrues i detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv

Albina Dobruna, asistente administrative

Admir Shala, inspektor i IPK-së

Arben Vrajolli, inspektor i IPK-së

Arsim Telaku, inspektor i IPK-së

Asmir Muminovic, inspektor i IPK-së

Aziz Nika, inspektor i IPK-së

Bekim Lajci, inspektor i IPK-së

Bekim Pira, inspektor i IPK-së

Bujar Mustafa, inspektor i IPK-së

Daluk Haliti, inspektor i IPK-së

Hasan Mehmeti, inspektor i IPK-së

Hysni Gashi, inspektor i IPK-së

Ilir Idrizaj, inspektor i IPK-së

Kadri Keqmezi, inspektor i IPK-së

Miradije Kelmendi, inspektor i IPK-së

Mirsad Pucurica, inspektor i IPK-së

Nazmi Gashi, inspektor i IPK-së

Servet Tasholli, inspektor i IPK-së

Valdet Hoxha, inspektor i IPK-së

Xhevdet Halili, inspektor i IPK-së





## Ekipi implementues i OSBE-së për Inspektoratin Policor të Kosovës



Anëtarët e Ekipit të OSBE-së

Frank Harris, menaxher i projektit

Steve Smith, menaxher për trajnim

Selim Selimi, trajner (Ligji i aplikueshëm)

Apollon Hoxha, trajner (Përpilimi i raporteve)

Burim Brahimi, trajner (Shkathtësitë e menaxhimit)

Teuta Begolli, trajner

Arlinda Krasniqi, koordinatore për vlerësimin e punës në terren

Bojana Ivkovic, koordinatore e ekipit për përkthim

Venera Mehmeti, asistent i programit, përkthyes/monitorues

Srdjan Peric, asistent i programit, përkthyes/monitorues

Elvane Bunjaku, asistent i programit, përkthyes/monitorues

Almir Vucej, asistent i programit, përkthyes/monitorues

Mehmet Veliu, asistent i programit, përkthyes/monitorues

Sinan Pasha, asistent i programit, përkthyes/monitorues

### *In Memoriam - Nenad Gajic*

*Në nëntor 2006 Nenad Gajic, Përkthyes/Monitorues dhe një koleg i dashur i OSBE-së, ka humbur jetën tragjikisht në një aksident komunikacioni. Ne kemi kujtime të ngrohta për të dhe jemi mirënjohës për kontributin e veçant të tij për projektin e IPK-së.*



*Vizitë IPK-së nga komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, Steve Curtis, shtator 2006*

# SEMPER VIGILO

Motoja e Inspektoratit Policor të Kosovës është 'Semper Vigilo' – përherë vigjilent dhe duke vëzhguar. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është një organ i pavarur i mbikëqyrjes së policisë, i cili i shërben interesave të përgjegjshmërisë drejt përmirësimit të punës policore, në të mirë të të gjitha bashkësive.

Inspektorati Policor i Kosovës – Raporti vjetor 2006

Ministria e Punëve të Brendshme – Qeveria e Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

# SEMPER VIGILO